

UDHA PROFETIKE

Udha Profetike

Përgatiti

Taulant Bica

Detin Kotrri

Armand Asllani

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Ndalohet shumëfishimi, botimi, fotokopjimi dhe depozitimi elektronik, mekanik apo me anë të ndonjë sistemi tjetër regjistrimi i teksteve dhe figurave të krejt librit apo të një pjese të tij, pa leje me shkrim nga shtëpia botuese.

Udha Profetike
Kolana e librave – PRIZMI

Përgatiti : Taulant Bica
Detin Kotrri
Armand Asllani

Grafika: Indrit Isufi

ISBN: 9789928476524

Shtëpia Botuese “ZAMBAKU”
Adresa: Rruga Demneri, Z.K. 2679, 41/2/37
Kashar | Tiranë

www.zambaku.al

PËRMBAJTJA

Dashuria e profetit Muhamed (pqmt) për nënën	7
Dita e parë e të Dërguarit të Zotit në Medine.....	11
Edukimi i fëmijëve nën dritën e haditheve	16
Rëndësia e konsultimit dhe komunikimi në familje.....	21
Mënyra e debatimit dhe komunikimi në familje	28
Mënyra e komunikimit të Profetit tonë (pqmt)	35
Ndjeshmëria e sahabeve në të shprehur.....	39
Një ditë e Profetit Muhamed (pqmt)	43
Profesioni i sahabeve dhe veçoritë e tyre.....	46
Sakrificat e sahabeve në misionin e kumtimit të fesë	50
Urtësia në dërgimin e profetëve dhe librave	55
Veçoritë fizike të Profetit tonë (pqmt)	61
Vlera e tesbihatit të namazit	65
Edukimi i grave në kohën e Profetit (paqja qoftë mbi Të).....	70
Parime të edukimit profetik: “Përhap dashuri dhe mëshirë!”	79
Parime të edukimit profetik: “Bëje të dashur, mos e bëj të urreyer!”	84
Prefekti i parë i Mekes pas Islamit.....	88
Radhitja e katër kalifëve dhe meritat e tyre	91

Dashuria e profetit Muhamed (pqmt) për nënën

Siç dihet, Profeti (pqmt) e humbi nënën e tij, zonjën Emine, kur ishte akoma një djalë i vogël gjashtëvjeçar. Por nuk është e vështirë të mendohet dashuria e sinqertë dhe respekti që Profeti (pqmt) do të tregonte ndaj saj nëse ajo do të jetonte.

Ajetet kuranore dhe hadithet profetike rreth të drejtave të prindërve, urdhrat dhe këshillat që ato shprehin, na e tregojnë qartësisht mënyrën se si Profeti (pqmt) do të sillje me prindërit nëse ata do të ishin në jetë.

Le të shohim se çfarë thuhet në Kuranin Famëlartë rreth kësaj teme, pastaj le t'i referohemi edhe disa haditheve. Në Kuranin Famëlartë, Allahu i Madhërueshëm urdhëron kështu:

“Adhurojeni Allahun e mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët, të varfërit, me fqinjët e afërt dhe të largët, me atë që keni pranë, me udhëtarin dhe me robërit (nën pushtetin tuaj). Me të vërtetë, Allahu nuk e do atë që është kryelartë (arrogant) dhe atë që lavdërohet (mburret).”¹

“Ne e kemi urdhëruar njeriun që t'i nderojë prindërit e vet. Nëna e ka mbartur atë duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Ne i thamë atij: ‘Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu! Tek Unë do të ktheheni të gjithë.’”²

“Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuroni tjetër

¹ Surja Nisa, 36.

² Lukman, 14.

përpos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj as ‘Of!’ atyre, as mos u bëj i vrazhdë me ta, po thuaju fjalë të mira (të buta, respektuese). Dhe në shenjë mëshire, shtrije pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj: ‘Zoti im! Mëshiroji ata të dy, sikurse (ata) më edukuan mua kur isha i vogël’.”³

Ndërsa Profeti Muhamed (pqmt) është shprehur kështu:

Kënaqësia e Allahut gjendet në kënaqësinë e prindërve, ndërsa zemërimi i Allahut ndodhet në zemërimin e tyre.⁴

Ndër gjynahet më të mëdha janë t’i bësh shokë Allahut dhe të kundërshtosh prindërit.⁵

Kur e pyesin Profetin (pqmt) se për kë duhet të kujdesemi më shumë, Profeti përgjigjet tri herë “Për nënën”, herën e katërt thotë “Për babanë”.⁶

Pra, siç vihet re në ajetet dhe hadithet e mësipërme, respekti ndaj prindërve është shumë i rëndësishëm dhe i vlerësuar.

Tani do të përpiqemi të tregojmë një kujtim të Profetit (pqmt) në lidhje me nënën e vet, si dhe sjelljet që Ai shfaqti ndaj zonjave që kishin genë si nëna për Të:

Profeti (pqmt), gjatë umres së Hudejbijes, kur ishte rrugës për në Meke, vizitoi edhe Ebvan. Kërkoi leje nga Allahu (xh.sh.) dhe vizitoi varrin e nënës. E rregulloi me dorën e Tij varrin dhe filloi të qante. Kur e panë Profetin duke qarë, edhe myslimanët e tjerë të pranishëm filluan të qanin dhe, më pas, e pyetën Profetin (pqmt) për arsyen. Ai u përgjigj kështu: “M’u kujtua dhembshuria dhe mëshira e nënës për Mua, prandaj qava.”

Kur Profeti i nderuar (pqmt) ishte ende i porsalindur, Ai u mækua për një javë nga Suvejbe, një robëreshë e Ebu Lehebit. Gjatë gjithë jetës së Tij, Profeti (pqmt) u soll mirë me këtë grua dhe i bëri shumë të mira.

³ Surja Isra, 23-24.

⁴ Tirmidhi, Birr ve Sila, 3.

⁵ Tirmidhi, Birr ve Sila, 4.

⁶ Buhari, Edeb, 2.

Edhe pas emigrimit për në Medine, Profeti vazhdimisht i dërgonte asaj ushqime dhe të fala me anë të atyre që shkonin e vinin, të cilët edhe i pyeste për gjendjen e saj. Profeti vijoi të kujdesej për të derisa ajo ndërroi jetë. Kur mësoi për vdekjen e saj, pyeti nëse i kishte i mbetur ndonjë i afërm. I thanë se ajo nuk kishte askënd.

Mëndesha e Profetit, zonja Halime, erdhi në Meke dhe i tregoi Profetit (pqmt) se ishte periudhë thatësirash të mëdha dhe se, për shkak të kësaj thatësire, kafshët e tyre po ngordhnin. Profeti, i cili në atë kohë ndodhej në Meke dhe ishte i martuar me Hatixhen (Zoti qoftë i kënaqur me të), i dhuroi Halimes 40 krerë dele si dhe një deve, për t'i hipur gjatë rrugës së kthimit e për të transportuar ngarkesën.

Kur Halimeja e vizitoi Profetin (pqmt) një tjetër herë, Profeti u ngrit menjëherë në këmbë duke iu drejtuar me fjalët: “Nëna ime e dashur! Nëna ime e dashur!”. Pastaj hoqi një rrobë të vetën dhe e shtroi që ajo të ulej mbi të. Asokohe, ky veprim cilësohej si shenjë dashurie dhe respekti.

Le të përmendim këtu edhe Umu Ejmen Bereken (Zoti qoftë i kënaqur me Të), e cila në librat e Shemalit⁷ përmendet si dadoja e Profetit. Profeti (pqmt) e donte dhe e respektonte shumë këtë zonjë që i pati shërbyer Atij. Ai e donte aq shumë atë, saqë, herë pas here, i thoshte: “Ti je një nënë e dytë për mua”. Është interesant fakti që Profeti e quante atë “nënë të dytë”. Kur merret parasysh edhe statusi i saj shoqëror prej një robëreshe shërbëtore, kuptohet më mirë vlera, respekti dhe dashuria që Profeti tregonte për të. Siç dihet rëndom, në periudhën e injorancës, skllëverit nuk gëzonin asnjë të drejtë, por Profeti e lartësonte Umu Ejmenin në nivelin e nënës së vet.

Kjo tregon se, me ardhjen e Profetit (pqmt), do të kishte një zhvillim të madh në lidhje me të drejtat e grave.

Do të ishte me vend që të përmendej këtu edhe zonja Fatma, bashkëshortja e Ebu Talibit. Kur Profeti, në moshën tetëvjeçare, u vendos në shtëpinë e tyre, kjo zonjë filloi ta trajtonte atë njësoj si fëmijët e saj.

Ashtu siç veproi me të gjitha gratë që i kishin shërbyer kur kishte

⁷ Disiplina që analizon aspektin njerëzor të Profetit tonë.

qenë fëmijë, Profeti ashtu u soll edhe me zonzjën Fatma. Ai e respektoi atë gjatë gjithë jetës dhe nuk u tregua asnjëherë i vrazhdë. Kur Fatma ndërroi jetë, Profeti (pqmt) tha: “Më vdiq nëna.” Dha këmishën, që të përdorej si qefin për të, dhe e futi në varr me duart e veta.

Kur e pyesin për arsyen e këtij interesimi kaq të madh për të, Ai (pqmt) përgjigjet:

“Me përjashtim të Ebu Talibit, askush tjetër nuk më ka bërë aq mirë sa kjo grua. Këmishën ia dhashë për qefin në mënyrë që asaj t’i vishen rrobat e xhenetit. E futa vetë në varr, që jeta e varrit të jetë e lehtë dhe e rehatshme për të. Ajo ishte nëna ime! Edhe kur i kishte fëmijët e vet të uritur, ajo më ushqente mua në fillim. M’i rregullonte flokët para tyre. Ajo ishte nëna ime!”⁸

Me shprehjen e këtyre fakteve, mund të thuhet pa asnjë mëdyshje se dashuria e Profetit (pqmt) për nënën ishte shumë e madhe.

Edhe në lidhje me dashurinë për nënën, ashtu si në çdo temë tjetër, myslimanët e marrin shembullin më të mirë nga Profeti Muhamed (pqmt). Pra, të gjithë myslimanët, duke ndjekur shembullin e Profetit tonë të dashur, duhet t’i duan dhe t’i respektojnë nënat dhe ato që janë në statusin e nënës për ta.

Për rrjedhojë, nëse e kemi në jetë nënën, duhet të tregojmë vazhdimisht dashuri dhe respekt për të, duhet të jemi në çdo kohë në shërbim të saj. Nëse ka ndërruar jetë, duhet ta përmendim duke kërkuar mëshirë për të, duhet t’i ndajmë me fëmijët tanë kujtimet që kemi në lidhje me nënën tonë, të lutemi për të dhe të kryejmë vepra që do ta qetësojnë në botën tjetër.

⁸ Shikoni shembujt rreth dashurisë së Profetit (pqmt) për nënën tek Ibn Sa‘d, *Tabakâtu’l-Kubrâ*, I, 109-117; Ibnu’l-Esîr, *el-Kâmil*, I, 459; Ahmed b. Ebî Ya’kub b.Xha’ferr, *Tarihu’l-Ja’kubî*, II, 14; Mevlânâ Abdulbâkî, *Meâlimu’l-Jakîn*, fq. 25.

Dita e parë e të Dërguarit të Zotit në Medine

Ikja nga Kuba

Pasi qëndroi 14 ditë në Kubë, i Dërguari i Allahut lajmëroi në ditën e pesëmbëdhjetë fisin Nexhran. E ata erdhën për ta shoqëruar përgjatë rrugës drejt Medines. Pasi kishte hipur mbi Kasvan⁹, devenë e Tij, bijtë e Amr Ibni Avfit i dolën para Profetit dhe i thanë: “O i Dërguari i Allahut, a po ikën se je mërzhitur me ne apo po kërkon një vend më të bekuar?”

I Dërguari i Allahut (pqmt), i cili gjithmonë vepronte sipas urdhërit të Allahut tha: “Unë jam urdhëruar të udhëtoj drejt nje qyteti të bekuar. Prandaj, mos ia zini rrugën devesë sepse edhe ajo është urdhëruar të shkojë diku.”¹⁰ Këto fjalë shprehin qartë se edhe deveja e Tij kishte marrë një urdhër dhe se do ta zbatonte patjetër atë.

Teksa po udhëtonin për në Medine, drejt shtëpisë së Ejub el-Ensarit, anëtarët e fisit Nexhran po e shoqëronin Atë në të dy krahët. Pak pasi ishin nisur për rrugë, Ebu Bekri (Zoti qoftë i kënaqur me të) vërejti se një kalë po vinte me shpejtësi drejt tyre. U kthye menjëherë nga i Dërguari i Allahut (pqmt) dhe i tha se kalorësi po vinte drejt tyre me qëllimin për t'i sulmuar. Pasi e vuri re këtë gjë, i Dërguari i Zotit iu lut Allahut (xh.xh.) që ta hidhte kalorësin përtokë. Ende pa ulur duart e hapura në lutje, Profeti pa që kali e kishte hedhur kalorësin në tokë.

⁹ İbn Sa'd, *Tabakat*, I/171

¹⁰ Semhudî, *Vefau'l-Vafa*, I/442

Por, brenda pak çastesh, kalorësi u ngrit, i kërkoi falje Profetit dhe iu përgjërua që t'i jepnin mundësinë për të bërë diçka për ta. Pikërisht ai, i cili pak minuta më parë kishte tentuar ta vriste, tani po i përgjërrohej të Dërguarit të Allahut që ta falte dhe t'i jepte mundësinë për të bërë diçka për Të! I Dërguari i Allahut pranoi dhe i dha atij detyrën e qëndrimit në atë vend deri në mbrëmje, që të mos lejonte të kalonte askënd nga ata që ishin nisur me qëllimin për t'iu bërë keq atyre. Kalorësi e mbajti fjalën dhe qëndroi roje në atë vend deri në mbrëmje.¹¹

Kur arritën në vendin e quajtur Harre, i Dërguari i Zotit u dërgoi lajm ensarëve. Erdhën edhe ata që ta shoqëronin drejt Medines. Ndërkohë, njerëzit në Medine, të ngazëllyer nga lajmi i ardhjes së Profetit, shprehnin dëshirën e madhe që ta kishin Atë mysafir në shtëpitë e tyre. Në mënyrë që askujt të mos i vinte keq e që të mos i thyhej zemra asnjëri, i Dërguari i Zotit u shpreh se deveja e tij kishte marrë urdhër (nga Allahu) të ndalonte pikërisht atje ku Ai do të rrinte.

Sapo mbërrijnë në vendin e quajtur Belhubla, i Dërguari i Allahut pikas Abdullah ibni Ubej ibni Selulin dhe shpreh dëshirën për ta vizituar, por ai, me një arrogancë të theksuar, thotë: “Shko vizito ata që të kanë ftuar!”

Pas këtyre fjalëve, Sad ibni Ubade, kryetari i fisit Hazrexh, thotë: “O i Dërguari i Zotit, mos u mërzit nga fjalët e tij, sepse njerëzit e Medines i kishin premtuar se do ta bënë mbretin e tyre, por Allahu (xh.xh.) atë të drejtë ta dha Ty. Prej kësaj është mërzitur ai.”¹²

Ndërkohë që devenë Kasva e kishte lënë të çapitej e lirë, i Dërguari i Zotit lutej me fjalët e Hz. Nuhut (pqmt): “Zoti im, më dërgo në një vend të bekuar! Ti je më i miri i atyre që vendosin!”¹³

Vendi ku Kasva ndaloi

Ndërkohë, Kasva ndaloi në një copë toke, e cila u përkiste dy jetimëve të fisit Nexhran, Sehlit dhe Suhejlit. Ishte më se e qartë, kjo

¹¹ Ibn Sa'd, Tabakat, I/172

¹² Semhudî, I/445

¹³ Surja Muminun 23/29

ishte një zgjedhje hyjnore. Kjo copë toke e bekuar ishte krejt bosh dhe deri atëherë ishte përdorur nga ata pak myslimanë të atij qyteti për të falur namazin pas Esad ibni Zurares. Madje, edhe Musab ibni Umejri, kur kishte ardhur për t'i mësuar Islamit medinasve, në këtë vend e kishte falur namazin.¹⁴

Pas kësaj, i dërguari i Zotit zbriti nga deveja. Gara për ta pasur Profetin si mysafir në shtëpi u përtërit. Prandaj u hodh një short. Emri që u zgjodh ishte ai i Ebu Ejub el-Ensarit (Zoti qoftë i kënaqur me të). Në fakt, vendi ku deveja kishte ndaluar gjendej shumë afër shtëpisë së tij. Kështu që, çështja u zgjidh në një mënyrë të pranueshme për të gjithë.

Gëzimi në Medine

Qyteti i Medines po përjetonte ditën më të gëzueshme. Rrugët e qytetit kurrë nuk kishin parë një ditë aq të bukur. Njerëzit shprehnin gëzimin e tyre duke i thënë njëri-tjetrit kështu: “Erdhi i Dërguari i Allahut! Erdhi i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi Të)!”. Ndërkohë, i Dërguari i Zotit u nis më këmbë drejt shtëpisë ku do të qëndronte. Ai ecte me një modesti të madhe. Vajzat e fisit Nexhar kishin dalë në rrugë për të përshëndetur të Dërguarin e Allahut dhe, nën shoqërinë e tingujve të defit¹⁵, shprehnin dashurinë për Të dhe ngazëllimin e mbarë qytetit duke thënë: “Ne jemi vajzat e Nexharëve! Sa mirë që po bëhemi komshinj me të Dërguarin e Allahut!”.

I Dërguari i Zotit nuk kaloi pa e vlerësuar sjelljen e tyre. Ndaloj, u kthye drejt tyre dhe i pyeti: “A më doni ju mua?” “Po, o i Dërguari i Zotit!” iu përgjigjën ato njëzëri. Pas kësaj, i Dashuri i Zotit tha: “Pasha Allahun, edhe une ju dua fort!” Dhe e përsëriti këtë tri herë.¹⁶

Në shtëpinë e Ebu Ejub el-Ensarit

Pasi i Dërguari i Zotit hyri në shtëpinë e Ebu Ejub el-Ensarit, u ul për të pushuar. Pikërisht atëherë, të gjithë ata që kishin dashur të

¹⁴ Ibn Sa'd, Tabakat, I/174

¹⁵ Një instrument muzikor i ngjashëm me dajren (shënim i përkthyesit)

¹⁶ Semhudî, Vefau'l-Vefa, I/451

ishin mikpritësit e të Dërguarit të Allahut, për ta qerasur Atë me çfarë kishin, u nisën me nxitim drejt shtëpisë së Ebu Ejubit. Vizitorja e parë qe nëna e Zejd ibni Thabitit, e cila vajti atje bashkë me djalin e saj. Për këtë ditë të shënuar, ajo kishte përgatitur bukë me gjalp dhe qumësht. Ky qe edhe ushqimi i parë që iu ofrua të Dërguarit të Allahut (pqmt) në Medine. Zejdi ia zgjati ushqimin Profetit duke i thënë se e ëma e kishte përgatitur enkas për Të. Ndërsa i Dërguari i Allahut (pqmt) u përgjigj me fjalët: “Allahu e ktheftë në begati për ty dhe nënën tënde”. Më pas, që ta hanin bashkë bukën, Profeti thirri edhe bashkudhëtarët e Tij. Pa mbyllur mirë derën Zejdi, me një tas ushqim në dorë, në prag u shfaq Sad ibni Ubade. Qerasja e Profetit me ushqime u kthye në një lloj gare midis sahabeve. Tre-katër syresh në ditë i dërgonin ushqim Profetit. Dhe kjo zgjati për shtatë muaj me radhë.¹⁷

Shtëpia e Ebu Ejubit (Zqkmt) ishte dykatëshe. I Dërguari i Zotit tha se donte të qëndronte në katin e parë, por Ebu Ejubi iu lut të kalonte në katin e dytë, pasi nuk mund të rrinte i qetë nga droja se mos e shqetësonte të Dërguarin e Allahut, paçka se ecte në majë të gishtave që të mos bënte zhurmë. Kur u ngrit për të falur namazin e natës (tehexhudin) natën e parë, nga mendimi se po qëndronte sipër kokës së të Dërguarit të Allahut (pqmt), u struk në një cep të dhomës dhe ashtu qëndroi deri në mëngjes. Të nesërmen, foli sërish me të Dërguarin e Allahut (pqmt) dhe këmbënguli që Ai të ngjitej në katin e sipërm, duke thënë kështu: “O i Dërguari i Zotit, unë nuk mund të qëndroj në asnjë cep të katit të dytë, nga mendimi se ti je poshtë këmbëve të mia.” Pas kësaj, Ebu Ejubi zbriti në katin e parë.¹⁸

I Dërguari i Zotit qëndroi në këtë shtëpi plot shtatë muaj, aq kohë sa u desh për ndërtimin e dhomës së Tij pranë mesxhidit *Nebevi*. Ebu Ejubi (Zqkmt) tregon një ngjarje që kishte ndodhur gjatë kësaj kohe. “Një herë i ofrova (të Dërguarit të Allahut) ushqim, në të cilin kishte qepë dhe hudhra. Pas pak, i Dërguari i Zotit e solli mbrapsht ushqimin. Nuk e kishte prekur fare. Kjo na bëri përshtypje dhe e pyetëm se mos

¹⁷ İbn Sâd, Tabakat, I/173

¹⁸ Semhudî, Vefau'l-Vefa, I/454

vallë kishim gatuan një ushqim jo të mirë. Ai (pqmt) na tha: ‘Ndjeva erë qepe dhe hudhre, prandaj nuk e hëngra. Unë jam vazhdimisht në kontakt me Zotin tim, por ju mund ta hani atë ushqim.’ Pas kësaj përgjigjeje, u qetësuam dhe e hëngrëm vetë atë ushqim. Të Dërguarit të Allahut nuk i ofruam më ushqim të atillë.’¹⁹

Përfundime

Në Akabe, ensarët u betuan se do ta mbronin, strehonin dhe ushqenin të Dërguarin e Zotit. Kësisoj, ata e mbajtën fjalën. I Dërguari i Allahut (pqmt) u strehua në vend të sigurt dhe u mbrojt nga armiqtë e Tij. Ai u vendos pranë njerëzve që e mbronin dhe që kujdeseshin për Të njëlloj si për veten dhe familjet e tyre. Ditët e vështira të Mekes kishin mbetur pas. Në jetën e Profetit dhe në historinë e Islamit po fillonte një epokë e re. Drita e Islamit, të cilën në Meke kishin dashur ta shuanin, tashmë kishte kaluar në qytetin e ndritur të Medines. Me zbritjen e kësaj drite dhe me ardhjen e Profetit të Fundit, emri dhe misioni i këtij qyteti ndryshoi. Tashmë ai quhej “Medinetur Rasul - Qyteti i të Dërguarit të Zotit” ose “Medine el-Munevvere - Qyteti i Ndritur.” Me kalimin e kohës dhe në përputhje me fjalët ndriçuese të të Dërguarit të Zotit, këtij qyteti iu referuan si “vendi i besimit, vendi i hixhretit dhe kubeja e Islamit.”

¹⁹ İbn Hişam, I/110

Edukimi i fëmijëve nën dritën e haditheve

Edukimi është ai proces sistematik që sjell ndryshime pozitive në sjelljen e individit, ndryshime në ide e qasje ndjesore, të cilat, më pas, pasqyrohen edhe në veprime. Nga ky këndvështrim, mund të thuhet se edukimi ndikon mendjen, zemrën dhe trupin e njeriut.

Suksesi i aktivitetit edukues që është ndërmarrë në kohën e profetit Muhamed (pqmt) nuk është arritur nga askush e në asnjë periudhë tjetër. Po të merren parasysh momenti i fillimit të profetësisë dhe gjendja e atëhershme e popullit që Profeti (pqmt) edukoi - po të analizohet niveli që arritën këta njerëz si rezultat i këtij edukimi - do të vërehet fare qartë suksesi i Profetit tonë (pqmt). Po ashtu, mund të thuhet se niveli i arritur është një tjetër argument i profetësisë së Tij (pqmt).

Profeti Muhamed (pqmt), në një kohë shumë të shkurtër prej 23 vjetësh, arriti të bënte ndryshime rrënjësore dhe të kishte mbi njerëz një ndikim aq domethënës, sa që ky ndikim vazhdon edhe sot e kësaj dite dhe do të zgjasë deri në ditën e gjykimit. Ashtu si në periudhën kur Ai jetonte, edhe sot myslimanët e duan me gjithë zemër të Dërguarin e Allahut (pqmt) dhe i ndjekin me devotshmëri parimet e shprehura prej Tij. Askush tjetër, përgjatë gjithë historisë së njerëzimit, nuk ka arritur të ketë një ndikim të tillë dhe njerëz që i binden me kaq devotshmëri.

Ai, me lejen e Allahut, arriti që njerëzit e një populli, të cilët i groposnin të gjalla vajzat e lindura, t'i kthente në njerëz që kujdeseshin që të mos i shkelnin as milingonat teksa ecnin. Ai (pqmt) arriti t'i

bënte njerëzit të hiqnin dorë nga shumë zakone të këqija dhe të arrinin të bëheshin mësues të vlerave morale dhe shpirtërore për mbarë njerëzimin. Një revolucion i pashoq ky, që pati sjellë ndryshime rrënjësore në ide e qasje, në mendje e zemra. Një revolucion që i nxori njerëzit nga bataku i injorancës dhe i shndërroi ata në më të lartët e të lartëve. Po të shohim në ditët e sotme, pavarësisht përpjekjeve të shumta të shkencëtarëve për parandalimin e një vesi të keq siç është duhanpirja, nuk është arritur ndonjë rezultat i kënaqshëm. Kjo tregon edhe një herë përmasat e revolucionit që realizoi Profeti Muhamed (pqmt).

Por çfarë ishte ajo gjë që bëri të mundur që Profeti (pqmt) të bënte një revolucion të tillë shoqëror dhe të kishte ndikim kaq të madh te njerëzit? Cila urtësi mundësoi që njerëzit të lidhen kështu me Të dhe t'i binden Atij në këtë masë? Cila është e fshehta që këta njerëz të zhytur në injorancë arritën të merrnin një zhvillim kaq domethënës në dije, dituri, moral e edukatë? Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve, duhet të analizojmë të gjithë jetën e Profetit Muhamed (pqmt).

Para së gjithash, Profeti (pqmt) mbështetej nga Forca Hyjnore. Ky është faktori më i rëndësishëm i ndikimit të Profetit. Morali i Tij ishte prej Kuranit Famëlartë. Ai ishte dërguar për të qenë edukator, dhe kështu gëzonte cilësitë më të larta të një edukatori të mirefilltë. Ai ishte i drejtë dhe i besueshëm. Ishte i dashur dhe i mëshirshëm me njerëzit. I afrohej njerëzve me respekt, dashamirësi e dhembshuri. U përgjigjej nevojave të tyre dhe u qëndronte pranë në kohë të vështira. Ishte modest e tolerant me njerëzit. Sillej me drejtësi, nuk mbante anë e nuk bënte dallime.

Krenaria e Njerëzimit (pqmt), ashtu siç ishte një shembull me sjelljet e veta, po ashtu ndriçonte mendjet dhe zemrat e njerëzve edhe me fjalët e Tij. Ai ishte në majën e artit të komunikimit; fliste qartë e pastër, dhe i përsëriste disa fjalë që njerëzit ta kuptonin më mirë. Fliste duke marrë për bazë nevojat dhe nivelin e njerëzve. Ishte elokuent dhe nuk e zgjaste fjalën kur diçka e atillë ishte e panevojshme. Nuk e thoshte atë që nuk e bënte, ato që i thoshte i hidhte në jetë. Ndonjëherë, ia tërhiqte

bashkëbiseduesit vëmendjen me pyetje që e çonin bisedën aty ku duhej të shkonte. Fliste për gjithçka dhe, me veprat e veta, bëhej një shembull i mirë për të gjithë. Për ta ilustruar me një shembull metodën e Tij edukuese, le të analizojmë ngjarjen e Rafi b. Amrit.

Ngjarja e Rafi b. Amrit (Zqkmt)

Kur Rafi b. Amr ishte ende një djalë i vogël, një ditë pati gjuajtur me gurë hurmën e një sahabiu në Medine. Pronari i tokës e çoi atë tek i Dërguari i Allahut (pqmt). Ai donte që Profeti (pqmt) ta dënonte djalin e vogël. I Dërguari i Allahut (pqmt) e pyeti:

- Bir, pse i gjuajta me gurë hurmës?
- Isha i uritur, prandaj e gjuajta hurmën me gurë,- u përgjigj djali.
- Mos i gjuaj më hurmat me gurë, por merr kokrrat që kanë rënë në tokë, - i tha Profeti (pqmt) dhe, duke ia ledhatuar kokën, u lut për të. - Zoti im, ngope këtë djalë!²⁰

Kjo ngjarje hedh dritë mbi mjaft parime që duhen ndjekur në edukimin e fëmijëve, të cilat janë shprehur edhe më poshtë:

1. T'i qasesh çështjes me dashuri dhe dhembshuri

Esenca e edukimit është dashuria dhe dhembshuria. Edukimi duhet të përçojë respekt dhe kjo duhet bërë me dashuri. Veçanërisht për fëmijët, dashuria është shumë e rëndësishme. Ata kanë më shumë nevojë për dashuri. Ata rriten dhe edukohen me dashuri. Fëmijët lidhen ngushtë me personin që u fal dashuri, ua vënë veshin fjalëve të tij dhe përpiqen të jetojnë si ai. Për këtë arsye, një nga prioritetet e edukimit është të dhënit mësim me dashuri.

Krenaria e Njerëzimit (pqmt) u qasej të gjithë njerëzve me dashuri dhe dhembshuri. Por Ai (pqmt) tregojë akoma më i dashur me fëmijët dhe i trajtonte ata me shumë dhembshuri. Rafi b. Amr (Zqkmt) është një nga shembujt e bukur të kësaj çështjeje. Edhe pse djalin e sollën

²⁰ Tirmidhi, Buju', 54; Ibn Maxhe, Tixharet, 67.

para Tij si një fajtor, Profeti (pqmt) nuk u tregua aspak i vrazhdë me të, nuk e ndëshkoi, por iu afrua me dhembshuri. Ai iu drejtua djalit me fjalën “bir”, i ledhatoi kokën dhe i foli me dashamirësi.

2. T'i dëgjosh fëmijët dhe të futesh në botën e tyre

Për t'i kuptuar fëmijët, është e nevojshme t'i dëgjoni ata dhe të futeni në botën e tyre. Ata kanë një botë krejt tjetër. Fëmijët kanë ndjenja dhe veçori të ndryshme sipas moshës në të cilën janë. Mendja e fëmijës nuk mund të kuptojë dhe peshojë plotësisht gjithçka. Për këtë arsye, duhet t'i njohësh ata shumë mirë dhe të marrësh parasysh edhe mendimet e ndjenjat e tyre. Shumë prindër thonë se nuk mundën t'i kuptojnë sjelljet e fëmijëve të tyre, por, për fat të keq, ata nuk i dëgjojnë kurrë fëmijët me qëllimin për t'i kuptuar.

Në rastin e Rafi b. Amrit (Zqkmt), Profeti ynë (pqmt) e pyeti djalin se përse e kishte kryer atë veprim, pra, e bëri atë të fliste dhe, para se të thoshte diçka apo të merrte një vendim, i dëgjoji me vëmendje fjalët e tij. Djali i tregoi Profetit se i kishte gjuajtur me gurë hurmat për të siguruar diçka për të ngrënë. Afërmendsh, është më se normale që ta mirëpresim një fëmijë të uritur dhe të përpiqemi t'ia shuajmë urinë. Fëmija mund të mos jetë i vetëdijshëm për gabimin që ka bërë. Në situata të tilla, është e domosdodhme të kuptohen qëllimet dhe mendimet e fëmijës që ka kryer një veprim, qofshin këto edhe të gabuara. Çfarëdo që të bëjnë fëmijët, ne duhet t'i dëgjojmë ata para se të marrim vendimin tonë. Ne duhet të futemi në botën e tyre dhe të përpiqemi t'i kuptojmë.

3. T'u ofrosh alternativa fëmijëve

Një nga gabimet më të shpeshta që nënat dhe baballarët bëjnë është përpjekja e vazhdueshme për t'i ndaluar fëmijët të bëjnë diçka, për t'u vendosur pengesa, në mënyrë që të ngushtojnë gamën e veprimeve të tyre. Sigurisht, fëmija nuk duhet lejuar të bëjë veprime të gabuara. Dhe kjo gjë duhet arritur duke e paralajmëruar dhe duke i shpjeguar

atij pasojat negative të veprimeve të caktuara. Nuk është e drejtë që të heshtim kur fëmijët gabojnë. Por, që ndryshimi i sjelljes të jetë i pranueshëm për ta, krahas ndalimeve dhe pengimeve duhen ofruar alternativa. Nëse nuk i ofrohet një alternativë, fëmija ka gjasa të këmbëngulë në atë sjellje dhe ta përsërisë gabimin, pasi ai mund ta ketë të vështirë të gjejë një tjetër mënyrë për t'u dëfryer. Alternativat, krahas përforsimit të ndalimit, duhet t'i ofrojnë fëmijës mënyra të ndryshme kënaqësie.

Në edukim dhe pedagogji, një parim i çmuar është aplikimi i alternativave që shoqërojnë ndalesat e vendosura për fëmijët. Nuk është e drejtë që hapësira e lëvizjes dhe veprimtaria e fëmijës të ngushtohen duke i thënë vetëm “mos e bëj këtë”, “mos e bëj atë”. Të rriturit vazhdimisht i ndalojnë fëmijët të bëjnë diçka, të prekin diçka, të vizatojnë, të vrapojnë apo të kërcëjnë. Fëmija ama ka nevojë të veprojë ashtu si ia kërkon moshën. Ngushtimi i gamës së lëvizjes mund të ndikojë negativisht në zhvillimin e fëmijës. Ndërkohë që fëmijës i vendosen ndalime, i duhet shpjeguar gjithashtu se çfarë mund të bëjë në vend të veprimit të ndaluar. Për shembull, duhen ofruar alternativa të tipit “mos vizato mbi mure, por mund të vizatosh çfarë të duash në këtë letër”; “mos vraponi në sallën, por mund të vraponi në korridor”; “mos e shiko atë film, por mund të ndiqni këtë film tjetër”.

Në rastin e Rafi b. Amrit (Zqkmt), Profeti (pqmt), pasi dëgjoji fjalët e djaloshit, i tha se veprimi i tij ishte i gabuar dhe se nuk duhej ta përsëriste, por, në të njëjtën kohë, Ai i dha edhe një alternativë: “Mos i gjuaj hurmat me gurë, por mund të hash nga kokrrat që bien vetë në tokë”. Sa me vend do të ishte dhe sa ndikim do të kishte pasur nëse Ai do t'i thoshte një fëmije të uritur të mos i prekte hurmat? Fëmija, në njëfarë mënyre, do të ushqehet. Por, Profeti i tregoi fëmijës një mënyrë për t'u ushqyer, pra, i dha atij një alternativë.

Të thuash thjesht “mos” nuk është zgjidhje ndaj rreziqeve dhe veseve që, në ditët e sotme, i kanë rrethuar fëmijët në të katër anët. Duhet krijuar alternativa të reja, që të zënë vendin e tyre. Në vend që t'u thuhet “Mos shkoni në kinema!”, “Mos shikoni televizor!”, fëmijëve u

duhen gjetur filma dhe dokumentarë të atillë, që të jenë një alternativë e mirë, që të shihen nga fëmijët. Në vend që t'u thuhet “Mos shkoni këtu!”, “Mos shkoni atje!”, për fëmijët duhen përgatitur mjedise ku mund të shkojnë pa drojë dhe ku mund të formojnë rrethin e dëshiruar shoqëror. Përveç edukimit të fëmijëve tanë brenda familjes, gjithashtu duhen gjetur mënyra për t'i mbrojtur ata edhe kur gjenden në rrethin e tyre shoqëror.

4. Të lutesh për fëmijët

Lutja i jep fëmijës mesazhin për t'iu drejtuar Allahut në çdo çështje, që githçka ta kërkojë prej Tij. Për çdo gjë që i nevojitet, njeriu duhet t'i drejtohet Allahut; vetëm Atij duhet t'ia kërkojë atë. Pasi të ketë kryer detyrën që i bie mbi supe duke iu drejtuar Allahut, që qëllimi i tij të përmbushet, njeriu duhet të kërkojë ndihmën e Allahut. Për edukimin fetar të një fëmije, të rriturit duhet t'i tregojnë në një kohë të përshtatshme fëmijës kur dhe si të lutet.

Në të njëjtën kohë, qoftë edukatorët, qoftë prindërit, duhet t'iu lutën Zotit që të arrijnë ta edukojnë mirë fëmijën. Pra, i rrituri duhet të presë që fjalët e tij të kenë ndikim dhe që Zoti t'ia bëjë të mundur arritjen e rezultatit të dëshiruar. Është shumë e rëndësishme që prindërit të lutën për fëmijët e tyre, sepse lutjet e nënës dhe babait për fëmijët janë nga lutjet e pranuar. Nëse një nënë dhe një baba do të lutën sinqerisht për fëmijën e tyre, kjo do të jetë lutja më e pranueshme. Në ngjarjen e përmendur më lart, Profeti ynë (paqja qoftë mbi Të) e dha këtë mesazh duke u lutur për djaloshin, gjë kjo që thekson rëndësinë e lutjes krahas veprimeve të kryera.

5. Ledhatimi

Për fëmijën, përkëdhelja nga ana e një të rrituri ose një tjetër formë kontakti fizik është njëfarë shpërblimi. Bëhet fjalë për përkëdheljen e kokës ose faqeve, ledhatimin e shpinës, përqaftimin, puthjen apo mbajtjen e dorës. Një prekje e tillë e bën fëmijën të kuptojë se ai është i

dashur për personin që e ledhaton dhe, në këtë mënyrë, ndien afërsinë e tij. Në të njëjtën kohë, fëmija ndihet i sigurt dhe i mbrojtur nga personi që e ledhaton, nuk ndihet i vetmuar.

Kontakti fizik është gjithashtu shumë i rëndësishëm për sa i përket komunikimit ndërnjerëzor. Prekja dhe kontakti fizik konsiderohen gjerësisht si mjete të komunikimit joverbal. Një kontakt i këtij lloji e ndihmon personin të shprehë ndjenjat e veta më lehtësisht. Prandaj kontakti fizik është shumë i rëndësishëm, veçanërisht për zhvillimin e fëmijëve, pasi është edhe një nevojë psikologjike e tyre. Disa studime kanë treguar se te fëmijët që nuk duhen dhe nuk përkëdhelen mund të shfaqen një sërë sëmundjesh mendore.

Kontakti fizik i jep personit këtë mesazh: “Ti je i rëndësishëm për mua. Unë jam këtu me ty, ti nuk je vetëm.” Në dhënien e një mesazhi të tillë, asnjë fjalë nuk është aq efektive sa prekja. Ledhatimi i kokës së fëmijës me butësi nga i ati ose nga një mësues mund të jetë më me ndikim në komunikim sesa e folura e atij personi për orë të tëra. Prindërit dhe mësuesit nuk duhet të mjaftohen vetëm me shprehjen me fjalë të dashurisë së tyre për fëmijët. Është e nevojshme që ata ta shprehin dashurinë e tyre edhe nëpërmjet kontaktit fizik, duke u ledhatuar atyre kokën dhe faqet ose duke u përkëdhelur shpinën. Prekja do të përçojë ndjenjat që nuk mund të shprehen me fjalë.

Përfundime

Një nga arsyet pse Profeti ynë (paqja qoftë mbi Të) kishte ndikim domethënës te njerëzit dhe arriti të bënte ndryshime të mëdha tek ata është se Ai i zbatonte shumë mirë metodat dhe parimet e edukimit. Metodat dhe parimet e Tij nuk janë të kufizuara vetëm në çështjet e përmendura më lart. Kur analizojmë jetën e të Dërguarit të Allahut (pqmt), vihet re se ajo është e mbushur me mësimet ty vyera për sa i përket edukimit të fëmijëve. Për shembuj të vlefshëm aktiviteteve edukative që mund të zbatohen edhe sot, duhet shqyrtuar me kujdes jeta e Profetit tonë (paqja qoftë mbi Të) dhe duhen analizuar parimet që Ai ka ndjekur.

Rëndësia e konsultimit dhe komunikimi në familje

Një aspekt i rëndësishëm që duhet përmendur në kuadër të komunikimit të shëndetshëm brenda familjes është konsultimi. Konsultimi është praktika e shqyrtimit të një çështjeje duke e diskutuar mes palëve, në mënyrë që të merret vendimi më i goditur. Ashtu siç e ka treguar historia dhe ashtu siç vërehet edhe në ditët e sotme, vendimet e marra në mënyrë të njëanshme, pa marrë në konsideratë nevojat e palëve të tjera, e kanë dëmtuar rëndë komunikimin e shëndoshë brenda familjes dhe jo vetëm. Mbrojtja nga këto rreziqe në bashkëjetesë, duke përmbushur nevojat e gjithsecilit dhe pa cënuar të drejtat e të tjerëve, është e mundur vetëm përmes konsultimit.

Kurani Famëllartë urdhëron konsultimin

Kur përmenden cilësitë e besimtarëve në Kuran, thuhet “**...për ata që i përgjigjen thirrjes së Zotit të tyre, e falin namazin rregullisht dhe këshillohen për punët e veta me njëri-tjetrin...**”²¹, duke theksuar kështu rëndësinë e konsultimit. Përmendja e parimit të konsultimit si një cilësi e besimtarëve krahas besimit, dorëzimit, adhurimeve dhe shpenzimit (të të ardhurave) në rrugën e Allahut, shpreh qartë domethënien që konsultimi ka në sferën personale, familjare, shoqërore dhe administrative. Po ashtu, midis ajeteve që u zbritën pas tronditjes së pësuar në luftën e Uhudit, është edhe ajeti që i drejtohet Profetit

²¹ Shura, 38.

(pqmt) në këtë mënyrë: **“Konsultohu me ta në të gjitha çështjet dhe, kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu, sepse Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.”**²². Pra, në Kuran thuhet se, edhe në çastet më të vështira, pavarësisht asaj që mund të ketë ndodhur, zgjidhja me e saktë është ajo që arrihet nëpërmjet konsultimit.

Kjo tregon se, si ata që kanë pozicione drejtuese, po ashtu edhe vartësit e tyre, urdhërohen që t'i organizojnë punët me konsultim. Kështu që, siç nuk mund të quhen besimtarë të vërtetë ata të cilët nuk e praktikojnë konsultimin, vështirë se mund ta arrijnë lumturinë e vërtetë edhe ato familje apo shoqëri që nuk e praktikojnë konsultimin.

I Dërguari i Allahut (pqmt) e praktikonte konsultimin

Pa asnjë dyshim, njeriu që e zbatonte më me përpikmëri urdhrin për t'u konsultuar ishte i Dërguari i Allahut (pqmt). Ebu Hurejre, duke thënë “Nuk kam parë dikë tjetër që të konsultohet me shokët aq sa konsultohej i Dërguari i Allahut”²³, tregon ndjeshmërinë e Profetit tonë në këtë çështje. Ai (pqmt), si në Meke, ashtu edhe në Medine, në çështjet për të cilat nuk kishte shpallje hyjnore, konsultohej me shokët e tij dhe i këshillonte edhe ata që të vepronin në këtë formë. Për shembull, për të treguar rëndësinë që i është dhënë konsultimit dhe se vendimet në lidhje me çështjet administrative bazohen te konsultimi, Profeti ynë thotë: “Nëse do të urdhëroja emërimet pa marrë mendimin e myslimanëve, do të emëroja Abdullah b. Mes'udin”²⁴.

Profeti (pqmt), duke vënë theksin te qetësia, begatia dhe siguria që i sjell konsultimi individit, familjes dhe shoqërisë, thotë: “Kur drejtuesit tuaj të jenë prej të mirëve të mesit tuaj, kur të pasurit tuaj të jenë bujarë dhe për aq kohë sa punët do t'i bëni me konsultim, qëndrimi mbi tokë (pra, jeta) është më i dobishëm për ju sesa qëndrimi poshtë saj (nën dhé).”²⁵ Me fjalë të tjera, Profeti (pqmt), duke pasur parasysh të mirat

²² Ali Imran, 159.

²³ Tirmidhi, Xhihad 34 (1714).

²⁴ Ahmed b. Hanbel, Musned, I/76.

²⁵ Tirmidhi, Fiten 78 (2266).

që shoqëria përfiton nga konsultimi, është përpjekur që çdo çështje ta zgjidhë përmes konsultimit.

Ai (pqmt) e këshillonte konsultimin edhe para martesës

Për të garantuar një komunikim të shëndetshëm në familje, por edhe qetësinë dhe harmoninë, Islami nxit konsultimin në jetën familjare si para martesës, po ashtu edhe pas saj. Profeti (pqmt) ka vendosur një rregull të përgjithshëm duke thënë: “Në çështjet që kanë të bëjnë me to, konsultohuni me gratë.”²⁶ Me të vërtetë, në çështjet që kanë lidhje me to, duke qenë gratë e dinë më mirë situatën e tyre, sigurisht që mund të japin një vendim shumë më të përshtatshëm. Në vendimet që merren në lidhje me gratë pa u pyetur ato, në shumicën e rasteve burrat do të gabojnë. Në përputhje me këtë, Profeti (pqmt) është shprehur kështu rreth martesës së vajzave: “Për vajzat, konsultohuni me gratë”²⁷. Pra, Profeti ka kërkuar që burrat të konsultohen me gratë, sepse nënat janë ato që i njohin më mirë vajzat e tyre. Moskonsultimi me gratë për një çështje kaq të rëndësishme në jetën e njeriut, siç është martesë, shkakton probleme të mëdha për familjen.

Konsultimi në jetën familjare të Profetit (pqmt)

Po të ndërmerrej një analizë e imtësishme e jetës së Profetit (pqmt), do të vërehej se Ai, në çështjet familjare, konsultohej me bashkëshortet e Tij. Në fakt, Ai (pqmt) nuk kishte nevojë për mendimin dhe opinionet e tyre, sepse mbështetej në shpalljet hyjnore. Megjithatë, Profeti ynë vepronte në këtë mënyrë ngase dëshironte që ta mësonte popullin e Tij më këtë gjë dhe që gratë e Tij të formoheshin si bashkëshorte të denja profeti. Krejt ndryshe nga ajo çfarë ishte aplikuar deri më atë ditë, Profeti (pqmt) i dha gruas një pozitë shumë të lartë në familje. I Dërguari i Allahut (pqmt) e praktikoi këtë fillimisht në familjen e Tij.

²⁶ Ahmed b. Hanbel, Musned, II/97.

²⁷ Ebu Davud, Nikah 23 (2095).

Konsultimi me Hatixhen (Zqkmt)

Në lidhje me martesën e Tij (pqmt) me Hatixhen (Zqkmt), Profeti e pati marrë vendimin pasi që konsultuar me ungjin e Tij, Ebu Talibin. Kështu, Ai (pqmt) pati hedhur themelet e martesës përmes konsultimit. Në të njëjtën mënyrë, kur i erdhi shpallja e parë, menjëherë pasi zbriti nga Hira, Profeti ynë vajti dhe ia rrëfeu Hatixhes gjithë çfarë kishte përjetuar. Pra, u konsultua me dikë edhe në këtë çështje. Pasi e dëgjoi bashkëshortin e saj, Hatixheja, duke treguar një largpamësi të pashoqe, tha: “Mos u shqetëso! Beto hem se Allahu asnjëherë nuk do të të turpërojë apo mërzisë. Ti kujdesesh për lidhjet farefisnore, flet gjithmonë të drejtën, i ndihmon nevojtarët dhe të varfrit, e mirëpret mysafirin dhe i përkrah njerëzit që u është bërë padrejtësi!”

Konsultimi me Ummu Selemen

Në vitin e gjashtë të Hixhretit (Migrimit), Profeti (pqmt) bashkë me 1400 sahabe pati shkuar deri në Hudejbije me qëllimin për të vizituar Meken, për të bërë umre. Edhe pse ishin vetëm nja 25 km larg Mekes, politeistët mekas nuk lejuan që ata ta vizitonin Qaben. Në këtë situatë, palët u detyruan të bënin një marrëveshje. Por, pikat e marrëveshjes së Hudejbijes qenë aq të rënda për myslimanët në ato çaste, sa që nuk u mbeti fuqi as për të lëvizur vendit. Edhe pse Profeti (pqmt) i kishte urdhëruar që të thernin kurbanet dhe të hiqnin ihramet (veshjet) që kishin veshur, sahabet, me mendimin se ndoshta ky vendim do të ndryshonte, u vonuan dhe nuk e përmbushën menjëherë këtë urdhër. Ndonëse Profeti (pqmt) e kishte përsëritur edhe një herë tjetër urdhrin, sahabet vijonin të prisnin me shpresë.

Sapo e kuptoi atë që po ndodhte, Profeti (pqmt) u fut në çadrën e vet dhe u konsultua me nënën tonë, Ummu Selemen. Kjo zonjë mendjemprehtë foli me Profetin vetëm që kushti i konsultimit të përmbushej. Në fund të fundit, ajo e dinte që Profeti (pqmt) nuk kishte nevojë për fjalët e saj, ajo e dinte që Profeti (pqmt) donte t'i mësonte popullit të Tij rëndësinë e konsultimit.

Ummu Seleme i tha Profetit: “O i Dërguari i Allahut! Mos e përsërit më urdhrin, se ndoshta nuk e zbatojnë dhe, kështu, humbasin. Ti there kurbanin Tënd dhe hiqe ihramin pa u thënë gjë atyre. Kur ta shohin këtë, do të kuptojnë se urdhri duhet zbatuar dhe do të të binden Ty.” Dhe Profeti kështu veproi. Sapo Ai theri kurbanet, edhe sahabet filluan të thernin kurbanet e tyre.

Mënyra e debatimit dhe komunikimi në familje

Prej faktorëve që e pengojnë komunikimin brenda familjes në ditët e sotme, janë edhe polemikat e kota dhe debatet e pavlerë. Debatit, pavarësisht se në plan të parë mund të duket jo i dëmshëm dhe i logjikshëm apo si një faktor i pazëvendësueshëm i komunikimit, nëse nuk zhvillohet në përputhje me rregullat e debatimit, me kalimin e kohës, mund ta zbehë dashurinë dhe respektin për njëri-tjetrin. Fatkeqësisht, ngaqë në shumicën e rasteve nuk i përmbahemi këtyre rregullave, debati, më tepër se dobi, sjell dëme. Prandaj, çiftet që pretendojnë se kanë komunikim më të frytshëm kur debatojnë, me kalimin e kohës ftohen dhe largohen prej njëri-tjetrit. Po ashtu, duke mos e vënë re dëmin që i sjell debati atyre dhe familjes, bashkëshortët fillojnë të kërkojnë fajtorë të tjerë dhe të pyesin veten me fjalët “Mos vallë na ka bërë dikush magji?” apo “Mos e kanë marrë mësysh marrëdhënien tonë?”. Në fakt, faji nuk duhet kërkuar jashtë por brenda shtëpisë, sepse fajtorët janë pikërisht ata vetë. Ajo që nuk i përmbahet asnjë rregulli në debat dhe që, edhe kur i njeh, i injoron ato, është egoja e njeriut.

Parimet e diskutimit, të cilat duhen ndjekur në mënyrë që debati apo diskutimi të japë frytet e tij të pritshme dhe që të ruhem prej dëmeve që mund të na shkaktojë, janë si më poshtë:

1. Vetëdija që, në fund fare, do të jepet llogari para Allahut

Si në çështjet familjare, po ashtu edhe në çështje të tjera jashtë familjes, diskutimet duhen bërë me ndjenjën e *ihسانit* (njeriu duhet

të sillet sikur e sheh Allahun, por edhe nëse nuk e sheh, duhet ta dijë se Allahu e sheh atë në çdo çast), sepse Allahu mbikëqyr çdo situatë e veprim të robërve të Tij. Çdo çështje debatimi, çdo çështje për të cilën nuk ka dakordësi midis palëve, do të sillet në praninë e Allahut (xh. sh.) në Ditën e Gjykimit. **“Sigurisht që ti (o Muhamed) do të vdesësh një ditë dhe sigurisht që edhe ata do të vdesin. Pastaj, në Ditën e Gjykimit, ju do të grindeni para Zotit tuaj!”**²⁸ Kur ky ajet zbret, Zubejr b. Avam (Zqkmt) e pyet të Dërguarin e Allahut (pqmt):

- O i Dërguari i Allahut, çështjet që kemi diskutuar në këtë botë, polemikat e debatet e ndryshme, a do të përsëriten sërish në ditën e kiametit?

- Po, - thotë i Dërguari i Allahut.

- Atëherë situata qenka shumë e vështirë,²⁹- thotë Zubejr b. Avam (Zqkmt).

Prandaj duhet pasur kujdes. Kur debatojmë rreth një çështjeje, të mos tregohemi egoistë në mbrojtjen e pretendimit tonë pa e marrë fare parasysh mundësinë e të qenit në mbrojtjen e një pretendimi të gabuar. Të mos shkojmë në botën tjetër me barrën e cënimit të të drejtave të të tjerëve pa qenë aspak të vetëdijshëm për këtë.

Në të kundërt, ata që flasin pa ndier asnjë lloj përgjegjësie, do e dëmtojnë komunikimin. Kurani Famëlartë, duke na sjellë një ndodhi nga Epoka e Lumturisë, na jep një shembull të vyer për këtë çështje:

Eus b. Samit, që ishte një nga ensarët - mikpritësit e të mërguarve në Medine -, një ditë u nxeq keq me gruan e tij Haule b. Salebe dhe i tha: “Shpina jote është për mua si shpina e nënës sime!”, një shprehje që, asokohe, nënkuptonte divorcin. Pa kaluar shumë, ai u bë pishman për këtë veprim. Mirëpo Haule nuk mund t’i pranonte këto fjalë që binin ndesh me traditën e asaj kohe. Nga ana tjetër ama, as ajo nuk donte që t’i shkatërrohej foleja familjare. Si përfundim, u përpoq të gjente zgjidhje duke ia treguar të Dërguarit të Allahut ngjarjen me të gjitha detajet e saj. Ajo u shpreh se e kishte kaluar rininë në shërbim të

²⁸ Surja Zumer, 30-31.

²⁹ Tirmidhi, Tefsir 40; Ahmed b. Hanbeli, Musned, III/21.

burrit të saj, i kishte dhënë shumë fëmijë atij dhe se kërkonte që Profeti (pqmt) t'i gjente një zgjidhje për të mos u ndarë nga burri pas fjalëve që ai kishte thënë, fjalë të cilat, asokohe, ishin të barazvlefshme me divorcin e ditëve tona. Profeti (pqmt) i tha se nuk mund të jepte një gjykim tjetër për këtë çështje, përpos atij që këto fjalë nënkuptonin, dhe se nuk kishte ndonjë shpallje hyjnore që do ta ndryshonte gjykimin. Haule këmbënguli duke treguar për gjendjen e saj të rëndë, por nuk arriti të merrte një përgjigje tjetër.

Kur e kuptoi që këmbëngulja e saj nuk do të kishte ndonjë dobi, Haule u ul në një cep dhe filloi t'i lutej Allahut: “Zoti im! Jam shumë e vetmuar. Kjo ndarje më bën të vuaj së tepërmi. Kam fëmijë të vegjël. Nëse i lë që të jetojnë me të atin e tyre, do të vuajnë shumë. Nëse i marr unë, do të vuajnë nga uria. Po ta paraqes Ty gjendjen time. Më shpëto nga kjo vështirësi! Zbriti një shpallje të Dërguarit Tënd!” Pak pasi Haule e përfundoi lutjen e saj, zbriti ajeti. Profeti (pqmt) e thirri Haulen pranë Tij, i lexoi ajetin e zbritur dhe e përgëzoi se, falë kësaj shpalljeje, martesë e saj do të vazhdonte.³⁰

Ajetet e zbritura për këtë çështje janë: **“Allahu i ka dëgjuar fjalët e asaj, që diskutoi me ty për burrin e vet dhe iu ankua Atij. Allahu e dëgjoji bisedën tuaj, sepse Ai dëgjon dhe sheh gjithçka.”**³¹

Aishja (Zqkmt), e cila ishte dëshmitare e kësaj ngjarjeje, tha: “Sa i madh është Allahu që dëgjon çdo zë! Ajo zonjë, kur po i paraqiste gjendjen e saj Allahut, fliste me aq zë të ulët, sa që një pjesë të fjalëve të saj ishte e pamundur t'i dëgjoje.”³² Me këto fjalë në fakt, Hz. Aishe (Zqkmt) po i referohej edhe ajetit të parë, në të cilin Allahu thotë: **“Vërtet, Allahu i dëgjon dhe i sheh të gjitha.”**

Pra, ata që mendojnë se nuk i dëgjon askush kur debatojnë me njëri-tjetrin, asnjëherë nuk duhet ta heqin nga mendja faktin se Allahu gjithmonë dëgjon e sheh çdo gjë. Kjo do t'i ndalonte ata nga thënia e shumë fjalëve të padrejta dhe shfaqja e sjelljeve të pahijshme.

³⁰ Ebu Davud, Talak 7.

³¹ Shk. Surja Muxhadele, 1-5.

³² Kurtubi, el-Xhami' li-Ahkami'l-Kuran, IX/6440.

2. Të ndjekim udhëzimet e Allahut (xh.sh.) dhe Profetit (pqmt)

Gjithmonë duhet parë nëse një çështje që diskutohet brenda familjes gjendet apo jo në Kuran ose në thëniet profetike. Duhet parë se si çështja parashtrohet në Kuran ose në traditën profetike dhe, nëse çështja gjen zgjidhje aty, duhet braktisur debati për të evituar kështu dëmtimin e marrëdhënieve familjare. Urdhri i Kuranit drejtuar besimtarëve, për sa i përket kësaj teme, është i qartë: **“Beto hem në Zotin tënd se ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, për sa kohë nuk të marrin ty për gjykatës në konfliktet që ekzistojnë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dëshpërimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht.”**³³ Pra, kur nuk biem dakord për një çështje të caktuar, ajo duhet shtjelluar nën dritën e Kuranit dhe traditës profetike; dhe duhet t'i bindemi gjykimit të Kuranit dhe sunetit edhe kur mendimi ynë është i ndryshëm.

3. Të mos mbytemi në debat, po t'i dorëzohemi të vërtetës

Në të shumtën e rasteve, njerëzit nuk e ruajnë dot gjakftohtësinë gjatë debateve dhe mendojnë se duhet të dalin fitimtarë në çfarëdolloj mënyre. Pa u menduar gjatë në lidhje me informacionin që përdorin si argument, nëse është i saktë apo i gabuar, orvaten për t'ia mbyllur gojën bashkëbiseduesit ose për ta mundur atë. Ata që debatojnë një çështje mes tyre duhet të kenë kujdes që të mos e kalojnë kufirin në debat dhe të mos mbyten nga egot e tyre. Për sa i përket kësaj, Profeti ynë (pqmt) e paralajmëron popullin e Tij me fjalët: “Ai që urrehet më shumë nga Allahu është ai që, gjatë debatit, devijon nga e drejta për të dalë fitimtar dhe e vijon debatin në mënyrë të ashpër.”³⁴ Duke pasur këtë parasysh, principi që duhet ndjekur kur debatojmë nuk është triumfi personal, por përpjekja e përbashkët për të gjetur të vërtetën. Nëse debati vazhdon pa u zbatuar ky princip, nga ky debat nuk përfitohet ndonjë dobi. Përkundrazi, merren mbi shpinë gjynahe të shumta. Kjo

³³ Surja Nisa, 65.

³⁴ Buhari, Ahkam 34; Medhalim 15; Muslim, Ilim 2 (2668); Neueui, Şerhu Muslim, VIII/437.

shprehet edhe në këto fjalë të Profetit (pqmt): “Vazhdimi i debatit edhe kur e di se nuk ka të drejtë, i mjafton si gjynah njeriut.”³⁵ Në situata të tilla, edhe bashkëshortët, duke marrë gjynahet e debatit, ashtu siç e humbasin njëri-tjetrin në këtë botë pa dashur, e humbasin edhe në jetën e përtejme. Pra, rruga për të fituar, si në këtë botë, ashtu edhe në jetën e përtejme, kalon nga moskëmbëngulja në të gabuarën dhe pranimi i së drejtës kur ajo del në pah. Nëse është nevoja, i duhet kërkuar falje atij që ka të drejtë dhe, nëse e drejta e robit është cënuar, këtij njeriu duhet t’i kërkohej që t’ia bëjë tjetrit hallall.

4. Në debat, pajtimi është themelor

Kur debatohen çështjet brenda familjes, një prej pikave që duhen pasur kujdes është edhe pajtimi. Kriteri që Kurani vendos për debatin, veçanërisht për debatet familjare, bazohet në principin **“Pajtimi është më i dobishmi.”**³⁶ Kur bashkëshortët debatojnë rreth diçkaje, duhet të kenë si qëllim bashkimin në një pikë të përbashkët. Edhe nëse kjo nuk arrihet në atë moment, pajtimin duhet t’i lenë gjithmonë një derë hapur. Nuk duhet t’i binden egos, e cila mund të bëhet shkak për ta parë njëri-tjetrin si dy armiq që nuk do të pajtohen dot kurrë. Nuk duhet harruar se, në martesë, gruaja dhe burri nuk janë as konkurrentë e as armiq të njëri-tjetrit; ata janë palë dhe aleatë. Bisedat dhe diskutimet nuk janë fushëbeteja ku bashkëshortët pozicionohen në dy fronte të kundërta si armiq. Nëse për shkak të natyrës njerëzore, brenda vetes u lindin ndjenja armiqësore, duhet të sjellin ndërmend aleancën dhe marrëdhëniet që kanë me njëri-tjetrin. Duhet të veprojnë duke mbajtur parasysh këto fjalë të të Dërguarit të Allahut (pqmt): “Nëse kërkon armik, armiku yt më i madh është nefsi (egoja), ai që ndodhet mes dy krahëve të tu.”³⁷ Komunikimi me njëri-tjetrin duhet të jetë gjithmonë në linjën e vëllazërisë, miqësisë, dashurisë, respektit dhe pajtimin. Sepse, jo vetëm fjalët, por edhe të vepruarit në bazë të këtyre

³⁵ Tirmidhi, Birr, 58 (1994); Darrimi, I/336 (Hadis No: 296).

³⁶ Surja Nisa, 128.

³⁷ Axhluni, Keshfu’l-Hafa, I/143.

principeve të çon në një pikë të përbashkët dakordësie dhe në pajtim.

Një tjetër princip i rëndësishëm i debatit, që Profeti (pqmt) i ka dhënë njerëzimit, është edhe ky: “Duaje me masë atë që do, një ditë ai mund të bëhet armiku yt. Me atë që inatosesh, inatosu me masë, se ndoshta një ditë ai mund të bëhet miku yt.”³⁸

5. Të mos hequrit dorë nga debati rrjedh prej hipokrizisë, ndërsa sheshimi i menjëhershëm i mosmarrëveshjeve rrjedh prej besimit

Një problem dhe rrezik shpirtëror që ndez armiqësinë dhe largon pajtimin në debat, është edhe hipokrizia në besim. Në plan të parë, debati pa masë mund të mos duket se ka lidhje me hipokrizinë. Por Profeti (pqmt), kur përmend tiparet e hipokritit në besim e jetë, krahas gënjeshtërs, mosrespektimit të marrëveshjes, mosmbajtjes së premtimit dhe fjalës së dhënë, përmend edhe këtë: “Kur futet në konflikt, devijon nga e vërteta (dhe e tepron në armiqësi pa ndjekur asnjë lloj parimi).”³⁹ Për këtë arsye, Profeti (pqmt) thotë: “Mos u zhyt asnjëherë në debat me vëllain tënd, mos bëj shaka të tepruara me të dhe mos i premtu atij diçka që nuk e përmbush dot.”⁴⁰

Nga ana tjetër, të mos e zgjatësh debatin dhe ta përfundosh atë sa më parë është pjesë e besimit të sinqertë, pasi është një hap që hidhet për të mos dëmtuar unitetin e vëllazërinë. Dhe kjo ka shpërblim shumë të madh. Siç shprehet Profeti ynë (pqmt), “Unë jam garant se atij që hedh hapin e parë, për t’i dhënë fund mosmarrëveshjes (e debatit) edhe kur ka të drejtë, do t’i jepet një vilë në një cep të xhenetit. Jam garant edhe se atij që nuk gënjen, qoftë edhe për shaka, do t’i jepet një vilë në mes të xhenetit. Po ashtu jam garant se atij që ka moral të lartë do t’i jepet një vilë në vendin më të lartë të xhenetit.”⁴¹ Pra, është e qartë se debati më i mirë dhe më i dobishëm është ai që përfundon sa më shpejt. Nëse burri dhe gruaja i përmbahen këtij principi dhe e zbatojnë

³⁸ Tirmidhi, Birr 60.

³⁹ Buhari, Iman 24 (34); Muslim, Kitebu Iman, 106.

⁴⁰ Buhari, el-Edebu’l-Mufred, fq. 106 (394); Tirmidhi, Birr 58 (1995).

⁴¹ Ebu Davud, Edeb 8 (4800); Tirmidhi, Birr 58 (1993).

atë në jetën e tyre bashkëshortore, debatet familjare nuk do të devijojnë nga boshti i pajtimit dhe nuk do të shndërrohen në grindje e armiqësi. Për më tepër, ata që sillen në këtë mënyrë, para se të shohin vilën që Profeti (pqmt) u premton për botën tjetër, do të shohin se foleja e tyre familjare është shndërruar në një saraj të përhershëm xheneti.

6. Të mbahen parasysh virtytet e bashkëbiseduesit

Një prej treguesve të sjelljes me drejtësi dhe në mënyrë të ndërgjegjshme nga ana e dikujt është përmendja e virtyteve të bashkëbiseduesit në fillim të debatit dhe mosvënia në pah e anëve negative të tij. Në të kundërt, një debat që fillon me kritika e qortime do ta tensionojë bashkëbiseduesin, i cili, për rrjedhojë, do të vërë në lëvizje egon e tij, që të mbrojë veten dhe jo të drejtën. Në fund të fundit, qëllimi i debatit nuk është vënia në pah e të metave të bashkëbiseduesit, por dakordësimi në një pikë të përbashkët dhe të drejtë.

Përfundime

Në pamje të parë, debati mund të duket i vlefshëm. Por, në rast se nuk zhvillohet duke u bazuar në principet dhe kriteret e përmendura më sipër, debati sjell më shumë dëme sesa dobi dhe e cënon komunikimin e shëndoshë. Parë nga ky aspekt, debati është nga sprovat e rënda të gjuhës dhe fjalës. Është një prej momenteve kur shejtani mund të depërtojë brenda njeriut dhe ta nxisë atë për të ndezur armiqësinë. Është një ves që ushqen zemrën dhe ndjenjat e njeriut me mllef e urrejtje. Është një ves i keq, që e shkatërron ndjenjën e sigurisë dhe besimit mes bashkëshortëve dhe i ftoh ata nga njëri-tjetri, aq sa mund t'i çojë edhe në ndarje. Prandaj, debati duhet zgjatur sa më pak të jetë e mundur dhe duhet zhvilluar duke mbajtur parasysh kriteret e lartpërmendura. Lusim Allahun (xh.sh.) që të na ruajë nga e keqja që vjen prej gjuhës dhe nga debati shterpë e i pamasë!

Mënyra e komunikimit të Profetit tonë (pqmt)

Duke qenë se i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi Të) është dërguar si burim udhëzimi për tërë njerëzimin deri në ringjallje, do të thotë se Ai është një model që duhet ndjekur në çdo aspekt. Ai (pqmt) ishte një predikues dhe orator me ndikim, që prekte edhe zemrat e njerëzve; ishte një gjykatës i drejtë në zgjidhjen e çështjeve, një komandant trimufues në luftën kundër armiqve, një udhëheqës i aftë në qeverisje, një mësues efektiv dhe i dhembshur në edukim dhe një baba i mirë për familjen. I Dërguari i Allahut (pqmt) ndërmori një mision të vështirë. Për këtë qëllim, Ai u dha një rëndësi shumë të madhe fjalëve dhe sjelljeve të Tij. Prandaj ishin të qarta, të kuptueshme dhe ndikuese mesazhet që Ai përcolli.

I Dërguari i Allahut ka thënë se fjala ka peshë dhe lë mbresa tek njerëzit. Dhe, në elokuençë dhe retorikë, i Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi Të) ishte më i miri në mesin e arabëve. Ai (paqja qoftë mbi Të), këtë veçori të tijën e vë në dukje me fjalët “Unë jam dërguar me aftësinë për të shprehur shumë me fare pak fjalë,” si dhe “Më elokuenti me fjalët jam unë, sepse unë jam nga fisi i Kurejshëve dhe gjuha ime është ajo e Sa’d b. Bekrit.” Ibnu’l-Esir (v.606/1209), në lidhje me elekuencen dhe retorikën e të Dërguarit të Allahut (pqmt), thotë: “Patjetër që, për sa i përket diksionit, e folura e të Dërguarit të Allahut ishte më e qarta; për sa i përket fjalës dhe dialektikës, Ai ishte më i drejtpërdrejt; Ai ishte më i fuqishmi për sa i përket argumentimit, më i miri në aspektin e oratorisë; Ai ishte pa dyshim njohësi më i mirë i fjalës dhe udhërrëfyesi

më i mirë.” Hz. Aliu (Zoti qoftë i kënaqur me të) pranon, jo pa çudi, se pjesën më të madhe të bisedës së të Dërguarit të Allahut me Benu Nehdin nuk e kuptoi. I Dërguari i Allahut i tha: “Zoti im më ka mësuar ta përdor gjuhën (oratorinë) në mënyrën më të bukur dhe unë u rrita në fisin e Benû Sa’dit.”

I Dërguari i Allahut i njihte mirë dialektet e fiseve arabe dhe secilit i fliste në mënyrën dhe gjuhën që dinte e kuptonte. Në një prej haditheve të tij, i Dërguari i Allahut e shpjegon këtë me fjalët “Unë jam urdhëruar të flas me njerëzit në përputhje me nivelin e tyre të të kuptuarit dhe arsyetuarit”. Xhahizi (v. 255/869) shprehet në lidhje me gjuhën e të Dërguarit të Allahut duke thënë se është e pasur në figura letrare, por nuk lë vend për kontradikta; ai thotë se Profeti ynë ishte në gjendje të thoshte shumë me pak fjalë, se fjalët e Tij karakterizohen nga bukuria e shpjegimit, ku dashuria njesohet me butësinë, dhe se, ndonëse përdorte gjuhën e folur në përditshmëri, Atij nuk i mungonin shprehjet e reja dhe të veçanta.

Nëna jonë, Hz. Aisheja, që shqetësuar shumë nga mënyra se si Ebu Hurejre i transmetonte hadithet e të Dërguarit të Allahut dhe, kështu, që ankuar te Urve b. Zubejri. Ajo u thoshte se Ebu Hurejre i përcillte hadithet pa ndërprerje mes fjalëve, ndërkohë që i Dërguari i Allahut nuk kishte folur asnjëherë kështu. Pra, Profeti i thoshte fjalët një nga një dhe në këtë mënyrë hynte Ai në zemrat e dëgjuesve.

Sipas një tjetër transmetimi, Hz. Aisheja (Zoti qoftë i kënaqur me të) thotë: “Nëse dikush do t’i numëronte fjalët e të Dërguarit të Allahut ndërsa ai fliste, me siguri që ai person do arrinte t’i llogariste saktësisht”. I Dërguari i Allahut fliste qartë dhe kushdo mund ta kuptonte lehtësisht atë. Ata që dëgjonin me kujdes ndërsa Ai (pçmt) fliste, mund t’i mesonin përmendsh fjalët e tij. Qofshin të paktë a të shumtë në numër njerëzit me të cilët fliste, Ai fliste gjithmonë me finesë, me sinqeritet dhe pa u sforcuar.

Një prej fjalimeve të rralla të gjata të të Dërguarit të Allahut (paqja qoftë mbi të) është hutbeja (fjala predikuese) e lamtumirës, gjatë së cilës renditi një sërë parimesh të Islamit. Fjalimet e gjata, të cilat

tregojnë rregulla dhe principe, janë ngaherë të mërzitshme dhe të vështira për t'u ndjekur. Sidoqoftë, i Dërguari i Allahut e bëri fjalimin e tij të rrjedhshëm dhe të lehtë për t'u ndjekur përmes përdorimit të disa teknikave të oratorisë si përsëritja, pyetjet retorike dhe shembujt. Kështu, të pranishmit e dëgjuan me vemendje dhe pa u shpërqendruar.

I Dërguari i Allahut, i Cili fliste më bukur se kushdo, na mëson edhe ne si të flasim. Ai thotë: “Sigurisht, Allahu Teala nuk i do ata që, si bagëtitë, flasin duke përtypur ushqimin e tyre nëpër gojë”. Ai (pqmt) thotë: “Ata që mbajnë fjalime të gjata vetëm që njerëzit të thonë ‘sa bukur fliska!’, ata që i zgjasin dhe i ekzagjerojnë fjalët që thonë për t'u pëlqyer nga të tjerët, si dhe ata që flasin me fjalë të mëdha për t'u dukur të ditur janë ata që nuk i dua. Në Ditën e Gjykimit, këta do të jenë ata që do të gjenden më larg meje”.

I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi Të), para se të fillonte të fliste me njerëzit, jepte selam. Përshëndetja nëpërmjet dhënies së selamit është një mënyrë nderimi, por edhe shprehje e dashamirësisë. Të japësh selam do të thotë të largosh problemet e kësaj bote dhe asaj të përtejme. Të japësh selam do të thotë edhe të urosh arritjen e së vërtetës, paqes dhe shpëtimit. Kur dikush i drejtohet tjetrit me “*Selam alejkum*”, në fakt, po i thotë atij personi “Shpëtimi, paqja qoftë mbi ju! Ju mirëpres paqësisht, asnjë e keqe nuk do t'ju vijë nga unë!”. Prandaj, përshëndetja duke dhënë selam është një fillim i mbarë i komunikimit efektiv dhe të frytshëm.

I Dërguari i Zotit (paqja qoftë mbi Të) nënvizon rëndësinë e selamit me këto fjalë: “Ju nuk mund të hyni në xhenet nëse nuk besoni dhe nuk e doni njëri-tjetrin. A t'ju tregoj diçka që, kur ta praktikoni, do t'ju bëjë ta doni njëri-tjetrin? Përhapni mes jush selamin!” Nga ky hadith kuptohet qartë se njerëzit duhet ta duan njëri-tjetrin, duhet t'i përforcojnë marrëdhëniet mes tyre dhe se hapi i parë i komunikimit është selami.

Kur hyni në xhami dhe kur dilni prej saj apo kur takoni një besimtar, është sunet (sjellje në përputhje me traditën profetike) të thuhet “*Selam alejkum*”. I Dërguari i Allahut i jepte selam çdo burri, gruaje apo fëmije

që takonte në rrugë. Edhe kur takonte myslimanë, hipokritë dhe jobesimtarë që rrinin bashkë, ai i përshëndeste me *selam* të gjithë.

Kur disa hebrenj iu drejtuan Profetit tonë (paqja qoftë mbi të) me fjalët “Vdekja qoftë mbi ju!” Ai, prej edukatës së lartë që e karakterizonte, nuk iu përgjigj atyre në të njëjtën mënyrë, pra, nuk u tha “Vdekja qoftë edhe mbi ju!”. Por u tha “*ue alejkum*”, që do të thotë “Qoftë edhe mbi ju!”. Gjithashtu, i Dërguari i Allahut i porositi sahabet që, nëse ndokush do t’i përshëndeste ata në atë mënyrë, t’i përgjigjeshin me “*ue alejkum*”.

I Dërguari i Allahut (paqja qoftë mbi të) shkruante fjalën “*selam*” edhe në krye të letrave shtetërore dhe diplomatike. Në krye të letrës që i pati dërguar Hirakliut, mbretit romak, shkruhej “Paqja qoftë mbi ata që i nënshtrohen udhëzimeve!”.

Një tjetër fjalë e përdorur nga i Dërguari i Allahut për të përshëndetur ishte “*merhaba*”. Kjo fjalë derivon nga rrënja “*rhb*”, që do të thotë të jesh i gjerë/i bollshëm. “*Merhaba*” bart edhe kuptimin “Mirë se erdhe!/ Më gëzove me ardhjen tënde!”. Pejgamberi ynë (paqja qoftë mbi të), në një rast pati vërejtur se disa persona që kishin hyrë në xhami për herë të parë po përjetonin drojë dhe ankth. Në këtë situatë, Ai u kërkoi shokëve që t’i përshëndetnin ata me fjalën “*merhaba*”, për t’ua hequr frikën dhe ankthin. Në vijim, profeti Muhamed i pyeti të ardhurit se kush ishin. Delegacioni u përgjigj duke thënë se ishin përfaqësues të fisit Rabia. Pas kësaj, i Dërguari i Allahut i përshëndeti ata në këtë mënyrë: “*Merhaba* – Mirë se erdhët! Allahu mos ju turpëroftë dhe mos ju bëftë pishman!”

Ndjeshmëria e sahabeve në të shprehur

Rruga që ndiqet, qasja dhe mënyra se si shprehen mendimi, ndjesia, dija dhe përvoja përbëjnë atë që quhet formulim, stil. Çdo njeri ka formulimin e vet të veçantë. Formulimi shfaq nivelin e dijes, moralin, karakterin, filozofinë e jetës, si dhe botëkuptimin e personit. Formulimi dhe stili janë po aq të rëndësishëm sa vetë mesazhi i dhënë në të shkruar a të folur. Madje, në shumicën e rasteve, stili dhe formulimi kanë te lexuesi apo dëgjuesi ndikim shumë më të madh se edhe vetë mesazhi që përcillet. Për këtë arsye, duhet të tregohemi të kujdesshëm në të shkruar e në të folur dhe duhet t'i japim rëndësinë e duhur stilit dhe formulimit. Gjithmonë duhen pasur parasysh koha, vendi dhe rrethanat. Kur flasim, duhet treguar një kujdes i shtuar në mimikë e gjeste dhe, një të njëjtën kohë, i duhet kushtuar një rëndësi e veçantë tonit të zërit dhe fjalëve që duhen përzgjedhur.

Sahabet e nderuar, të cilët qenë edukuar nga i Dërguari i Allahut (pqmt) me edukatë hyjnore, ishin shumë të kujdesshëm në çdo aspekt. Përpiqeshin që çdo veprim ta bënin në përputhje me bindjen ndaj Allahut dhe lidhjen e veçantë me të Dërguarin e Tij, si dhe duke ruajtur marrëdhëniet e mira me të tjerët. Përpjekja dhe munda që shfaqnin ata, ndikonin në gjendjen, ndjenjat dhe mendimet e të tjerëve, por njëkohësisht, ndikonin gjithashtu edhe me mënyrën se si i formulonin fjalitë e thëna. Situatat me të cilat përballeshin ua shpjegonin atyre që kishin rreth vetes, në mënyrë që gjithësecili të përfitonte sa më shumë edhe nga eksperiencat

e të tjerëve. Këtë e bënin duke treguar një kujdes të veçantë dhe kjo formësonte edhe stilin e tyre të komunikimit. Nëse përballeshin me një ngjarje negative, ata jepnin mesazhin e duhur pa përmendur emra të përveçëm. Në këtë mënyrë ruanin veten nga përgojimi, nuk e turpëronin personin që kishte gabuar, nuk i ofendonin miqtë dhe të afërmit e tij dhe parandalonin mendimet negative që mund t'u lindnin të tjerëve në lidhje me atë person.

Pa dyshim, kjo ndjeshmëri është një tregues i moralit të lartë në përputhje me Kuranin dhe me shembullin e të Dërguarit të Zotit. Kur rrëfen për ngjarje të ndryshme të popujve të ndryshëm, Kurani, por edhe i Dërguari i Allahut (pqmt), nuk përmend emra konkretë, po shpjegon gabimet e tyre. Kur i Dërguari i Allahut (pqmt) donte të zgjidhte një problem apo të rregullonte një gabim, mundahej të mos përmendte emrin e askujt. U drejtohej të gjithëve me fjalë të llojit “Ç’po ndodh me ju, që ju shikoj duke vepruar kështu?”⁴² dhe e zgjidhte problemin pa ofenduar asnjërin prej atyre që kishin vepruar gabim.

“Muhaxhiri i Ummu Kajsit”

Në periudhën e hixhretit (emigrimit), një banor i Mekes u zhvendos në Medine për t’u martuar me një grua, e cila quhej Ummu Kajs. Kur e pyetën të Dërguarin e Allahut (pqmt) nëse ky person do të merrte apo jo edhe sevapet (mirësitë) e emigrimit, Ai (pqmt) u përgjigj: “Veprat janë (vlerësohen) sipas qëllimit. Secili do të përfitojë atë që ka pasur për qëllim. Kush emigroi për të fituar kënaqësinë e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij, emigrimi tij është për Ta. Kush emigroi për të fituar diçka të kësaj bote ose për t’u martuar me dikë, emigrimi tij është për atë çfarë synon.”⁴³ Shpjegimi i të Dërguarit të Allahut (pqmt) theksonte se problemi qëndronte tek qëllimi dhe se ai duhej ndryshuar. Sahabet e nderuar, të cilët nuk donin që ai person të ofendohej, edhe pse e dinin emrin e tij, nuk e kanë përmendur atë, por, për t’iu referuar atij, kanë përdorur fjalët “Emigranti i Ummu Kajsit”.

⁴² Ebu Davud, Edeb 5

⁴³ Buhari, Bedu’l-Vahy 1; Muslim, Ìmare 155; Ebu Davud, Talak 11

“Një grua”

Një ditë, i Dërguari i Allahut (pqmt) kishte shkuar për vizitë në varreza, ndoshta për të vizituar miqtë e tij. Ndërsa ishte atje, ai vuri re një grua që vajtonte mbi varrin e të birit duke përdorur edhe fjalë që binin në kundërshti me besimin. Profeti u mërzi shumë nga gjendja e gruas. Dhe, ngaqë deshi ta këshillonte, iu afrua pranë. Por gruaja, që nuk e kishte njohur Profetin (pqmt), ia ktheu me këto: “Hiqmu qafe! Ti nuk mund ta kuptosh atë që më ka ndodhur mua!”. Pas kësaj, Pejgamberi i mëshirshëm u largua që aty pa i thënë asgjë tjetër.

Më vonë, disa persona që ndodheshin aty, i treguan gruas se Ai që kishte dashur ta këshillonte ishte i Dërguari Allahut (pqmt). Gruaja u prek shumë nga kjo. Edhe pse pa dashje, ajo e kishte mërziur të Dërguarin e Allahut (pqmt). Donte ta shlyente fajin duke i kërkuar falje të sinqertë. Sapo e mori pak veten, vajti te shtëpia e Profetit dhe, e turpëruar, i kërkoi falje. I Dërguari i Allahut (pqmt) e fali dhe tha: “Durimi duhet treguar në momentin kur të godet e keqja.”

Sahabet që e transmetojnë këtë ngjarje, duke filluar nga Enes ibni Malik (Zqkmt), nuk e përmendin emrin e gruas të tronditur nga ajo fatkeqësi e rëndë, por i referohen asaj si “një grua”, në mënyrë që të mos paragjykohet apo ofendohet nga gabimi i shkuar.⁴⁴

“Një djalosh”

Një ditë, teksa i Dërguari i Allahut (pqmt) po bisedonte me shokët në xhami, dikush hyri brenda dhe iu afrua Atij. Më pas, me zë aq të lartë sa për ta dëgjuar edhe të pranishmit e tjerë, i tha: “O, i Dërguari i Allahut! Më jep leje për të bërë zina (imoralitet).” Kjo kërkesë aspak e hijshme nuk u prit mirë nga të pranishmit, të cilët filluan t’i bërtisnin dhe ta ofendonin djaloshin. Nga ana tjetër, i Dërguari i Allahut (pqmt), duke ruajtur qetësinë, shokëve u kërkoi të heshtnin, kurse djaloshit, të ulej përballë Tij. Pastaj e pyeti:

⁴⁴ Buhari, Cenaiz 32, 43, Ahkam 11; Müslim, Cenaiz 14, 15

- A dëshiron ti që të bëhet zina me nënën, vajzën, motrën, hallën apo tezen tënde?

- Çështë ajo fjalë, o i Dërguari Allahut! Sigurisht që nuk e dëshiroj diçka të atillë!

Atëherë, i Dërguari i Allahut (pqmt) i tha:

- Edhe njerëzit e tjerë nuk kanë dëshirë që me nënat, vajzat, motrat, hallat apo tezet e tyre të bëhet zina.

Më pas, i Dërguari i Allahut (pqmt) vendosi dorën në gjoksin e djaloshit dhe iu lut Allahut për të: “O Zoti im, falja gabimin, pastroja zemrën dhe ruaja nderin!”⁴⁵ Pasi u bind nga fjalët e të Dërguarit të Allahut (pqmt) dhe pasi u qetësua, djaloshi u largua që aty.

Ebu Umame (Zqkmt), i cili e transmeton këtë hadith, edhe pse e dinte emrin e djaloshit, nuk e përmend atë. Në këtë mënyrë, as djaloshi dhe as pasardhësit e tij nuk ofendoheshin kur e dëgjonin këtë histori. Një njeri i ndershëm, i martuar nga vetë i Dërguari i Allahut (pqmt) dhe për të cilin, kur ra dëshmor, i Dërguari i Allahu (pqmt) pati thënë “Ai është humbja ime!”, nuk mund të përmendet për t’u turpëruar. Andaj rrëfëhet vetëm ngjarja, me qëllimin për të nxjerrë mësim prej saj.

Përfundime

I Dërguari i Allahut, profeti Muhamed (pqmt), me oratorinë, komunikimin dhe sjelljen e tij, ka pasur shumë ndikim në mënyrën e jetesës së shokëve të vet. Duke marrë Atë si shembull, sahabet janë treguar shumë të kujdesshëm në zgjedhjen e fjalëve që transmetonin. Kështu, nuk është ofenduar askush dhe nuk është lejuar që gabimet e të parëve të rëndojnë mbi supet e pasardhësve. Në këtë mënyrë nuk bëhen pjesë e përgojimeve as transmetuesit, as lexuesit e ngjarjeve. Të gjithë ne, në të folurën, të shkruarit dhe të vepruarit tonë duhet të bazohemi në kriteret e ndjekura nga këta njerëz të dashur të Allahut, të cilët janë nga një busull orientuese për të gjithë myslimanët.

⁴⁵ Ahmed İbn-i Hanbel, Musned 36/545 (22211)

Një ditë e Profetit Muhamed (pqmt)

Si e kalonte Profeti Muhamed (pqmt) 24-orëshin e një dite?

Mënyrën se si Ai Zotëri i Nderuar i kalonte 24 orët e një dite na e tregojnë nipat e Profetit, ashtu siç ua ka transmetuar babai i tyre, Hz. Aliu.

Profeti Muhamed (pqmt) e ndante ditën në tri pjesë. Një pjesë e kalonte duke adhuruar Allahun me namaz dhe lexim Kurani. Një pjesë tjetër e kalonte duke ndihmuar pjesëtarët e familjes në punët e shtëpisë, pra, duke bërë punët e përditshmërisë. Edhe punët vetjake i bënte vetë. Kurse në pjesën tjetër të ditës, pushonte. Por edhe pjesën e pushimit e ndante në dy pjesë. Një pjesë të kësaj kohe e kalonte duke pritur vizitat e sahabeve më fisnikë dhe duke i mësuar ata me dije sipas nevojës që kishin. Këta të fundit, pasi largoheshin që aty, dijet që kishin marrë nga Profeti ua mësonin sahabeve të tjerë. Në mësimet që bënte me sahabet, Profeti (pqmt) i jepte më shumë rëndësi takvasë (përkushtimit në fe) sesa pasurisë, të ardhurave, prejardhjes familjare e kështu me radhë. Për këtë arsye, Ai (pqmt) u bënte komplimente atyre që ishin më të përkushtuar në adhurim e lutje, që i bindeshin fjalës së Allahut dhe që ndiqnin shembullin e Profetit.

Ai i ndihmonte nevojtarët sipas nevojave të tyre; dikujt i jepte diçka, një tjetri i jepte dyfishin, kurse të tjerëve, nëse kishin shumë nevojë, u jepte akoma më shumë. I dëgjonte hallexhinjtë pa u mërzhitur aspak, sillej shumë butë me ta dhe mendohej t'i ndihmonte. Kur dikush i drejtonte një pyetje në lidhje me këtë botë ose botën e përtejme, Ai

përgjigjej sipas nevojës dhe nivelit të personit që kishte bërë pyetjen.

Atë që bënte pyetje e drejtonte për nga rruga e mirë dhe e drejtë (hairit). Atyre që mësonin pranë Tij u thoshte se dijet që kishin marrë mund t'ua mësonin edhe atyre që nuk ishin të pranishëm. U kërkonte gjithashtu që t'ia përcillnin edhe nevojat dhe dëshirat e atyre që nuk kishin mundësi të shkonin pranë Tij, qofshin ata burra, gra apo robër.

Atyre që ndihmonin ata që nuk kishin mundësi në paraqitjen e kërkesave të tyre tek i pari i shtetit, Ai (pqmt) ua kujtonte gjithmonë këto fjalë: “Në Ditën e Kiametit, Allahu nuk do lejojë që këmba e atyre që ndihmojnë të tjerët të rrëshqasë në urën e Siratit.”

Nuk lejonte që në praninë e tij të thuheshin fjalë të panevojshme, të parëndësishme dhe të padobishme. Edhe kur dilte, Pejgamberi (pqmt) sillej me përulësi dhe edukatë. Kudo që shkonte, në treg, në rrugë apo diku tjetër, Ai shfaqej i buzëqeshur. Zemrat e njerëzve i fitonte duke i pyetur ata për hallet e tyre dhe duke folur me ta me ëmbëlsi.

Sapo vërente mungesën e ndonjë sahabeje në mesxhid (faltore), xhami, xhemat (mbledhje), xhuma (falja e së premtës) etj., interesohej menjëherë për gjendjen e tij dhe përpiquej të mësonte se mos i kishte ndodhur gjë. Atyre që takonte u thoshte gjëra që ua forconin vendosmërinë dhe ndjeshmërinë në besim, që i bënë të rendnin drejt së drejtës dhe punëve të mira dhe të largoheshin nga e gabuara dhe punët e këqija.

Kur shkonte në ndonjë vend apo mexhlis, Profeti ynë (pqmt) nuk përpiquej të ulej në krye patjetër. Ulej në fund ose aty ku kishte ndonjë vend bosh, me qëllim që të mos pengonte askënd. Edhe të tjerët i këshillonte që, në mbledhje të tilla ose mexhlise, të uleshin në një vend të përshtatshëm pa u bërë pengesë për asnjeri. Sa herë ishte e nevojshme, Ai (pqmt) i lavdëronte ata që ishin të pranishëm dhe përmendte punët e tyre të mira. Aq fort i lavdëronte, sa gjithësecili besonte se ishte më i dashuri për Profetin. Ata që ndiheshin të lodhur nga përpjekja ose që e kishin tepruar me veprime të pahijshme, mundohej t'i ndihmonte pa u mërzhitur, me durim dhe qetësi.

Kur i kërkohet diçka, nëse kishte mundësi, e jepte atë. Në të kundërt,

ia fitonte me butësi zemrën atij që kërkonte diçka dhe i premtonte për t'ia dhënë atë në të ardhmen. Të gjithë e dinin dhembshurinë, mëshirën, bujarinë dhe modestinë e Tij. Të gjithë e dinin se Profeti (pqmt) interesohej dhe kujdesej për ta, ishin të sigurt në këtë pikë. Duke përjashtuar këtu vetëm ndonjë rast të veçantë, në ndarjen e gjërave nuk bënte dallime mes njerëzve. Mexhlisi (mbledhja) i Pejgamberit (pqmt) ishte vendi i dijes, edukatës, durimit dhe i amanetit të ruajtur. Një pjesë e çështjeve që diskutoheshin në të tilla mbledhje nuk lejohej që të thuheshin jashtë saj. Asnjëherë nuk bëheshin thashetheme. Në të vërtetë, në mexhlis nuk thuhej asnjë fjalë kundër një tjetri dhe nuk fajësohej askush. Mangësitë që dilnin në pah në praninë e Tij, nuk përhapeshin nga të pranishmit. Ato ngelnin aty.

Ata që merrnin pjesë në mexhliset e Profetit, flisnin një gjuhë dhe shihnin me një palë sy. Pra, misioni ishte njësuar me shpirtat e tyre dhe ata ishin shkrirë në harmoninë e njësimi. Veprimtarinë e kishin në përputhje me fjalët që thoshnin. Në mesin e popullit të Tij mbizotëronte thjeshtësia dhe, në përputhje me këtë, të moshuarit respektoheshin dhe të vegjëlët trajtoheshin me dhembshuri. Së bashku rendnin për të ndihmuar nevojtarët. Por, për t'u kujdesur për nevojtarët, fillimisht zgjidheshin personat jonevojtarë.

Si përfundim, mund të thuhet se Muhamedi (pqmt), përgjatë 24 orëve të një dite, adhuronte Allahun, i kushtonte kohë pjesëtarëve të familjes së Tij dhe merrej me punët e shtëpisë, merrej me punët e fesë dhe të kësaj bote, merrej me problemet e shoqërisë dhe pushonte. Brenda kësaj kohe, Ai ia dilte të përmbushte çdo detyrim, t'i jepte gjithsecilit atë çfarë i takonte dhe, me thjeshtësi e mirësjellje të pamunguar ndaj çdokujt, me drejtësi dhe seriozitet të plotë, Ai i udhëhiqte të gjitha punët publike.

Çdo mysliman duhet të jetë i vetëdijshëm për rëndësinë e kohës. Duhet ta kuptojë që koha është si paraja, që edhe ajo harxhohet. Duhet ta mbajë në mend faktin se koha është e kufizuar dhe e fundme. Duhet të mos harrojë se koha është pasuria më me vlerë që kemi dhe se detyrimet e besimit dhe të kësaj bote duhet të përmbushen me ndjeshmëri të madhe në çdo njëzetekatërorësh.

Profesioni i sahabeve dhe veçoritë e tyre

Profesioni i sahabeve është të bëhesh pjesë e botëkuptimit të të Dërguarit të Allahut (pçmt) dhe të ngjyesh me bojën e Tij; t'i dalësh për zot Islamit në momentet më të vështira, atëherë kur duhet marrë parasysh edhe vdekja; të mos gënjesh kurrë, qoftë edhe për shaka, dhe, në këtë mënyrë, të arrish në nivelin e njerëzve më të mirë dhe më të lartësuar, sigurisht, poshtë nivelit të profetëve.

1. Nën udhëheqjen e Kuranit dhe Sunetit

Veçoria parësore e profesionit të sahabeve - rrugë kjo e ndjekur edhe nga njerëzit e mençur, trashëgimtarët e Profetit - është përpjekja për t'i analizuar çështjet sipas *nassit* (duke iu referuar ajeteve e haditheve dhe jo komenteve të mëpasshme). Në lidhje me çdo çështje, sahabet e nderuar fokusoheshin te të kuptuarit e vullnetit hyjnorë, në mënyrë që të vepronin në përputhje me kënaqësinë e Zotit, pra, për ta fituar atë kënaqësi. Në çdo gjë me të cilën përballeshin, fillimisht mendonin se çfarë kërkonte nga ata Allahu (xh.xh.).

Sahabet janë përpjekur dhe munduar në mënyrë të paimagjinueshme, të pakrahasueshme me ndonjë gjeneratë tjetër ndër shekuj, për të kuptuar se si të kënaqnin Allahun përmes kuptimit të saktë të fjalës hyjnore, pra, të Kuranit Famëlartë.

Një tjetër veçori po aq e rëndësishme e profesionit të sahabeve është edhe përpjekja e skajshme për të vijuar me përpikmëri traditën profetike, pra, përpjekja për të jetuar sipas fjalëve, veprave dhe sjelljes

së të Dërguarit të Allahut (pqmt). Ashtu si çdokush që dëshiron ti ngjajë atij që admiron, edhe sahabet e nderuar, të cilët ishin shumë të lidhur shpirtërisht me të Dërguarin e Allahut (pqmt), dëshironin dhe përpiqeshin t'i ngjanin Atij jo vetëm në adhurime, por edhe në çdo veprim apo sjellje.

Përpjekja për t'i ngjarë të Dërguarit të Allahut (pqmt) në të gjitha veprimet dhe sjelljet tona të përditshmërisë na bën të fitojmë sevape. Njeriu fiton sevape edhe nëse mundohet t'i ngjajë të Dërguarit të Allahut (pqmt) në veprimet dhe sjelljet me të thjeshta dhe të zakonshme të përditshmërisë si në mënyrën e të ngrënit, të pirit, të fjeturit, të folurit, të ulurit, etj..

Sahabet e nderuar, edhe veprimet apo sjelljet më të zakonshme të përditshmërisë të të Dërguarit të Allahut (pqmt) i konsideronin një formë adhurimi. Prandaj janë përpjekur që t'i zbatojnë ato me një zell dhe përpikmëri të paarritshme nga tjetërkush.

2. Kerameti (mrekullia) i vërtetë i sahabeve

Një tjetër veçori po aq e rëndësishme e profesionit të sahabeve është mungesa e dëshirës për të kërkuar keramet (mrekulli/ të bërit mrekulli) nga Allahu. Të gjithë sahabet janë “*veli*”, pra, njerëz të dashur të Allahut (xh.xh.). “*Velajeti*” i tyre, pra, të qenit njerëz të dashur të Allahut (xh. xh.), quhet “*velajeti kubra*” dhe rrjedh nga “*veraseti nubuvvet*”, që është trashëgimia profetike. Me fjalë të tjera, ata janë trashëgimtarët e të Dërguarit të Allahut (pqmt). Nuk ka qenë e nevojshme për sahabet e nderuar të përshkojnë rrugëtimin e *velive* të tjerë – të njerëzve të dashur të Allahut (xh.xh.) – pasi ata e kanë arritur të vërtetën në një mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes mirësisë së Allahut (xh.xh.). Kështu që, edhe rruga e tyre për tek e vërteta, për tek Allahu (xh.xh.), është më e shkurtër dhe nuk ka nevojë për keramete (mrekulli). Po të hulumtohet jeta e tyre, do të vihet re se ata kanë shfaqur shumë pak keramete (mrekulli).

A kanë pasur sahabet keramete, që kanë shërbyer si frymëzim për ata vetë dhe për njerëzit përreth ose si paralajmërim para se të

ndodhte diçka? Përgjigjja e kësaj pyetjeje është “Po.” Patjetër që kanë pasur keramete të tilla, por ata kurrë nuk ia kanë kërkuar Zotit ato. Madje i kanë konsideruar kerametet si sprovë nga Zoti dhe, kur iu jepeshin, mundoheshin t’i mbanin të fshehta. Por, edhe pse janë treguar të kujdesshëm në fshehjen e tyre, ka pasur edhe raste kur nuk kanë mundur t’i shpëtojnë shikimit të njerëzve.

Për shembull, ndërsa po predikonte hutben, Omerit (Zqkmt) i shfaqet para syve gjendja e vështirë e ushtrisë që kishte dërguar për në Iran. Në atë situatë, ai i flet komandantit të ushtrisë: “Sarije, shiko nga mali!” Edhe pse ndodhet shumë larg Omerit (Zqkmt), komandanti Sarije e dëgjon zërin e tij, e vëren kurthin e armikut në anën e malit, i merr menjëherë masat dhe e fiton betejën.

Disa prej sahabeve të nderuar u pranoheshin në çast lutjet që bënin. Ashtu siç ka thënë dhe i Dërguari i Allahut (pqmt), “Ka nga ata njerëz me pamje të mjeruar që, po të betohen në lidhje me ndonjë çështje në emër të Allahut, Ai nuk i nxjerr ata gënjeshtarë.” Pra, Allahu e pranon fjalën e tyre dhe e përmbush atë. Bera bin Malik ishte njëri prej tyre. Madje ka edhe transmetime të tilla, që thonë se, kur myslimanët gjendeshin në vështirësi gjatë luftë, sahabet shkonin pranë Bera bin Malik dhe i thoshnin: “Betohu që do ta fitojmë luftën, se Allahu ty nuk të nxjerr gënjeshtar!”

Sad ibn Ebu Vakkas (Zqkmt) ishte një tjetër sahabe, lutja e të cilit pranohej menjëherë. Një ditë, ndërsa Aliu, Zybejr ibn Avvam dhe Talha ibn Ubejdullah (Zqkmt) po ecnin nëpër rrugët e Kufes në Irak, Sad ibn Ebu Vakkas dëgjoi një person t’i ofendonte rëndë ata. E qortoi dhe e porositi disa herë që të fliste fjalë të bukura ose të heshte. Por personi në fjalë nuk bëri asnjë hap pas, përkundrazi, vijoi t’i shante tre sahabet e nderuar. Pas njëfarë kohe, Sad ibn Ebi Vakkas ngriti duart drejt qiellit dhe iu lut Zotit: “O Allahu im, jepi atë çka meriton këtij njeriu, në mënyrë që dhe njerëzit e tjerë të nxjerrin mësim prej tij!”

Pa kaluar shumë kohë, një deve, që rendte si e çmendur e që nuk u kuptua nga erdhi, iu afrua me shpejtësi turmës së njerëzve. Dukej sikur kërkonte pikërisht atë njeri, të cilin, më në fund, e gjeti diku në

mes të turmës. E përplasi dhe e shkeli me këmbë derisa përsoni në fjalë ndërroi jetë para syve të të pranishmëve.

Pra, në mesin e sahabeve, ka pasur edhe prej atyre që, edhe pse nuk ia kërkonin Zotit diçka të atillë, kanë shfaqur keramete dhe janë gjendur në të tilla situata. Sahabet mundoheshin që të fitonin kënaqësinë e Zotit me çdo veprim që bënin, përpiqeshin të jetonin në përputhje me udhëzimet hyjnore dhe të thelloheshin në botën e tyre shpirtërore. Ndërkohë, Zoti i begatonte ata me të tilla keramete (mrekulli).

Sakrificat e sahabeve në misionin e kumtimit të fesë

“Sahabe” quhet çdokush që e ka parë të Dërguarin e Allahut (pqmt) me sytë e vet, që ka jetuar pak kohë pranë Tij dhe që i ka besuar Atij si profet.

Pas profetëve, sahabet janë njerëzit më të mëdhenj të njerëzimit. Ata janë edukuar drejtpërsëdrejti nga i Dërguari i Zotit (pqmt). Por nuk mund të themi se sahabet janë të gjithë në të njëjtën gradë. Patjetër që edhe ata kanë grada të ndryshme devotshmërie. Ata të cilët besuan në momentet më të vështira, pra, në periudhën e Mekes, ata të cilët besuan pas emigrimit për në Medine dhe ata të cilët besuan pas çlirimit të Mekes, me shumë mundësi u përkasin gradave të ndryshme. Kështu është shprehur kjo çështje në Kuran dhe Sunet (traditën profetike). Në ajetet përkatëse shpaloset qartë ndryshimi në gradë mes muhaxhirëve (emigrantëve) dhe ensarëve (mikpritësve) të parë⁴⁶, ashtu siç shprehet edhe ndryshimi mes atyre që besuan dhe u përpoqën për fenë e Allahut para çlirimit të Mekes nga ata të cilët besuan dhe u përpoqën pas çlirimit të saj.⁴⁷ Këtë ndryshim e hasim edhe te hadithet e të Dërguarit të Allahut (pqmt). Gjithsesi, Ibn Hazmi, duke shprehur edhe mendimin e shumë interpretuesëve të tjerë të Islamit, thotë: “Të gjithë sahabet janë *ehli Xhenet* (banorë të parajsës).”⁴⁸

⁴⁶ Surja Teube, ajeti 100

⁴⁷ Surja Hadid, ajeti 10

⁴⁸ Ibn Haxher, 1/10

Sahabet në Kuran

Sahabet e nderuar përmenden në një sërë ajetesh të Kuranit Famëlartë.

“Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të (sahabet), janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre. Ti i sheh ata si përkulen (në ruku) dhe bien në sexhde, duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e Allahut. Në fytyrat e tyre dallohen shenjat e sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Teurat. Ndërsa në Ungjill, shembulli i tyre përshkruhet si një farë e mbjellë që lëshon filiza e forcohet, dhe pastaj ngrihet e fortë me kërcellin e vet, duke i gëzuar mbjellësit. (Kështu përshkruhen ata,) me qëllim që, nëpërmjet tyre, Ai t'i zemërojë mohuesit. Për ata midis tyre, që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, Allahu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh.”⁴⁹

“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve dhe ensarëve, Allahu është i kënaqur me ta dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Atë. Allahu ka përgatitur për ta kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!”⁵⁰

Duke theksuar se ajetet në të cilët përmenden sahabet janë të shumtë, këtu po mjaftohemi me kaq.⁵¹

Sahabet në hadithe

“Mos thoni fjalë të pahijshme për shokët e mi (sahabet)! Edhe sikur ndonjëri prej jush të ketë aq flori sa mali i Uhudit dhe ta shpenzojë atë në rrugë të Allahut, përsëri nuk mund të krahasohet as me një grusht (të holla) të shpenzuar nga ata (në këtë rrugë).”⁵²

“Njerëzit më të hairit (mirë) janë ata që jetojnë në shekullin që jetoj

⁴⁹ Surja Fet’h, ajeti 29

⁵⁰ Surja Tevbe, ajeti 100

⁵¹ Surja Bakare, 207, 218; Surja Âl-i Imrân, 172, 195; Surja En’âm, 51-53; Surja Enfâl, 64, 74; Surja Tövbe, 19-22, 88-89; 117; Surja Nahl, 41-42; Surja Hac, 58-59; Surja Ahzâb, 23; Surja Fetih, 18; Surja Haşr, 9

⁵² Buhari, Fezailul-Es’hab 5; Muslim, Fezailus-Sahabe 221

unë. Pastaj renditen ata që vijnë pas tyre (Tabiin) dhe ata që vijnë pas këtyre të fundit (Tebei Tabiin).⁵³

“Allahu i mallkoftë ata që flasin keq për shokët e mi! I mallkofshin engjëjt, mbi ta qoftë edhe mallkimi i njerëzve!”⁵⁴

Rëndësia e kumtimit të fesë

Kumtimi i fesë (teblig) është kumtimi dhe përhapja e asaj që konsiderohet e mirë dhe të ftuarit e çdokujt për ta pranuar atë. Kumtimi i fesë është qëllimi i dërgimit të profetëve. Në një sërë ajetesh të Kuranit Famëllartë, shprehet qartë se detyra kryesore e profetëve është kumtimi (teblig).⁵⁵

Në kumtimin e Islamit, të gjithë njerëzit janë të barabartë. T’ua shpjegosh Islamit të tjerëve është një përgjegjësi e të gjithë myslimanëve pa dallim race, ngjyre, periudhe kohore, vendi e gjeografie. Sepse të ftuarit e dikujt për të pranuar Islamit nuk ishte veçori vetëm e Hz. Muhamedit (pqmt) dhe e shokëve të tij, sidomos kur dihet se pas Muhamedit (pqmt) nuk do të vijë një peygamber tjetër. Ndërkohë, Allahu në Kuran thotë: *“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”⁵⁶*

Durimi dhe sakrificat e sahabeve

Idhujtarët e Mekes bënë presion dhe i torturonin të Dërguarin e Zotit dhe ata të cilët besuan në fenë e kulluar, fenë islame. Mekasit i spiunonin të gjithë ata të cilët e takonin Muhamedin (pqmt) dhe, si pasojë e kësaj, ata burgoseshin, rriheshin, liheshin pa ngrënë e pa pirë dhe torturoheshin në mënyrat më çnjerëzore. Për shembull, i shtrinin të zhveshur mbi rërën e nxehtë. Në mesin e atyre që ishin të ekspozuar ndaj kësaj dhune nuk gjendeshin vetëm të dobëtit dhe ata

⁵³ Buhari, Fezailul-Es’hab 1; Muslim, Fezailus-Sahabe 212

⁵⁴ Mecmau’z-Zevâid, 10/21; Kenzu’l-Ummâl, 11/531(32477)

⁵⁵ Surja Al-i Imrân, 20; Surja Mâide, 92, 99; Surja Ra’d, 40; Surja Nahl, 35,82; Surja Nûr, 54; Surja Jasin, 17

⁵⁶ Ali Imran, 104

pa mbështetje si Bilal Habeshi, Amar Suhejbi apo Habab ibn Eret, por edhe ata me status të lartë në shoqërinë e asaj kohe dhe në gjendje të mirë ekonomike, siç ishte edhe Musab ibn Umejr, një ndër të rinjtë më në zë dhe më të kamur të Mekes. Deri në momentin kur pranoi Islam, ai qe një djalosh që i jepte rëndësi veshjes në mënyrë të hijshme dhe të ushqyerit mirë. E para që i doli kundër atij qe familja e tij. Shkëputën me të lidhjet derisa ai ndërroi jetë.⁵⁷ Madje, kur ra shehid (dëshmor) në Uhud, Musab ibn Umejr, ky djalosh aq i pasur në të shkuarën, nuk kishte as një rrobë të mjaftueshme për qefin.⁵⁸

Hixhreti (emigrimi)

Hixhret do të thotë të braktisësh vendin tënd për të mirën e fesë. Këtë bëri edhe Muhamedi, i Dërguari i Zotit (pqmt) në vitin 622, duke u larguar nga idhujtaria e mekasve për në Medine, për në qytetin e zemrave të buta dhe të etura për besim të pastër. Mizoria e idhujtarëve të Mekes i detyroi myslimanët të braktisnin vendlindjen, familjen dhe pasurinë e tyre. Ndër ta ishin edhe Ebu Bekiri i besës, Omeri i fuqishëm dhe Osmani i pasur. Ata ishin njerëz me status të lartë në atë shoqëri, por që u detyruan të largoheshin duke lënë pas familjet dhe pasuritë e tyre. U detyruan të bënin 450 km rrugë në shkretëtirën e nxehtë, pa ditur as se çfarë do të hanin e do të pinin gjatë 15 ditëve të atij udhëtimi shumë të vështirë. Këta njerëz të ndershëm dhe krenarë u ndihmuan nga medinasit mikpritës, që, më pas, u quajtën ensarë.

Vuajtje mbi vuajtje! Sakrificë mbi sakrificë! Por ata njerëz të papërsëritur në historinë e njerëzimit duruan pa kundërshtuar qoftë edhe një herë të vetme caktimin e Zotit të tyre. Pse? Sepse Mbreti i fjalës (pqmt) u thoshte: “Duroni, sepse vendi ku do të shkoni është Xheneti!”

Përfundime

Për aq kohë sa do të vijojë njerëzimi, ata që sakrifikojnë për këtë fe nuk kanë për të munguar asnjëherë. Ndoshta do të ketë sulme dhe

⁵⁷ İbn Hacer, 3/421

⁵⁸ Buhârî, Cenâiz 28

goditje të shumëllojshme ndaj fesë së Zotit, por, ashtu si sahabet në kohën e tyre, gjithmonë do të ketë durimtarë dhe sakrifikues të këtij misioni. Ka për të pasur njerëz që, për të shpjeguar fenë e Zotit, do të sakrifkohen rehatinë e kësaj bote dhe, ashtu si sahabet, do të shpërndahen në vende të ndryshme të botës, në ato vende ku njerëzit janë të etur për besim dhe vlera njerëzore që burojnë nga hyjnorja. Patjetër që organizimi dhe bashkimi i besimtarëve të këtij shekulli për të ringjallur fenë e Allahut dhe të të Dërguarit të Tij (pqmt) do e kënaqë Krijuesin dhe Profetin tonë. Këtë e themi duke u bazuar në fjalët e të Dërguarit të Allahut (pqmt), i Cili, rreth 15 shekuj më parë, pak para se të ndahej nga kjo botë, tha: “Bëjini selam vëllezërve të mi!” Kur sahabet e pyetën me fjalët “A nuk jemi ne vëllezërit e tu?”, Ai u përgjigj kështu: “Ju jeni shokët e mi, vëllezërit e mi nuk kanë ardhur akoma. Ata do të vijnë më pas. Do të vijnë në një kohë të vështirë, atëherë kur feja e Zotit do të nëpërkëmbet dhe Kurani do të braktiset e sulmohet.” Ata do të jenë mbrojtësit e tyre. Do t’i mbrojnë ato duke sakrifikuar ashtu si sahabet, duke braktisur rehatinë, mallin, pasurinë dhe vendlindjen, sa që njerëzit do të habiten kur t’i shohin. E, ashtu siç thuhej dikur për sahabet, “Këta janë të çmendur!” do të thuhet edhe për ta.

Allahu na mundësoftë një besim të shëndoshë dhe një zemër të ndjeshme ndaj fesë së Tij dhe na mundësoftë që, me veprat tona, të ndjekim rrugën e të Dërguarit të Tij (pqmt) dhe të sahabeve të nderuar.

Urtësia në dërgimin e profetëve dhe librave

Njerëzimi ka nevojë për librat hyjnorë. Është e pamundur që qeniet njerëzore t'i zgjidhin vetë problemet e tyre. Kjo gjë mund të arrihet vetëm nëpërmjet mësimave të mesazheve hyjnore. Prandaj, bashkë me njeriun e parë, Allahu (xhel'le xhelâluhu) dërgoi edhe disa faqe, të cilat përmbanin mesazhe hyjnore. Faqet që iu dhanë profetit Adem u derguan përmes shpalljes, ashtu si Kurani. Pas kësaj, Hz. Ademi i mbajti shënim ato që iu shpallën, duke i shkruar në letra. Pra, shkrimi nuk u zbulua më vonë, siç mund të mendojnë disa. Përkundrazi, shkrimi filloi me njeriun e parë, me profetin Adem, sepse Zoti i Plotfuqishëm e mësoi profetin Adem përmes shpalljes. Përndryshe, si do të ishte e mundur të zbuloheshin faqet që i qenë dërguar atij?

Këto faqe nuk zbritën nga qielli të shkruara. Një mënyrë e tillë nuk është hasur kurrë në mesin e llojeve të shpalljes. As në Kuran, as në hadithe nuk përmendet një formë shpalljeje që të jetë dërguar e shkruar qartë në letër. Ajeti 51 i sures Shura e mbeshtet këtë. Në kuadër të kësaj, për ato që iu shpallën profetit Adem, mund të thuhet se ato faqe u dërguan dhe, më vonë, u shkruan prej tij. Pra, Zoti i Plotfuqishëm ia mësoi Hz. Ademit të gjitha dijet e nevojshme në mënyrë të përmbledhur. Ato që shpjegohen pas kësaj, duke i diskutuar më gjerësisht temat, janë përshkrime në përputhje me epokën dhe rrethanat. Nëse çështja analizohet nga ky këndvështrim, arrihet në konkluzionet e mëposhtme:

Në thelb, nuk ka asnjë ndryshim midis faqeve që i janë dërguar

profetit Adem dhe faqeve ose librave që i janë dërguar profetëve të tjerë. Kurse, për sa i përket parimeve themelore, çfarëdolloj gjëje që parashtrahet në faqet e zbritura të parat, parashtrahet edhe në librin e fundit, pra, në Kuran. Ndryshimi qëndron vetëm në trajtimin dhe përshkrimin e tyre. Gjithçka që iu shpjegua shkurtimisht profetit Adem, profetit Muhamed iu shpjegua gjerësisht dhe me detaje. Me fjalë të tjera, nëse ajo që iu tregua profetit Adem është fara, Profetit tonë iu tregua pema, tashmë me degët, nyjet dhe frutat e saj. Sidoqoftë, edhe në këtë metodë ekziston një sistem i ndërtuar mrekullisht. Së pari, meqenëse njerëzit e hershëm nuk ishin shumë të zhvilluar për sa i përket perceptimit dhe ideve, ishte e nevojshme që shpalljet të ishin në një nivel të kuptueshëm për ta. Prandaj nuk ishin të hollësishme shpalljet. Stili dhe formulimi i tyre ishte sikur po mësonin një fëmijë të shkollës fillore, sepse niveli i përgjithshëm një qasje të tillë kërkonte. Informacioni që do t'i jepej njerëzve të parë, të cilët ishin larg njohjes së shumë dinamikave, duhet të ishte sipërfaqësor. Sidoqoftë, të gjitha të vërtetat e përshkruara në Kuran gjenden edhe në faqet që iu dhanë profetit Adem dhe ky është fakt që mund të vërehet nga kushdo që ka bërë studimet përkatëse.

Kjo vlen edhe për librat e tjerë që janë zbritur. Me fjalë të tjera, të vërtetat e Kuranit mund të gjenden përgjithësisht edhe në Teurat (Torah) dhe Bibël. Është e vërtetë që ka disa ndryshime, madje edhe shtrembërime, kur ato përkthehen nga gjuha origjinale në një gjuhë tjetër. Është shumë e vështirë të gjesh tekstet origjinale të këtyre librave, të cilët janë ndryshuar ose janë shtrembëruar vazhdimisht edhe nga përkthimet. Në këtë raste, nuk është e mundur të gjesh në to Kuranin.

Është e qartë se, që nga momenti kur njeriu i parë u zbrit në tokë, njerëzimi është pajisur me një mesazh hyjnor që do ta udhëheqë atë në jetën e tij, do t'ia organizojë jetën individuale, familjare, shoqërore dhe do ta drejtojë atë drejt hairit (së mirës), së bukurës, së mbarës dhe së drejtës. Kjo tregon qartë se, pa udhëzimin hyjnor, njerëzit nuk do të ishin në gjendje të zgjidhnin asnjë prej problemeve të tyre. Në fakt, kjo është në përputhje me krijimin dhe natyrën njerëzore. Siç u cek edhe më sipër, mund të thuhet se Allahu i Madhërishëm e krijoi universin

në formën e një libri. Një person që ndeshet me librin madhështor të quajtur gjithësi, ka nevojë për një udhëzues që t'ia shpjegojë dhe tregojë atij këtë libër. Profetët dhe librat qiellorë që u dërguan me ta kanë qenë gjithmonë udhëzues të pagabueshëm për njerëzimin.

Libri i universit ka aspekte që e tërheqin njeriun. Për shembull, kur shqyrton librin e universit, njeriu, ashtu si bleta, do të formojë një huall mjalti me ato çfarë ka kuptuar nga ai libër madhështor i shkruar nga Fuqia dhe Vullneti Hyjnor. Do t'i besojë zemrës dhe mendjes së vet me ato çfarë kupton që nga fara e deri te rrënjët e kësaj peme të madhe, nga degët dhe sythet, nga lulja e frytet e saj. Zemra dhe mendja e tij do t'i shqyrtojnë ato që ai sheh dhe do të përpiqen të kuptojnë atë çfarë është dashur të shpjegohet në to. Sidoqoftë, në rast se udhëzimi do të mungonte, njeriu nuk do të ishte në gjendje të kuptonte dhe konceptonte ato çfarë shihte. Kjo do të ishte një situatë e pashmangshme. Këtë mund ta shpjegojmë nëpërmjet shembullit të mëposhtëm:

Le të mendojmë një person që nuk ka parë kurrë një xhami ose një xhemat në jetën e vet. Le ta shoqërojmë këtë person në një xhami madhështore dhe t'i kërkojmë të vlerësojë ato që sheh brenda saj... Pa dyshim, ky person do të shohë me sy të hutuar dhe nuk do të mundet të bëjë ndonjë vlerësim... Ai nuk ka si ta dijë çfarë është minberi, për çfarë shërben mihrabi dhe çfarë bëhet në kursije. Ai nuk ka se si ta kuptojë pse njerëzit qëndrojnë pas një imami dhe falen njëzëri. Edhe nëse ky person është gjeni i një fushe tjetër, në xhami do të jetë si një fëmijë. Ai nuk ka informacion mbi rregullat e xhamisë dhe veprimet që kryhen në të. Nuk ia ka idenë dhe nuk do të jetë në gjendje të thotë gjë. Pa një mësues a udhërrëfyes, është e pamundur të dihet se për çfarë shërben një xhami dhe çfarë qëllimesh kanë orenditë në të.

Po, situata e një personi që hyn në xhaminë e universit pa udhëzim nuk është e ndryshme. Ai do të shikojë mijëra e miliona lloje të ndryshme bimësh që rriten, lulëzojnë dhe japin frytet e tyre çdo pranverë. Ai do të përpiqet t'i kuptojë ato dhe, me kalimin e kohës, do të orvatet për t'i dhënë një shpjegim të gjitha dukurive që vëren në natyrë. Shumë gjëra do i quajë "ligje të natyrës". Në qiell do të dallojë yje të shumta

që vezullojnë, por, duke qenë i painformuar në lidhje me të vërtetën, ai do u referohet edhe atyre si “ligje të natyrës”. Edhe pse fizika dhe kimia, me gjuhët e tyre të ndryshme, i tregojnë për harmoninë midis krijesave, rregullin dhe faktin se asgjë nuk është e kotë, ai do të mendojë se kupton gjithçka, por meritën e këtij rregulli dhe kësaj harmonie do ia japë gjërave që e rrethojnë, jo Krijuesit të tyre.

Me fjalë të tjera, pa udhëzimin e profetëve, njeriu nuk do të jetë në gjendje të gjejë të vërtetën me atë që sheh, di, ndien dhe dëgjon. Ai nuk do të jetë në gjendje të shpëtojë nga errësira e injorancës dhe të arrijë dritën “ndriçuese”. Në fakt, shkenca që nuk e çon një person drejt njohjes së Allahut nuk është shkencë. Prandaj, injorant nuk është kush tjetër përpos atij që nuk e njeh Zotin. Po, një person që nuk e njeh Allahun, edhe sikur të dijë qindra shkenca, vështirë se i shpëton injorancës së vërtetë. Por, kur e njeh Allahun, edhe nëse nuk di të lexojë dhe të shkruajë, ai nuk mund të konsiderohet analfabet. Sepse ai njeri di atë që duhet të dinte. Ai njeh Mjeshtrin që ka ndërtuar pallatin e universit dhe Autorin Madhështor të këtij libri. Kjo është pika e fundit që shkenca duhet të arrijë. Meqenëse Allahu i Madhërishëm shkroi librin e gjithësisë, natyrisht që Ai e di më së miri atë.

Çdokush, madje edhe njerëzit më të zakonshëm, mund ta shkruajë një poezi me dy rreshta. Në ato rreshta, secili mund të fshehë sekrete që vështirë se mund të dihen nga tjetërkush, mund të vendosë nënkuptime dhe nëntekste që, veç tij, askush tjetër nuk mund t’i kuptojë. Duke marrë parasysh këtë, a nuk është krejt normale që ne të mos jemi në gjendje ta kuptojmë librin e universit, këtë libër ku janë mbledhur me mijëra gjëra të panjohura për ne e të ndërlikuara, a nuk është e nevojshme të kemi një mësues dhe një udhëzues, që të na i shpjegojnë çështjet komplekse të këtij libri? Ja, pra, këtyre mësuesve u është dhënë emri “Profet”, ndërsa udhëzuesve që kanë zbritur me ta, “Libra Qiellorë”.

Pa profetët dhe librat hyjnorë, zbulimi i të vërtetës së mirëfilltë është i pamundur. Kjo dëshmohet më së miri nga pika ku filozofia ka arritur në ditët tona. Me mijëra filozofë, të cilët për shekuj me radhë janë përpjekur të gjejnë të vërtetën, nuk kanë rënë ndonjëherë dakord

në një linjë të caktuar, madje as kur kanë qenë pjesë e së njëjtës shkollë mendimi. Megjithëse racionalistë që të dy, Aristoteli dhe Dekarti kanë pikëpamje dhe mendime të ndryshme nga njëri-tjetri... Dhe secili e shpreh të vërtetën e vet në një mënyrë komplet të ndryshme. Idetë e Platonit për ekzistencën janë qaq të largëta nga ato të Aristotelit, Sokratit apo edhe ato të Dekartit.

Mund të thuhet se ndryshimi është aq i thellë, sa duket sikur kundërshtojnë njëri-tjetrin, sikur dakordësia mes tyre është diçka e pamundur. Ky ndryshim na tregon se mendja abstrakte njerëzore nuk mjafton për të kuptuar dhe konceptuar të vërtetën e përsosur. Nuk mjafton, sepse, edhe kur lexohen rreshtat e librit të universit, të shkruara me vija të trasha aq sa për t'u parë nga të gjithë, lindin të tilla polemika. Sidoqoftë, rreshtat e librat të universit janë shkruar me vija të trasha dhe të dukshme, që të mund t'i shohin edhe të verbërit. Në këtë strukturë, yjet janë kthyer në fjalë, mjegullnajat kanë formuar radhët, ndërsa sistemet e tilla si galaktika dhe Rruga e Qumështit janë si paragrafe.

Si mundet vallë t'i lexojë çështjet e thella, të fshehta dhe delikate të strukturës shpirtërore të qenies njerëzore një person që nuk është në gjendje t'i lexojë këto shkrime? Si mundet t'i lexojë dhe t'i zgjidhë problematikat pedagogjike, psikologjike dhe sociale të njerëzimit...?! Guximi për ta bërë këtë është veçse tregues i konfuzionit dhe injorancës. Njerëzit e sotëm kanë jetuar të mashtruar nga një injorancë kësisoj për shumë vite.

Është Allahu (xhel'le xhelâluhu) Ai që e ka shkruar këtë libër të universit. Ai e ka vendosur marrëdhënien midis njeriut dhe këtij libri, duke e bërë njeriun një tregues të këtij libri të madh ashtu siç shfaqet deti në një pikë uji. Në dritën e kësaj kuptohet se vetëm Ai mund ta dijë kuptimin dhe natyrën e këtij universi. Ai i njeh prirjet njerëzore, botën e brendshme të njeriut dhe strukturën e tij fiziko-shpirtërore. Sepse gjithësia është krijim i Allahut, njeriu është "*abdullah*", rob i Zotit, dhe Kurani, i cili analizon anatominë e tyre, është "*kelamullah*", fjala e Zotit. Kështu, Allahu është Ai që i njeh më mirë marrëdhëniet

midis librit dhe robrit, pasi është Ai që e krijoi një marrëdhënie të tillë. Për rrjedhojë, vetëm Atij i takon e drejta për të folur në lidhje me këtë temë. Njohuritë e Tij përfshijnë gjithçka. Në qoftë se Ai nuk ia tregon atij, njeriu nuk mund të dijë asgjë.

Duhet të kemi gjithmonë parasysh ajetin “... **ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron...**”. Siç ka thënë edhe profeti Hidr, “dituria e të gjithë njerëzve marrë së bashku, në krahasim me diturinë e Zotit të Plotfuqishëm, është aq sa uji në sqepin e një zogu në krahasim me ujin e oqeanit.”. Kaq është dituria për të cilën njerëzit thonë me gojën plot “Ne e dimë!”. Gjithsesi, në oqeanin e diturisë ka shkenca që duhet të dihen dhe mësohen më thellësisht, sepse njerëzit janë injorantë të atyre fushave. Fatkeqësisht, njeriu pandeh se është i mençur dhe ky është një dimension i errët i injorancës së tij. Është më se e qartë, një person i varrosur në errësirën e një injorance të këfillë do të ketë gjykime absurde dhe të pasakta edhe për veten. Në udhëzimet dhe vendimet hyjnore ama, saktësia është e padiskutueshme.

Në thelb, po sqarohet se, nëse njerëzimi ia lë në dorë Zotit të Plotfuqishëm çështjet e veta dhe i trajton ato në dritën e udhëzimeve të librit të Tij të mrekullueshëm, ai do të çlirohet nga trazirat materiale e shpirtërore, nga ato individuale, familjare e shoqërore, si dhe nga kaosi e anarkia, dhe do të jetojë në klimën e artë të paqes, prosperitetit dhe lumturisë së vërtetë. Përndryshe, fundi tragjik do të jetë fati i pandryshueshëm i njerëzimit.

Zoti i Plotfuqishëm e shpëtoi njerëzimin nga ky fat tragjik me librat që dërgoi, çfarë është tregues i mëshirës së Tij të madhe. Për më tepër, në epokën tonë, në këtë kohë kur kjo çështje ka një rëndësi të shtuar, Ai i dërgoi njerëzimit librin më të përsosur.

Veçoritë fizike të Profetit tonë (pqmt)

Cilat ishin veçoritë fizike të Profetit tonë (pqmt)?

Nëse i referohemi kritereve të bukurisë nga aspekti i krijimit, pra, nga pikëpamja fizike, te Zotëria i Universit (pqmt) ishin mbledhur të gjitha veçoritë e bukurisë. Kjo theksohet edhe nga Imam Kurtubi: “Vetëm disa prej cilësive të bukura të mbledhura te Profeti ynë (pqmt) ishin të dukshme. Sidoqoftë, nëse gjithçka do të ishte e dukshme, sahabet nuk do të ishin në gjendje ta shikonin atë bukurri.”

Sahabet kanë transmetuar mjaft informacion në lidhje me këtë çështje. Në mesin e këtyre sahabeve mund të përmendet Hz. Aliu (Zqkmt), Bera ibn Azibi (Zqkmt), Hz. Aisheja (Zqkmt), Ebu Xhuhajfe (Zqkmt), Xhabir bin Semura (Zqkmt), Ibn Abasi (Zqkmt), Muarrid bin Muajkib (Zqkmt), Ebu'l-Tufejl (Zqkmt), Addâ ibn Halid (Zqkmt), Hurejm bin Fatek (Zqkmt) dhe Hakim ibn Hizam (Zqkmt). Por ka edhe sahabe të tjerë që kanë treguar për cilësitë e Profetit tonë (pqmt) në këtë aspekt. Këtu po sjellim përshkrimin e tipareve të Profetit tonë (pqmt) ashtu siç është transmetuar nga Hz. Aliu (Zqkmt). Duke iu referuar veçorive të bukura dhe pamjes së përsosmërisë, pra, asaj të Muhamedit, profetit të së bukururës (pqmt), Hz. Aliu (Zqkmt) shprehte veçoritë e mëposhtme:

Profeti ynë (paqja qoftë mbi të) nuk ishte as i gjatë, as i shkurtër. Ai kishte një gjatësi mesatare, por më afër asaj që mund të konsiderohet e gjatë. Flokët e tij nuk ishin as kaçurrela, as të drejta, por diçka mes flokëve kaçurrela dhe atyre të drejtë. Fytyra e tij ndritur nuk ishte as e

rrumbullakët dhe e mbushur, por as e gjatë dhe thatime. Ai kishte një fytyrë të plotë dhe të ndriçuar. Lëkurën e kishte të butë, në një ngjyrë rozë të trëndafiltë. Sytë i kishte të zinj, kurse qerpikët, të gjatë. Ishte kockëmadh dhe me supe të gjera. Qimet e pakta të trupin e tij, ishin më të spikatura në pjesën e kraharorit. Duart dhe këmbët e tij të bekuara ishin të mbushura. Ndërsa shëtiste, Ai ecte me ëmbëlsi, e vendoste këmbën në tokë me vendosmëri, thua se po zbriste nga një e tatëpjetë. Kur donte të fliste me dikë ose të shikonte diçka, Ai kthehej i tëri në atë drejtim.

Mes shpatullave të tij gjendej vula e profetësisë. Pa dyshim që Ai do e kishte të vendosur vulën e Pejgamberit te fundit. Ai ishte më zemërgjeri mes njerëzve. Ishte më fjalëdrejti. Kishte karakterin më të butë. Në jetën e përditshme, Atë e karakterizonte mirësjellja. Ishte më i njerëzishmi dhe më bujari. Ne komunikim, më i kujdeshshmi, më i edukuari dhe më i ëmbli Ai ishte. Kushdo që të ishte ai që e shihte Atë për herë të parë, patjetër që do i ngrohej menjëherë zemra ndaj Tij dhe do fillonte të ushqente ndenja pozitive për Të; ata që hynin në atmosferën e tij dhe kishin nderin për ta njohur Atë nga afër, mahniteshin, ndikoheshin patjetër nga madhështia e tij, lidheshin fort dhe në mënyrë të pandashme me Të. Kushdo që dëshironte ta përmendte të Dërguarin e Allahut (pqmt), duke pranuar pafuqinë e vet, thoshte: “As para e as pas Tij nuk kam parë dikë si Ai, dhe nuk ka mundësi që të shoh dikë tjetër si Ai!”

O Zot, paqja, bekimet, përsëndetjet e perzemërta, selamet tona dhe çdo nderim qofshin mbi Të, familjen dhe sahabet e tij!

Berâ ibn Azib (Zqkmt) vëren: “Nuk kam parë kurrë brenda një rrobe njeri më të bukur se i Dërguari i Allahut (sal’lallahu alejhi ue sel’lem)!”

Ebu Hurejre (Zqkmt) thotë: “Nuk kam parë kurrë dikë më të bukur se i Dërguari i Allahut (pqmt)! Dielli sikur çelte në fytyrën e tij. Buzëqeshja e tij, me ata dhëmbë të bardhë, ndriçonte edhe muret!”

Në një tjetër rast, dikush erdhi dhe i tha Berait: “Fytyra e Profetit tonë shkëlqen si shpata.” Berai iu pergjigj: “Jo! Fytyrat e bekuar e të Dërguarit të Allahut është si dielli, si hëna!” Zotëria i të gjithë zotërinjve

e kishte fytyrën të plotë.

Ummu Ma'bed (Zqkmt) është një prej sahabeve gra të fisit Huza. Në një përshkrim të gjatë që i bën Profetit tonë (pqmt), ajo thotë: “Kur e shihje nga larg, Ai ishte më i bukuri i të gjithë njerëzve, kurse nga afër, Ai ishte më i ëmbli i të gjithë njerëzve!”

Sipas transmetimeve të Ebu Hale, “fytyra e bekuar e Pejgamberit shkëlqente ashtu si shkëlqen hëna e plotë”.

Lëkura e Profetit (paqja qoftë mbi Të) kishte një lloj arome të veçantë. Pikat e djersës që rridhnin nga fytyra e tij e bekuar përngjasonin me perlat. Lëkura e tij e bekuar ishte shumë e butë. Kështu transmeton Hz. Enesi (r.a.), i cili thotë: “Ngjyra e lëkurës së Pejgamberit (pqmt) ishte e trëndafiltë. Pikat e djersës se tij dukeshin si perla. Mëndafshi nuk është më i butë se lëkura e tij. As misku dhe as qelibari nuk kanë aromë më të këndshme se era e trupit të tij.”

Teksa përshkruante Profetin tonë (pqmt), Bera ibn Azib (Zqkmt) thoshte kështu: “Qimet e bekuara të profetit Muhamed në trupin e tij të bekuar, flokët mbi kokë dhe qimet në mjekrën e tij ishin diçka midis atyre kaçurrele dhe atyre të drejta. Trupi i Tij ishte *mu'tedilü'l-makam* (me gjatësi të mesme). Profeti Muhamed (pqmt), shpatullat i kishte të gjera. Edhe gjoksin e bekuar e kishte të gjerë.”

I Dërguari i Allahut, flokët, që i derdheshin nga koka, i kishte të dendura. Flokët i arrinin deri te bula e veshit. Në fakt, ka pasur transmetime të ndryshme në lidhje me gjatësinë e flokëve të bekuara të Profetit tonë (pqmt). Sipas një transmetimi, flokët e tij arrinin deri te gjysma e veshëve. Sipas një transmetimi tjetër, flokët i arrinin deri poshtë veshëve. Sipas një tjetër transmetimi, flokët e tij zgjateshin deri pak mbi shpatullat e tij të bekuara, kurse në një tjetër transmetim thuhet se flokët i derdheshin deri te shpatullat. Nga këto kuptohet se Profeti ynë (pqmt) i kishte zgjatur flokët e tij të bekuara deri te shpatullat dhe, më vonë, i kishte shkurtuar ato deri te veshët.

Imam Nevevi tregon se veshja e Profetit ishte një “hulle”, pra, një veshje me dy pjesë. Këto dy pjesë quhen “izar” dhe “ridâ”.

Ebu Ubejde thotë se “hulle” është një rrobë e përbërë nga dy pjesë të

së njëjtës pëlhurë. Në këtë transmetim, thuhet gjithashtu se askujt nuk i shkonte ngjyra e kuqe ashtu siç i shkonte Atij. Gjithsesi, duhet theksuar fakti se rroba e kuqe që përmendet në këtë transmetim është një veshje ku gjendet edhe ngjyra e kuqe, jo një veshje tërësisht e kuqe. Duke iu referuar transmetimit të lartpërmendur, i nderuari Imam Shafiu e sheh të pranueshme veshjen e rrobave të kuqe, ndërsa Imam A'zam Ebu Hanife vlerëson se veshja e kësaj ngjyre është e ndaluar.

Kur flet për Profetin tonë (pqmt), Bera ibn Azib shprehet në këtë mënyrë: “Kurrë nuk kam parë dikë më të bukur se Zoteria ynë. Nëse do më pyesni se çfarë prisja, atëherë po ju them se nuk kam pare asgjë më të bukur se i Dërguari i Allahut. I Dërguari i Allahut ishte më i bukur se gjithçka që kam parë dhe se gjithçka që di.”

Vlera e tesbihatit të namazit

Tesbihati i namazit është sunet (traditë profetike) i profetit Muhamed (pqmt), është një thesar i mrekullueshëm dhikri (përmendjeje) i attributeve të bukura të Allahut, por edhe një thesar lutjesh dhe salavatesh. Fatkeqësisht, shumë besimtarë e neglizhojnë tesbihatin pas namazit dhe, për rrjedhojë, nuk përfitojnë nga ky thesar i madh.

Bediuzaman Said Nursi e konsideron tesbihatin e namazit si përmendje dhe lartësim të emrit të Allahut, por edhe të Profetit (pqmt). Mjeshtri i nderuar, i cili i ka kushtuar shumë rëndësi dhe e ka praktikuar tesbihatin pa devijuar prej tij përgjatë gjithë jetës, në veprën *Kastamonu Lahikasi*⁵⁹, shprehet kështu:

“Tesbihatet pas namazit janë rruga e Profetit (pqmt) dhe *viridi*⁶⁰ i trashëgimisë Muhamedane. Prandaj kanë një rëndësi të veçantë.” Në vijim, këto fjalë sqarohen në këtë formë: “Ashtu si trashëgimia Muhamedane, e cila qëndron mbi çdo trashëgimi tjetër për shkak se rrjedh nga vetë Profeti (pqmt), po ashtu edhe tesbihati pas namazit, që është rruga e kësaj trashëgimie dhe lutja e posaçme e trashëgimisë madheshtore, është po ashtu më e lartë në gradë sesa tarikatet (rrugët) dhe virdet e tjera.”

Në këto fjali, të cilat janë shkruar për të paralajmëruar besimtarët që shfaqin dembelizëm kur është momenti i tesbihatit të namazit, gjenden

⁵⁹ Shtesa e Kastamonu-së

⁶⁰ Një numër i caktuar adhurimesh, lutjesh dhe dhikresh që bëhen në një kohë apo për një periudhë të caktuar

të fshehura kaq shumë lajme të mira, saqë mund të gëzojnë gjithësinë mbarë. Pra, me fjalë të tjera, tesbihati pas namazit përfaqëson në njëfarë mënyre rrugën e Profetit (pqmt) dhe është viridi i Tij.

Le të reflektojmë pak. A është me vend neglizhimi i tesbihatit të namazit, i cili është më me vlerë dhe më i rëndësishëm se të gjitha tarikatet dhe virdet e tjera?

Vallë, a jemi të vetëdijshëm për thesarin që kemi humbur për shkak të punëve të thjeshta dhe që na pengojnë në kryerjen e këtij tesbihati, i cili nuk na merr më shumë se disa minuta pas çdo namazi?

Bediuzamani e përngjason tesbihatin pas namazit me një kuvend gjigand dhikri të drejtuar nga vetë Profeti (pqmt) dhe ku, në të njëjtën kohë, marrin pjesë miliona myslimanë.

Një mundësi e tillë dhe një përfitim shpirtëror i këtij kalibri nuk duhet braktisur kurrë, e jo më të braktiset për gjëra të kota. Por, për fat të keq, një pjesë e atyre që falin namaz, ose nuk e bëjnë fare tesbihatin, ose nuk ia japin hakun këtij adhurimi.

Tesbihati i namazit, që përbëhet nga “tesbihet, tahmidet, tekbiret, përmendja e Allahut, lutjet me dua dhe salavate, përmendja e attributeve të vyera të Allahut duke u mbështetur tek Ai”, është dylojësh: i shkurtër dhe i gjatë.

Tesbihati i shkurtër është versioni që bëhet në xhami nën udhëheqjen e imamit apo myezinit. Ky është shumë i njohur mes myslimanëve. Kurse tesbihati i gjatë është versioni që është përpiluar nga Bediuzaman Said Nursiu, i cili e ka hartuar duke iu referuar ajeteve dhe haditheve.

Le të rikujtojmë disa transmetime të sahabeve në lidhje me lutjet dhe dhikrin e Profetit (pqmt) pas namazit.

Në një transmetim të Theubanit (Zqkmt) thuhet se Profeti (pqmt), pasi mbaronte namazin, thoshte tri herë “*Estagfirullahel Adhim*” (Kërkoj falje prej Allahut të Madh); më pas vijonte lutjen me “*Allahumme entesselâmu ue minkesselâm, tebâarakte ja dhel xhelâli uel ikram.*” (Muslim, Mesâxhid: 135-136), e cila bart këtë kuptim: “Allahu im! Ti je paqja dhe paqja vjen prej Teje. O Allah i Madhërishtëm dhe

Bujar, sa mirësi dhe begati që zotëron Ti!”

Këto fjalë, që janë edhe tesbih edhe dhikr, mund të thuhet si pas namazeve nafle (suplementarë), po ashtu edhe pas namazeve farz (të detyrueshëm), pasi në këto lutje përmendet lartësia dhe madhështia e Allahut të Madhëruar. Prandaj është ndjekje e traditës profetike recitimi i tyre edhe pas namazeve sunet.

Pas kësaj lutjeje, lexohet salavati i njohur që nis me fjalët “*Salaten Tunxhina*”. Kjo është një dua shumë e dobishme, me anë të së cilës lutemi si për Profetin (pqmt), po ashtu edhe për veten tonë.

Të kujtojmë edhe këto fjalë në lidhje me teuhidin, e cila neglizhohet shumë: “Atij që thotë ‘*Lâ ilâhe il’lallâhu uahdehû lâ sherîke leh, lehul mulku ue lehul hamdu juhjû ue jumûtu ue hue hajjun lâ jemûtu bijedihil hajr ue hue alâ kul’li shej’in kadîr*’ pas namazit të sabahut dhe të akshamit pa u ngritur nga vendi, i shkruhen dhjetë sevape, i fshihen dhjetë mëkate dhe i mundësohet një lartësim prej dhjetë gradash. Atë ditë, ai njeri është i mbrojtur nga shejtani dhe çdo e keqe. Atë ditë, ai është i mbrojtur edhe prej mëkateve, përveç rastit kur bën *shirk* (idhujtari).” (Tirmidhi, Deauât: 63)

A është shumë e mundimshme të ndajmë disa minuta pas namazit për këtë gjë, e cila na mundëson fitimin e këtyre të mirave dhe begative që na janë premtuar? Cila vepër tjetër, nga ato që kryejmë në vend të tesbihatit, mund të ketë vlerën e tij? Cila prej tyre na i mundëson mirësitë që na janë premtuar nëpërmjet tesbihatit?

Një tjetër element është “Ajeti Kursi”, i cili ka vlera të veçanta gjithashtu. Në lidhje me këtë ajet, Profeti (pqmt) ka thënë: “Për atë e lexon Ajetin Kursi pas çdo namazi farz, përveç vdekjes, asgjë tjetër nuk e pengon hyrjen e tij në xhenet.” (Munau, Fejzul Kadir, 6/197)

Më pas thuhet 33 herë *Subhanallah*, 33 herë *Elhamdulillah* dhe 33 herë *Allahu Ekber*. Në një hadith të transmetuar nga Ebu Hurejre (r.a), thuhet kështu: “Atij që thotë 33 herë *Subhanallah*, 33 herë *Elhamdulillah*, 33 herë *Allahu Ekber* dhe, pastaj, ‘*Lâ ilâhe il’lallâhu uahdehû lâ sherîke leh, lehul mulku ue lehul hamdu ue hue alâ kul’li shej’in kadîr*’ menjëherë pas namazit, i falen të gjitha mëkatet edhe

sikur të jenë aq të shumtë sa shkuma e detit”. (Muslim, Mesâxhid 146)

Namazi është një adhurim unik i zbukuruar me ngjyrat e tesbiheve, tahmideve dhe tekbirove. Tesbihati që bëjmë pas namazit ia shton atij kuptimin.

Pas tesbiheve kalohet në dua, e cila është diçka personale. Pas duasë, është sunet të thuhet 33 herë “*La ilahe il’lallah*”. Edhe lutjet që gjenden në tesbihatin e gjatë kanë një rëndësi të veçantë.

Exhîrnat përbëhen nga lutje që, ose i ka bërë vetë Profeti (pqmt), ose janë nxjerrë nga ajetet kuranore. Pastaj vijnë Atributet e Allahut; të përmendësh Allahun e Madhëruar me Emrat e Tij të bukur është një adhurim i lartë dhe një mënyrë efikase për pranimin e lutjeve. Allahu i Madhëruar na ka këshilluar t’i lutemi Atij duke përmendur këto emra.

Salavatet e ndryshme, që gjenden gjithashtu edhe në tesbihat, janë një mënyrë tjetër efikase në arritjen e shefaatit (ndërmjetësimi) të Profetit (pqmt) dhe pranimin e duave tona. Nëse një besimtar nuk i neglizhon asnjëherë namazin dhe tesbihatin, i bie se ai thotë më tepër se 100 salavate në ditë.

Në mënyrë që të përfitohet prej begatisë së tesbihatit, përmbushja e tij nuk duhet neglizhuar kurrë. Nëse e kemi kohën të kufizuar, mund ta kryejmë atë edhe atëherë kur jemi duke bërë ndonjë punë tjetër. Për shembull, mund ta bëjmë tesbihatin kur jemi duke ecur, duke punuar, duke drejtuar makinën, duke bërë punët e shtëpisë e kështu me radhë. Mospërmbushja e tesbihatit ama, s’mund të jetë kurrsesi një opsion.

Në lidhje me pasazhet kuranore që themi pas namazeve, siç janë dy ajetet e fundit të sures Bekara apo tri ajetet e fundit të sures Hashr, ka porosi profetike të posaçme. Kështu, sipas transmetimeve, kushdo që reciton dy ajetet e fundit të sures Bekara pas namazit të natës fiton sevape sikur e ka kaluar gjithë natën me adhurime. Dhe, nëse ky person reciton edhe tri ajetet e fundit të sures Hashr në mëngjes, këto ndërmjetësojnë për të në arritjen e statusit të dëshmorit.

Nuk duhet t’i çojmë dëm këto mirësi dhe begati madhështore duke rënë pre e dembelizmit dhe neglizhencës sonë.

Përmbushja e tesbihatit të shkurtër dhe të gjatë çdo ditë, pas faljes së çdo namazi farz, është kusht për t'u quajtur nxënës i Risale-i Nurit dhe Bediuzamanit. Mjeshtri e thekson këtë në letrën ku bën klasifikimin e “mikut, nxënësit dhe vëllait”. Ai thotë: “Këto tri kategori e kanë kusht që të më përfshijnë në lutjet dhe përfitimet e tyre shpirtërore.” Si do të bëjë lutje për Mjeshtrin dikush që nuk bën as tesbihatin?

Kur shpjegon rrugën e “nevojës, varfërisë, dhembshurisë dhe meditimit”, ai parashtron kushtet e kësaj rruge duke thënë kështu: “Të falësh namazin sipas rregullave të tij (*tadili erkan*) dhe të bësh tesbihatin pas namazit...”

Por ja që shumë individë, të cilët kujtojnë se janë nxënës të Risale-i Nurit, e kanë kthyer tesbihatin në një vepër që kryhet për nostalgji, duke e lexuar atë vetëm në netët e mira ose në programet kolektive. Ama, nëse ky thesar do të aplikohet përditë nga pesë herë në ditë, do e kuptonim fare lehtë vlerën e tij nga përjetimet tona, sepse do ta shihnim vetë se si do të na mbushej shpirti me të.

Edukimi i grave në kohën e Profetit tonë (paqja qoftë mbi Të)

Një përmbledhje e shkurtër e situatës së grave në periudhën e injorancës

Periudha para fillimit të zbritjes së Kuranit quhet epoka e injorancës. Injoranca ishte një mënyrë jetese në atë kohë. Asokohe, jo vetëm shoqëria arabe, por bota mbarë qe kapluar nga injoranca.

Në atë periudhë, disa fise dyshonin madje nëse gruaja ishte apo jo një qenie njerëzore apo jo, kurse disa të tjerë besonin se ajo nuk kishte shpirt. Në disa vende mendohej se gruaja nuk ishte e pastër në ditët e saj të veçanta, se gjërat që përdorte dhe njerëzit që prekte bëheshin gjithashtu të papastër dhe nuk i shpëtonin dot kësaj papastërtie përgjatë një dite të tërë. Në disa vende të tjera, një grua që lexonte prej librit të shenjtë preferohej të digjej në zjarr. Në fakt, edhe leximi i fjalëve të shenjta nga gratë konsiderohej si mësim i imoralitetit. Nga ana tjetër, në shoqërinë arabe vajzat varroseshin të gjalla, ndërsa nënave nuk u jepej e drejta për të folur për to. Gruaja që lindte një vajzë fillonte të besonte se kishte kryer një krim të madh. Kur babait i thuhëj se ishte bërë me një vajzë, kur i jepej ky sihariq, atij i vinte turp nga kjo gjë. Fshihej nga e shoqja dhe shokët dhe fillonte të mendonte në lidhje me atë çfarë duhej të bënte në këtë situatë: ose do ta linte të bijën të jetonte dhe, kështu, do të jetonte edhe ai me turp, ose do ta varroste atë. Mbi këtë hidhet dritë edhe në Kuran: **“Dhe, kur ndonjëri prej tyre merr lajmin se i lindi një vajzë, fytyra i nxihet dhe i mbushet me mjerim. Ai fshihet nga njerëzit për shkak të lajmit të keq që mori dhe s’di: a**

ta mbajë këtë fëmijë, pavarësisht poshtërimit, apo ta varrosë në dhe. Ah! Sa mbrapsht që gjykojnë ata!”⁶¹

Ndryshimi që vjen me Islamin

Teksa errësira e injorancës përjetohej në mbarë botën dhe rëndonte më fort mbi gratë, lindi dielli i Islamit me ajetet: **“I Allahut është pushteti mbi qiejt dhe Tokën. Ai krijon çfarë të dojë. Ai i dhuron vajza kujt të dojë e djem kujt të dojë. Disave u dhuron të dyja gjinitë: djem e vajza; e, kë të dojë, e lë pa fëmijë. Vërtet, Ai është i Gjithëdijshëm dhe i Fuqishëm.”⁶²**

Në dritën e diellit të Islamit, grave iu hapën të gjithë rrugët e mundësitë. Tashmë gruaja ishte robëreshë e Zotit, dhe u bë e barabartë me burrat. U dha lajmi i mirë se vajzat e edukuara dhe të arsimuara do të ishin për prindërit e tyre si mburoja ndaj xhehenemit. Gruas iu dha liria dhe e drejta e fjalës; tanimë, ajo mund të shprehej fare lehtë. Asaj iu dha mundësia për të shkuar në xhami dhe për të folur në mënyrë të drejtpërdrejtë me të Dërguarin e Allahut, që t’i tregonte Atij për gjendjen e vet. Për konsultimin me gratë, shembulli u dha nga Profeti vetë, me praktikatat e Tij konkrete.⁶³

Rëndësia e Dijes

Dija është një prej çështjeve që Islami u kushton një rëndësi të veçantë. Kurani, i cili filloi të zbriste me urdhrin **“ikra”** (lexo), vijoi të theksonte dijen me fjalët **“i dituri me të paditurin nuk janë njësoj.”⁶⁴** dhe të inkurajonte me këmbëngulje jo vetëm të menduarit dhe kuriozitetin njerëzor, por edhe mësimin e diturisë, gjë kjo që kurorëzohet nëpërmjet ajetit: **“O Zoti im, shtoma dijen!”⁶⁵**

⁶¹ Nahl, 16 / 58–59

⁶² Shura, 42/49-50

⁶³ Buhari, Megazi, 1-2

⁶⁴ Shih suren Dharijat, 39/9

⁶⁵ Ta Ha, 20/114

Përveç këtyre, Kurani lavdëron dijetarët e vërtetë, pasi ata i frikësohen më fort Allahut, dhe i këshillojnë ata të pyesin për çështjet që nuk i dinë. Dija lartësohet edhe në hadithet e bekuara të të Dërguarit të Allahut (pqmt), i Cili thotë se dija është trashëgimia e vetme e profetëve⁶⁶. Ai, duke thënë se rrugët drejt Parajsës janë më të kollajta për ta dhe se engjëjt i shtrijnë krahët e tyre për dijetarët, i përgëzoi ndjekësit e diturisë.⁶⁷ Ky lajm i mirë e frymëzues, sigurisht, më së pari është për Atë vetë (pqmt), i Cili erdhi si mëshirë për botët.

Një herë, disa sahabë, të cilët e fitonin bukën e gojës duke bërë punë krahu, u ankuan te Profeti ynë (pqmt) duke thënë se vëllait të tyre, një prej kërkuesve të dijes, i sigurohej jetesa pa punuar fare. Profeti i qortoi ata me këto fjalë: “Ku e dini ju? Ndoshta për hatrin e tij po ushqeheni edhe ju!”⁶⁸

Vërtet që, sipas thënieve të të Dërguarit të Allahut (pqmt), dija jep siguri. Por jo vetëm kaq, edhe dijetarët dhe ndjekësit e dijes përmenden si krijesat më të çmuara në botë.⁶⁹ Po ashtu është raportuar se edhe ata që nisen për të fituar dije janë në rrugën e Allahut⁷⁰ derisa të kthehen në shtëpi. Edhe peshqit në det luten për ata që mësojnë dije.⁷¹

Përveç aspektit pozitiv, është shprehur edhe rreziku që sjell mosvlerësimi i dijes. Qëllimi ynë për dije duhet të jetë i pastër dhe duhet mbajtur parasysh paralajmërimi që thotë se ata që marrin dije për qëllime të kësaj bote nuk do të jenë në gjendje as për të nuhatur aromën e xhenetit.⁷² Gjithashtu duhet pasur parasysh se ata që mësojnë dituri me mendjemadhësi do të përfundojnë në xhehenem.⁷³ Besimtari duhet të kërkojë mbrojtjen e Allahut nga dijet e padobishme. Ne jemi përgëzuar me myzhdenë, e cila thotë se, nëse një person vdes

⁶⁶ Buhari, Dituria, 10

⁶⁷ Ebu Davud, Dituria, 1

⁶⁸ Tirmidhi, Zuhd, 33

⁶⁹ Tirmidhi, Zuhd, 14

⁷⁰ Tirmidhi, Dituria, 2

⁷¹ Tirmidhi, Dituria, 19

⁷² Ebu Davud, Dituria, 12

⁷³ Muslim, Imare, 152

në rrugën e dijes, do të qëndrojë me Profetët.⁷⁴ Por, në të njëjtën kohë, jemi përgëzuar edhe me lajmin se fletoret e veprave të mira të atyre që lënë pas njohuri të dobishme nuk mbyllen⁷⁵. Duhet theksuar fakti se, po ashtu si burrat, edhe gratë kanë të njëjtat të drejta, përgjegjësi dhe përfitime në të gjitha çështjet e përmendura në lidhje me rëndësinë e dijes.

Edukimi i Grave

Dija më e rëndësishme për t'u mësuar është ajo që lidhet me Allahun. Shkurtimisht, ne mund ta quajmë këtë dija e Zotit. Kjo pasohet nga dija që ka të bëjë me shtyllat e tjera të besimit, siç janë besimi në botën tjetër, besimi në engjëj, besimi në librat hyjnorë dhe besimi në të dërguarit e Allahut. Pastaj vijnë dijet që përmirësojnë jetën e njerëzve, qoftë edhe atë të një njeriu të vetëm të kësaj bote. Pas këtyre dijeve renditen çështjet morale. Pa dyshim, burrat dhe gratë janë të barabartë në mësimin e këtyre pikave. Me fjalë të tjera, për sa i përket përgjegjësive sheriatike, gratë nuk kanë ndonjë dallim nga burrat. “Gratë janë të detyruara të bëjnë gjithçka që është e detyrueshme për burrat, përveç namazit të xhumasë, xhihadit dhe namazit të xhenazes.”⁷⁶ Në lidhje me dënimet dhe shpërblimet e këtyre përgjegjësive në ahiret, gratë dhe burrat janë të barabartë. Ky fakt shprehet qartë edhe në Kuran: **“Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së tyre: ‘Unë nuk do t’ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra të mira, qoftë mashkull apo femër. Ju jeni njëlloj (në shpërblim).’”** Kjo barazi vë në dukje se, si gratë, ashtu edhe burrat, duhet të mësojnë dijet që u nevojiten.

Profeti (pqmt), kur thotë *“Nëse dikush që ka një robinjë, i jep asaj një edukim dhe një arsim të mirë e pastaj e liron, Allahu do ta shpërblejë dy herë (këtë person).”*⁷⁷, thekson se edhe robinjat kanë të drejta të barabarta me gratë e lira.

⁷⁴ Darimi, Mukadime

⁷⁵ Muslim, Vasijet

⁷⁶ Abdurrezak, 5/298

⁷⁷ Buhari, Xhihad, 145

Edukimi i grave, ajo çfarë Profeti ynë (pqmt) e inkurajonte me këmbëngulje, u praktikua në mënyrën më të mirë në Islam. Dhe gratë kurrë nuk u privuan nga kjo e drejtë. Nëse kjo gjë do të ishte bërë në një mënyrë të gabuar dhe vajzat do të ishin penguar që të merrnin edukim, siç vërehet edhe në kohën tonë në disa vende, kjo do ishte për shkak të keqkuptimit ose kuptimit jo të plotë të fesë.

Në kohën e Profetit gratë e mësonin dijen dhe fenë në disa mënyra, të cilat do të shpjegohen shkurtimisht më poshtë:

1. Gratë në xhami

Gjatë kohës së Profetit (pqmt), ashtu si burrat, edhe gratë shkonin në xhami. Ato falnin atje namazet e xhumasë, namazet e Bajrameve dhe namazet ditore. Në fakt, në ditë të veçanta gratë këshilloheshin të vinin në namazin e Bajramit, të qëndronin pas xhematit dhe të merrnin pjesë në tekbire.⁷⁸

Nga këto ngjarje të transmetuara kuptohet qartë se nuk ka ndonjë dëm a ndalesë në frekuentimin e xhamive nga gratë. “Mos i ndaloni gratë të shkojnë në xhami. Shtëpitë e tyre ama, janë më të mira për to.”⁷⁹ “Kur gratë t’u kërkojnë leje për të shkuar në xhami natën, jepuni leje.”⁸⁰ “Kur gratë duan t’i bashkohen xhematit, të mos lyhen me aroma.”⁸¹ Qartazi, atëherë xhamitë i kishin gjithmonë dyert e hapura për gratë. Sidoqoftë, nuk mungojnë disa rregulla. Gratë duhet të shkojnë në xhami pa vënë aromë, kështu ato nuk do të ndikojnë në përqendrimin që duhet pasur në namaz. Në këto dhe në të tjera masa të ngjashme, merret parasysh qetësia shpirtërore e duhur në namaz, si dhe mungesa e një elementi dashakeqës nga ana e burrave. Në të vërtetë, pas vdekjes së Profetit (pqmt) vajtja e grave në xhami ngjalli disa shqetësime dhe, herë pas here, bëheshin praktika të ndryshme.

Një nga këto praktika i përket periudhës kur kalif ishte Hazreti Omeri. Omeri (Zqkmt) caktoi një vend për gratë në xhami, që, gjatë

⁷⁸ Buhari, Dejn

⁷⁹ Salat Mysliman, 134-137

⁸⁰ Salat Mysliman, 139

⁸¹ Muslim, Salat, 141

Ramazanit, ato të luteshin veçmas nga burrat, dhe caktoi Sulejman bin Ebu Hasman si imam për to. Arsyen e praktikave të tilla e gjejmë në fjalët e Hazreti Aishesë (Zoti qoftë i kënaqur me të): “Nëse i Dërguari i Allahut do të kishte parë atë që bënin gratë pas Tij, ashtu si gratë e izraelitëve, Ai do t’ua kishte ndaluar edhe atyre vajtjen në xhami.”⁸² Është e qartë se veprimet e tyre shpërqendronin dhe dëmtonin atmosferën shpirtërore të namazit dhe xhamisë. Gjatë kalifatit të Hz. Osmanit, kjo praktikë u shfuqizua dhe gratë filluan të faleshin bashkë me burrat pas të njëjtit imam.

Në xhami, Profeti ynë (pqmt) tregonte dhe interpretonte ajetet e zbritura. Këtë e bënte jo vetëm ditën e xhuma, por edhe pas faljes së namazit në ditët e tjera. Ai (pqmt) u përgjigjej edhe pyetjeve të ngritura nga xhemati. Gratë mernin pjesë në këto biseda dhe bënin pyetje gjithashtu.⁸³

Dëgjimi i predikimeve dhe pjesëmarrja në biseda nga ana e grave vazhdoi edhe në periudhën e *Hulefa-i Rashidin* (periudha e katër kalifëve të mëdhenj pas Profetit). Fakti që një grua e kundërshtoi idenë e kufizimit të sasisë së *mahr*⁸⁴ ndërsa Omeri po predikonte, dhe se kjo grua e tha mendimin e saj pa asnjë lloj problemi, duke sjellë argumente edhe nga ajetet kuranore, është një tregues shumë domethënës i kësaj çështjeje.

Nga sa u tha më lart, kuptohet qartë, se në Shekullin e Artë, në xhami gratë përfitonin dije të dobishme nga ana shpirtërore.

2. Bisedat e posaçme të Profetit (pqmt) me gratë

I Dërguari i Allahut (pqmt) ka thënë: “Allahu më dërgoi mua si mësues.”⁸⁵ Ai ishte thëllësisht i interesuar për edukimin e popullit të Tij. Aq sa interesohej për edukimin burrave, po aq interesohej edhe për edukimin e grave. Për këtë arsye, Ai (pqmt) caktonte ditë të veçanta, që

⁸² Ebu Davud, Salat 53

⁸³ Buhari, Dituria, 41

⁸⁴ Shuma e parave që i dhurohet gruas nga bashkëshorti në martesë

⁸⁵ Ibn Maxhe, Mukadimeh, 229

të bisedonte me gratë dhe të predikonte posaçërisht për to.

Një ditë, gratë e Medines shkuan tek Profeti (pqmt) dhe thanë: “O i Dërguar i Allahut, burrat na e kanë kaluar për sa i përket dëgjimit të bisedeva të tua dhe përfitimit prej Teje. Na jep edhe neve një ditë të veçantë!” I Dërguari i Allahut (pqmt), në përputhje me rrethanat, caktoi një ditë të veçantë edhe për to. Në ato ditë të veçanta, Ai i këshillonte dhe i udhëzonte ato.⁸⁶

Gratë, të cilat e kishin të drejtën për ta dëgjuar bisedën dhe predikimin në xhami, hasnin vështirësi, sepse xhamia ishte e tejmbushur me burra dhe, në këto raste, ato nuk ishin në gjendje ta dëgjonin qartësisht Profetin tonë (pqmt). Pastaj, ishte edhe çështja e pamundësisë së tyre për të ardhur gjithmonë në xhami. Por Profeti (pqmt) nuk mund të tregohej indiferent ndaj tyre dhe, çështë e vërteta, nuk e priti me indiferencë kërkesën e tyre. Ai caktoi një ditë dhe, kështu, filloi të mbante predikime e biseda specifike për gratë. Në disa transmetime thuhet se i Dërguari i Allahut (pqmt) u predikonte grave në ndonjë shtëpi, pasi u thoshte atyre: “Mblidhuni në shtëpinë e kësaj apo asaj zonje!”

Një herë, i Dërguari i Allahut u tha grave kështu: “Nëse një grua ka tri vajza dhe i edukon mirë ato, këto tri vajza do të bëhen për të mburojë që do t’i mbrojnë nga xhehenemi.” Një nga gratë e pranishme e pyeti Profetin (pqmt) në këtë mënyrë: “Po nëse një grua ka dy vajza?” Profeti u përgjigj: “E njëjta gjë vlen edhe për ato që kanë dy vajza.” Nga kjo ngjarje kuptojmë se gratë duhet t’i mësojnë dhe t’i edukojnë mirë vajzat e tyre.

3. Kumtimi (i fesë) nga ana e sahabeve te familjet e veta

Zakonisht, i Dërguari i Allahut (pqmt) i jepte mesazhet dhe udhëzimet e tij në *Mesxhid-i Nebevi*. Gjithçka që Ai ua mësonte njerëzve ishin të bazuara në ato që i kishin zbritur nga Zoti. Udhëzimet që vinin nga përtej qiejve ishin të dëshiruara e të nevojshme ashtu si

⁸⁶ Buhari, Dituria 36

shiu që bie në tokën e zhuritur. Sa herë u ndodhte diçka, apo kur kishin ndonjë problem në shtëpi, sahabet vraponin për te Profeti (pqmt) në xhami dhe i kërkonin zgjidhje ose e pyesnin për mënyrën se si duhej të vepronin që problemi i tyre të gjente zgjidhje. Nëse ndonjë sahabe nuk arrinte ta pyeste Profetin, ose i vinte turp nga kjo gjë, ai pyeste atëherë *Ehli Suffan*⁸⁷, për të mësuar nëse kishte ndonjë lajm të ri nga Profeti (pqmt). Pasi e mësonte udhëzimin nëpërmjet kësaj mënyre, ai kthehej në shtëpi dhe ia mësonte atë edhe familjes së tij.⁸⁸ Kjo gjë i kërkohej sahabeve nga vetë Profeti, i Cili thoshte: “Edhe nëse është një varg (i vetëm), atë që dëgjoni nga unë përcilleni edhe te të tjerët.” Dhe as që mund të mendohet se ata mund të vepronin ndryshe. Siç kuptohet edhe nga ajeti **“O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja prej një zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët.”**⁸⁹, të gjithë besimtarët janë përgjegjës për mbrojtjen e anëtarëve të familjes nga zhgënjimi i përrjetshëm. Është e pamendueshme që sahabet, të cilët e dinin këtë ajet dhe kishin një ndjeshmëri të lartë për sa i përket jetesës në përputhje me udhëzimet fetare, t’i privonin familjet e tyre nga dijet që morën, edhe sikur ajo çfarë kishin mësuar të ishte një fjalë e vetme. Sigurisht që sahabet e patën kuptuar fort mirë këtë ajet dhe patën bërë atë që ishte e nevojshme.

Historia e mëposhtme, që tregon rastin e disa njerëzve që sapo e kishin mësuar fenë, na jep një ide mbi këtë çështje:

Një grup i fisit Rabia shkoi tek i Dërguari i Allahut (pqmt) dhe i kërkoj Atij që t’i jepte një numër këshillash, pasi, sipas pretendimeve të tyre, nuk mund të vinin lehtësisht në Medinë në një periudhë tjetër përveçse gjatë muajve kur ndalohej lufta e dhuna. Përndryshe, ata do të sulmoheshin nga fiset armike që ndodheshin ngado. I Dërguari i Allahut u dha atyre disa këshilla dhe, më pas, u tha: «T’i mësoni përmendsh ato që ju thashë dhe t’ua përcillni ato edhe atyre që kanë

⁸⁷ Një grup njerëzish që jetonin në strehën ngjitur me xhaminë, mësonin përmendsh ajetet e hadithet dhe përhapnin fenë

⁸⁸ Buhari, Dituria, 26

⁸⁹ Tahrim, 66/6

mbetur pas.” *“Ata që kanë mbetur pas”*, të përmendur në fjalët e Profetit (pçmt), janë i gjithë fisi dhe, në veçanti, familjet e atyre vizitorëve.

Parime të edukimit profetik: “Përhap dashuri dhe mëshirë!”

Në këndvështrimin e të Dërguarit të Allahut (pqmt), dashuria dhe mëshira janë parime kyçe dhe dalluese për sa i përket jetës dhe qenieve. Ai (pqmt) u dërgua si mëshirë për botët dhe, sidomos, për qeniet njerëzore. Për rrjedhojë, Ai i ndërtoi mbi dashurinë dhe mëshirën të gjitha marrëdhëniet me të tjerët, që nga jeta familjare te bashkëjetesa me fqinjët, që nga aktiviteti i Tij për kumtimin dhe udhëzimin deri te marrëdhëniet e tij shoqërore (me komunitetin) dhe administrative. Në këtë kuadër, baza e veprimtarisë së tij edukuese dhe formuese ishte dashuria dhe mëshira. Dhe, po në këtë kontekst, Ai (pqmt) ishte një mësues, që e shndërroi jetën në një qendër dashurie dhe mëshire me të gjitha aspektet dhe njësitë e saj.

I Dërguari i Allahut (pqmt) ishte një profet, i Cili u dërgua si mëshirë jo vetëm për besimtarët, por edhe për botët. Mëshira është një fenomen që del nga ndërthurja e dashurisë, dhembshurisë dhe interesimit. Ky është pasqyrimi i shërbimit për fenë në këtë botë. Prandaj, fjala e njësuar e të gjithë profetëve është në përputhje me ajetin e Kuranit: **“Unë nuk kërkoj diçka nga ju për predikimin (shërbimin) tim. Shpërblimi im i përket vetëm dhe vetëm Allahut!”** Kjo sakrificë është një shprehje e qartë dhe pasqyrim i një dashurie të thellë për njeriun. Ai që do, pikërisht prej dashurisë që ka, nuk pret ndonjë shpërblim për vete.

- **Profeti i fundit i donte me gjithë zemër njerëzit**

Kështu na e tregon Kurani Famëlartë këtë dashuri, interesim dhe mëshirë të thellë të të Dërguarit të Allahut (pqmt) kundrejt njerëzimit: **“A mos vallë ti (o Muhamed) do ta shkatërrosh veten ngaqë ata (banorët e Mekes) nuk duan të besojnë?”** Prandaj, një person që nuk ka dashuri në vetvete nuk mund të tregojë interesim e dashamirësi për bashkëbiseduesin e tij, nuk mund ta durojë atë derisa atij t’i zbutet zemra. Dashuria që nuk shoqërohet me interesim, mëshirë e dashamirësi është mjerane, nuk ka ndonjë vlerë. Për rrjedhojë, dashuria dhe mëshira e vërtetë janë thelbi i edukimit dhe formimit. Ai që nuk e do njeriun pa ndonjë interes, nuk mund ta kryejë siç duhet detyrën e edukuesit. Edhe nëse e kryen, nuk mund ta kryejë atë të plotë në të gjitha aspektet. Edhe nëse ia tregon mënyrën e përparimit në këtë botë, ajo nuk mund t’ia ndriçojë rrugën për në botën e përjetshme.

Në këtë kuptim, t’i duash njerëzit për Zotin është vetë fryma e edukimit. Në një periudhë të shkurtër prej 23 vjetësh, dashuria e thellë e të Dërguarit të Allahut (pqmt) për njerëzit, si dhe qëndrimi e sjellja e Tij plot dhembshuri dhe mëshirë, kanë qenë mënyrat më frytdhënëse për zbutjen dhe hapjen e zemrave të armiqve më të ashpër të Islamit. Me këtë dashuri pa asnjëfarë interesi, Ai (pqmt) shkriu ndjenjat e urrejtjes, hakmarrjes dhe armiqësisë dhe arriti të ngrinte një fron dashurie në zemrat e të gjithëve. Fjalët e Tij *“Më i miri i njerëzve dhe më i dashuri tek Allahu, është Ai që është më i dobishmi për njerëzimin.”* janë gjithashtu një tjetër tregues i kësaj dashurie universale. Pa dyshim që thirrja ndaj besimtarëve për të qenë të dobishëm për të gjithë njerëzimin tregon qartë se Ai (pqmt) i do të gjithë njerëzit dhe dëshiron t’i përqafojë të gjithë.

- **Marrëdhënia nxënës-mësues e bazuar në dashuri**

Marrëdhënia e të Dërguarit të Allahut (pqmt) me shokët e tij bazohet në dashuri dhe mëshirë. Ai (pqmt) që dërguar si një mësues për mbarë njerëzimin, kurse ata qenë ndjekësit dhe nxënësit e tij të parë. Në këtë kontekst, ndërsa Kurani e prezanton atë, thotë kështu: **“Juve ju erdhi një profet nga gjiri juaj. Atij i vjen rëndë për mëkatet**

që ju bëni, ai përpiqet që ju të shkoni në rrugën e drejtë dhe është i butë e mëshirues ndaj besimtarëve.” Pra, Ai (pqmt) jo vetëm që i do besimtarët, por, me dhembshurinë e një babai, edhe i dridhet zemra për ta. Dhe kjo nuk është gjë tjetër, po një shfaqje e natyrshme e dashurisë së vërtetë. Ndërsa i edukonte dhe i formonte sahabet, Ai iu qasej atyre me dashuri dhe dhembshuri. Edhe kjo është në përputhje me ajetin kuranor në vijim: **“Në sajë të mëshirës së Allahut, (ti) u solle butësisht me ta (o Muhamed)! Dhe nëse do të tregoheshe i ashpër e i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje.”**

Ashtu siç i donte Ai (pqmt) nxënësit e tij, edhe ata e donin Atë, madje e donin edhe më shumë se veten e tyre. Si një profet i dashurisë, i Dërguari dhe i Dashuri i Allahut mbolli farën e dashurisë në shpirtat e tyre. Dashuria, kujdesi dhe respekti që merrte ishte fryt i kësaj dashurie të fortë që Ai kishte kultivuar. Sahabet e donin këtë mësues më shumë se veten e tyre dhe, mbi të gjitha, e dëgjonin me shumë kujdes dhe e aplikonin me bindje dhe maksimalisht sunetin e Tij. Ata e donin aq shumë, sa që nuk ia kthenin kurrë fjalën; urdhrave dhe ndalimeve të tij i bindeshin me devotshmëri. Në fakt, rezultati dhe shenja më e dukshme e dashurisë ndaj të Dërguarit të Allahut është të jetuarit në përputhje me sunetin e Tij.

- Kurrë më parë nuk është dashur kaq shumë një mësues!

Edukimi është një punë që bëhet me dashuri dhe zemër. Mësues është ai person që është në gjendje të hapë dyert e zemrave me dashuri e mëshirë dhe të ngrejë fron në zemrat e nxënësve të vet. Në këtë drejtim, i Dërguari i Allahut (pqmt) është një mësues i arrirë, shembullin e të cilit duhet ta ndjekim të gjithë.

Për ta ilustruar këtë me një shembull, mund të sjellim në mendje ngjarjen në vijim.

Një ditë, një nga ensarët (mikpritësit) vajti për ta vizituar të Dërguarin e Allahut (pqmt) dhe, më pas, i tha Atij kështu: “O i Dërguari i Allahut! Unë të dua më shumë se jetën time, familjen time dhe pasurinë time. Kur të kujtoj Ty, nuk mund ta ndaloj veten dhe, kështu, vij menjëherë

për të të parë. Por, kur mendoj për vdekjen tënde dhe vdekjen time, unë mendoj kështu: Kur të hysh në Parajsë, Ti do të jesh në pozita të larta me profetët e tjerë. Kam frikë se, edhe nëse hyj në parajsë, unë nuk do të jem në gjendje për të të parë Ty atje.” Nuk kaloi shumë kohë dhe Profetit tonë (pqmt) i zbriti ky ajet: **“Kushdo që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, është me profetët, martirët dhe njerëzit e mirë, të cilët Allahu i ka bekuar. Sa miq të mirë janë këta!”** Pas kësaj, i Dërguari i Allahut (pqmt) e thirri sahaben dhe e njoftoi për zbritjen e këtij ajeti. Kështu, sahabet shpëtuan nga shqetësimet e tyre.

- Këshilla që njerëzit ta duan njëri-tjetrin

I Dërguari i Allahut (pqmt.) jo vetëm që i donte njerëzit dhe i trajtonte ata me mëshirë, por edhe i mësonte ata për ta dashur njëri-tjetrin. Ai iu qas kësaj çështjeje dhe e shpjegoi atë në kuadër të përsosjes së besimit: “Betohem në Allah, i Cili ka në dorë shpirtin tim, se nuk mund të hyni në Parajsë nëse nuk besoni. Dhe nuk do ta arrini besimin e vërtetë derisa ta doni njëri-tjetrin.” Ai (pqmt) u tregoi gjithashtu edhe rrugën e ndërtimit të kësaj dashurie mes tyre: “A t’ju tregoj diçka që, nëse e praktikoni, do t’ju bëjë ta doni njëri-tjetrin? Përhapeni përshëndetjen (selamin) midis jush!”

Ai (pqmt) thoshte se, në kuadër të përjetimit të besimit, dashuria e besimtarëve për njëri-tjetrin dhe të gjithë njerëzit nuk është një dashuri e zakonshme, por një dashuri me një vlerë të madhe dhe që vjen menjëherë pas dashurisë për Allahun dhe Profetin. Sidoqoftë, sipas Profetit tonë të dashur(pqmt), kjo dashuri duhet të jetë vetëm për të marrë pëlqimin e Zotit: “Një nga veprat më të mira është të duash vetëm për Allahun. E nëse do ta urresh dikë, ta urresh vetëm për Allahun”. Nuk ka egoizëm dhe dyfytirësi në një dashuri të tillë. Prandaj besimtarët i duan vëllezërit e tyre besimtarë dhe të gjithë njerëzit vetëm për Allahun. Dhe shpërblimin e kësaj ata e presin vetëm nga Allahu.

Ndërkohë që i mësonte njerëzimit dashurinë, i Dërguari i Allahut (pqmt) nuk e bënte këtë vetëm me fjalë. Ai e kishte atë parim të jetës dhe, si shprehje e ndjeshmërisë ndaj besimit, mbi të i ndërtonte

marrëdhëniet dypalëshe. Ai (pqmt) thekson: “Asnjëri prej jush nuk ka besuar derisa ta dojë edhe për vëllanë e tij atë që do për veten.” Se çfarë ka dashur të shprehë Profeti (pqmt) me këto fjalë, e kuptojmë edhe më mirë në dritën e asaj që transmeton Ebu Hurejre: “Që të quhesh besimtar, duaji edhe për të tjerët ato që i do për veten”. Një qasje kësisoj është një tregues domethënës për besimtarët që qëndrojnë larg së keqes, mashtrimit, gënjeshtërisë, dyfytërisë dhe zilisë. Përkundrazi, ata janë të mbushur me dashuri, dhembshuri dhe mëshirë.

Parime të edukimit profetik: “Bëje të dashur, mos e bëj të urryer!”

Një tjetër parim themelor i edukimit profetik është ky: “Bëje të dashur, mos e bëj të urryer!” Prandaj, teksa përpiqen të shprehin të vërtetat e tyre, ata që janë në pozitën e edukimit të njerëzve, por edhe ata që përpiqen për përmirësimin e shoqërisë dhe të mbarë njerëzimit, duhet të përdorin metoda që do t’u mundësojë nxënësve a bashkëbiseduesve të tyre ndjekjen e çështjes apo bisedës me dashuri dhe interes. Për këtë arsye, mësuesi duhet ta dojë mësimin aq sa e do edhe dijen. Duhet ta dojë nxënësin aq sa e do edhe mësimin, në mënyrë që ta bëjë mësimin e dashur për të. Siç u tha edhe më lart, themeli i edukimit dhe formimit është dashuria, dhe dashuria është vetë fryma e edukimit. Janë mësuesit dhe udhëzuesit shembullorë ata që do të transmetojnë dashuri. Kështu, institucionet arsimore ku këta mësues ndodhen do të dallohen dhe do të bëhen dominues. Këta mësues duhet të sakrifikojnë në emër të kësaj dashurie dhe të përdorin metoda, stile dhe forma që do të sjellin dashuri në edukim. Në të njëjtën kohë, ata duhet të shmangin qëndrimet dhe sjelljet që mund të bëhen shkak për urrejtjen ndaj tyre dhe vlerave që ata përfaqësojnë.

- “Mos e bëj të urryer!”

Një pikë tjetër drejt së cilës duhet tërhequr vëmendja është pjesa e dytë e parimit “Bëje të dashur, mos e bëj të urryer!”. Nëpërmjet pjesës së dytë të këtij hadithi, i Dërguari i Allahut (pqmt) kërkon që të jemi

vazhdimisht konstruktivë dhe, nga ana tjetër, të tregojmë kujdes që të mos e prishim atë që kemi ndërtuar deri në këtë moment. Ai bazohet gjithashtu edhe mbi parimin që thotë se “*gjërat njihen nga të kundërtat e tyre*”. Për rrjedhojë, Profeti (pqmt), që të mos biem në gabime, bashkë me dashurinë përmend edhe urrejtjen. Kështu që, mund të themi se ky parim është një sunet jashtëzakonisht i rëndësishëm në edukim, udhëzim e mësimdhënie, sepse në mjediset ku mbizotëron urrejtja, nuk mund të bëhet fjalë edukim, udhëzim dhe mësimdhënie aq efikase sa për të prekur zemrat dhe për të ndikuar shpirtrat.

I Dërguari i Allahut (pqmt), i Cili ua mësoi këtë parim sahabeve të tij, e ka përmendur këtë parim gjithashtu edhe në raste të ndryshme, madje edhe atëherë kur ka marrë ankesa. Një ditë, një nga sahabet erdhi pranë Tij dhe i tha se imami i xhamisë në lagjen e tij e kishte zgjatur shumë faljen e namazit të mëngjesit dhe se ai nuk dëshironte të falej më atje. I Dërguari i Allahut (pqmt) u habit thellësisht, u ngrit në këmbë dhe tha: “O njerëz! Disa prej jush i bëjnë njerëzit të urrejnë! Kushdo prej jush që bëhet imam, të mos ua vështirësojë namazin të tjerëve. Midis radhëve mund të gjenden njerëz të ndryshëm, mes të cilëve edhe nga ata që lëngojnë, të moshuar e të pafuqishëm.” Në një rast tjetër, kur i erdhi lajmi se një imam e kishte zgjatur lutjen, Ai (pqmt) iu drejtua atij imami me këto fjalë: “A je ti prej atyre që përhapin fitne?” Ai paralajmëroi se kjo (zgjatja e faljes së namazit) mund t’i çonte njerëzit në fitne dhe i këshilloi sahabet të këndonin sure të shkurtra, në mënyrë që të mos i ftohnin njerëzit nga falja e namazit.

- Metoda e përgëzimit

Përdorimi i një stili përgëzues gjatë edukimit dhe mësimdhënies së të vërtetave e bën dijen, edukimin dhe mësimin më të dashur. Për këtë arsye, ashtu si të gjithë profetët, edhe Profeti ynë (pqmt) u dërgua si “përgëzues”. Përgëzues është ai që inkurajon vijimin e rrugës së drejtë dhe thotë fjalë të mira; është ai që inkurajon veprat e mira me dashuri; është ai që i mbështet njerëzit në qëllimet e tyre larta dhe u jep atyre lajmin e mirë të shpërbimit. E kundërta e përgëzimit është “*nedhir*”, që

do të thotë “paralajmërues i dënimit”. Kjo qasje përfshin rikujtimin e pasojave të këqija të gabimeve dhe mëkateve, tërheqjen e vëmendjes tek rreziqet e të jetuarit larg të qenit rob i bindur ndaj Allahut e, për rrjedhojë, edhe shmangien e katastrofës në këtë botë dhe në *ahiret* (jetën e përtejme).

Në këtë aspekt, “përgëzuesi” inkurajon, jep dashuri dhe motivon. Nga ana tjetër, “*nedhir*» është paralajmërues për marrjen e masave, mbajtjen e njerëzve larg veprave të këqija dhe për mbrojtjen e tyre. Gjithsesi, duhet pasur kujdes që, teksa paralajmërojmë, të mos i bëjmë njerëzit të urrejnë dhe të vijojmë në qasjen plot dhembshuri. Andaj, emërtimi i të Dërguarit të Allahut (pqmt) si “përgëzues” shpreh qartazi parimin “bëje të dashur”, kurse “*nedhir*” shpreh po aq qartë parimin «mos e bëj të urryer”. Ai (pqmt) i ndoqi këtë parime në mënyrë që t’i bënte njerëzit të lumtur në të dyja botët. Përhapri dashuri duke inkurajuar veprat e mira dhe duke shmangur fundin e hidhur të veprave të këqija. Ai e kreu këtë detyrë pa ushqyer urrejtje ndaj njerëzve dhe ia la këto parime si trashëgimi profetike popullit të tij.

- Me fytyrë të qeshur dhe i buzëqeshur!

Një pikë e rëndësishme e parimit “Bëje të dashur, mos e bëj të urryer!” është të qenit i buzëqeshur gjatë mësimdhënies dhe edukimit. Një fytyrë e qeshur i bën njerëzit ta duan edhe fjalën, edhe vetë personin. Përkundrazi, të gjithë urrejnë dhe largohen nga fytyrat e ngrysura; askush nuk dëshiron t’i dëgjojë njerëz të atillë, e jo më të mësojë diçka prej tyre. I Dërguari i Allahut (pqmt) ishte gjithmonë i qeshur. Ai i pati këshilluar shokët e vet duke iu thënë: “Buzëqeshja juaj ndaj vëllait tuaj është sadaka”. Pra, Ai thekson se përhëndetja e të tjerëve me buzëqeshje bën pjesë në sferën e adhurimeve. Në dritën thënies së Profetit tonë (pqmt), “Ju nuk mund t’i kënaqni njerëzit me dhuratat që bëni nga pasuria juaj. Por ju mund t’i përqaftoni ata me fytyrën tuaj të qeshur dhe moralin tuaj të mirë,” kjo është, me të vërtetë, një nga mënyrat më të lehta të edukimit dhe të dashurisë.

- **Fjala e mirë dhe goja e ëmbël ju bën të dashur!**

Një nga dinamikat themelore që kërkon edukimi (arsimimi) dhe që e lehtëson punën e mësuesve dhe udhëzuesve janë fjala e mirë dhe goja e ëmbël. Nga ana tjetër, njerëzit e ashpër, të cilët kanë një mënyrë të vrazhdë komunikimi, i shqetësojnë tejmase bashkëbiseduesit dhe nxënësit e tyre, i dekurajojnë ata në çështjen e studimit dhe, kështu, dijen dhe veten i bëjnë të urryera te nxënësit. Në këtë këndvështrim, të gjithë profetët që u dërguan si udhëzues për njerëzimin ishin shpjegues fjalëmirë e gojëmbël të së drejtës dhe së vërtetës. Me fjalë të tjera, ata i ftuan njerëzit në fe dhe i paralajmëruan për pasojat e mosbindjes me mënyrën më të mirë, pra, me butësi.

Kurani Famëlartë hedh dritë edhe mbi këtë çështje kur tregon se si Allahu (xh.xh.) dërgon Musain (pqmt) dhe Harunin (pqmt) te faraoni: **“Shkoni që të dy te faraoni, se ai vërtet e ka tepruar. Flitini atij me fjalë të buta, ndoshta mendohet a frikësohet.”**⁹⁰ Fjala nuk ka të bëjë vetëm me tinguj dhe zhurma që dalin nga goja. Prandaj, fjala e mirë dhe goja e ëmbël do të jenë më efektive për bashkëbiseduesin a nxënësin.

Duke treguar për këtë të vërtetë, Profeti ynë (paqja qoftë mbi të) thotë: “Allahu është i Butë. Atij i pëlqen që edhe robërit e Tij të trajtohen me butësi. Pa dyshim se atë që e jep me fjalë dhe sjellje të butë nuk e jep dot me fjalë dhe sjellje të ashpra”. Për këtë arsye, i Dërguari i Allahut (pqmt) deklaroi duke na kujtuar një të vërtetë të madhe: “Nëse një person privohet nga butësia, ai është privuar nga çdo e mirë”. Ai (pqmt) deklaroi gjithashtu se mësuesit dhe udhëzuesit që nuk i përfshijnë këto metoda në arsimim dhe edukim nuk mund të jenë të suksesshëm.

⁹⁰ Ta Ha 20/ 43-44

Prefekti i parë i Mekes pas Islamit

Attab Ibni Esid (Zqkmt) ishte akoma një djalosh 11-12-vjeçar kur Profeti (pqmt) emigroi nga Meka për në Medinen e bekuar. Por i Dërguari i Zotit i kishte vënë re aftësitë e tij dhe ishte ndikuar prej tyre. Edhe pse kishte emigruar drejt Medines, e kishte ndjekur atë hap pas hapi në çdo aspekt. Pavarësisht faktit që në atë shoqëri familjet ishin me shumë fëmijë, Ai (pqmt) nuk ia kishte harruar fytyrën dhe emrin e djaloshtit.

Pas shumë vitesh, kur bashkë me sahabet ishte drejtuar drejt Mekes për ta çliruar atë, ndër emrat që priste të pranonin Islamin, Ai (pqmt) kishte përmendur edhe atë të Attab Ibni Esidit (Zqkmt).

Por, edhe pas çlirimit të Mekes, Attabi nuk e pranoi menjëherë Islamin. Ashtu si edhe disa mekas të tjerë, ai kishte disa dyshime që e pengonin në këtë pikë. Koha do ta tregonte vendimin që ai do merrte.

Kishte hyrë vakti (koha) i drekës dhe Bilal Habeshiu, të cilin dikur nuk donin ta shihnin me sy sepse kishte qenë një skllav me ngjyrë, ishte ngjitur mbi Qabe dhe po thërriste ezanin e parë në Meke. Zëri i tij, që disa vite më parë kishte tronditur malet Faran nëpërmjet thirrjeve “*Ehad! Ehad!*” për shkak të torturave të mekasve, sot atyre u dukej si shigjetë vrastare. Sigurisht që kjo nuk u kishte pëlqyer mekasve!

Prandaj, një grup mekasish, teksa dëgjonin ezanin e thirrur nga Bilali, shprehnin me njëri-tjetrin ndjenjën e mospëlqimit. Edhe Attab Ibni Esidi ishte në mesin e tyre. Madje ai kishte qenë i pari që kishte marrë fjalën dhe që, duke iu referuar të atit, kishte thënë: “Allahu e ka

begatuar Esidin (me vdekje) sepse sot nuk po e dëgjon këtë zë që të bën të çmendesh nga inati.”

Harith Ibni Hishami, i cili ishte vëllai i Ebu Xhehlit, dhe poeti i famshëm Suhejl Ibn Amr thanë kështu: “Nëse do të mendoja se Ai (pqmt) ishte në të drejtë, menjëherë do i besoja!”

Radhën për të folur e kishte Hakem Ibni Ebili, i cili u shpreh në këtë mënyrë: “Të hipi një skllav në majë të ndërtesës së Ebu Talhasë (Qabes) dhe të bërtasë në këtë mënyrë, me të vërtetë që është një ngjarje e madhe!”

Ndërsa Ebu Sufjani, i cili po i dëgjonte me vëmendje të tjerët, po tregohej më i rezervuar. Pa dyshim që poshtë këtij rezervimi qëndronte një përvojë e shkuar. I Dërguari i Allahut (pqmt) ia kishte vërtetuar atij që më parë se Ai i dinte me imtësi të gjitha diskutimet që ai bënte në shtëpi vetëm me gruan e tij, Hindin. Kështu që, ai foli në këtë mënyrë: “Në lidhje me këtë temë, unë nuk mund të them diçka, sepse e di që, sikur të them diçka, edhe këta gurë që janë këtu shkojnë dhe ia tregojnë atij atë çfarë folëm!”

Pas pak ndodhi ajo që kishte menduar Ebu Sufjani. Engjëlli Xhibril shkoi dhe ia tregoi Profetit (pqmt) gjithë çka u fol mes pjestarëve të atij grupi njerëzish.

Pas kësaj, i Dërguari i Allahut (pqmt) shkoi tek ata dhe tha: “E di shumë mirë që ju folët me njëri-tjetrin dhe thatë ashtu e kështu!”. Kjo fjali i kishte goditur ata aty ku nuk e prisnin. Edhe pse për pak minuta, nuk mundën ta fshehin habinë. Dhe i pari u dorëzua Attab Ibni Esidi, i cili dëshmoi menjëherë bindjen ndaj Tij duke thënë: “Edhe ne dëshmojmë se me të vërtetë Ti je i Dërguari i Allahut! Nuk kishte njeri që t’i dëgjonte fjalët tona dhe të t’i tregonte Ty!”.

Ja pra, më në fund, pas shumë e shumë vitesh erdhi momenti i shumëpritur dhe Attab Ibni Esidi pranoi Islamit.

Vetëm 19 ditë pas kësaj ngjarjeje, i Dërguari i Zotit (pqmt) bashkë me ushtrinë u detyruan të niseshin drejt Hunejnit. Personi të cilit i dorëzoi drejtimin e Mekes dhe e bëri prefekt të saj ishte 19-20-vjeçari i sapo bërë mysliman, Attab Ibni Esidi (Zqkmt).

I Dërguari i Allahut (pqmt) i kishte caktuar atij si rrogë 2 dirhemë. Por ai ishte aq i kujdesshëm dhe i ndjeshëm në këtë detyrë, sa që u shpreh në këtë mënyrë: “Që nga momenti që jam emëruar në këtë detyrë, nuk kam përfituar diçka tjetër përpos dy rrobave që ia kam veshur ndihmësit tim Kejsan”.

Ndërkohë, i Dërguari i Allahut (pqmt), krahas emërimit të tij prefekt, kishte emëruar si mësues në Meke edhe Muadh ibni Xhebelin dhe Ebu Musa el Eshariun (Zqkmt).

As Ebu Sufjani dhe as persona të tjerë me pozitë nga Kurejshët nuk i kishin konsideruar këto emërimë si problem. Nuk kishin menduar gjëra të tilla si: “Kur secili prej këtyre njerëzve me peshë mund të ishte fare mirë drejtuesi ynë, si mundet që të zgjidhet për këtë detyrë një djalosh 20-vjeçar?” Përkundrazi, pranimi i Islamit dhe ndikimi i tij në jetët e tyre i bëri ata t’i binden me modesti vendimit të Profetit (pqmt). Edhe pasi profeti Muhamed (pqmt) u kthye në Medine, ata vazhduan të mbanin të njëjtin qëndrim.

Gjithsesi, Attab Ibni Esidi vazhdoi të kryente detyrën e prefektit të Mekes edhe gjatë kalifatit të Ebu Bekrit (Zqkmt). Por Attabi (Zqkmt) nuk qëndroi gjatë në këtë jetë dhe, në një moshë fare të re, 23 ose 24 vjeç, u largua nga kjo botë. Pikërisht në atë ditë ndërroi jetë edhe kalifi i parë i Profetit (pqmt), Ebu Bekri (Zqkmt). Nuk duhet lënë pa u përmendur edhe fakti që Attabi ishte dhëndri i Ebu Xhehlit.

Radhitja e katër kalifëve dhe meritat e tyre

Kishte një marrëdhënie shumë të fortë midis Profetit tonë (paqja qoftë mbi Të) dhe katër kalifëve të mëdhenj. Duke marrë shkas edhe nga kjo marrëdhënie, Profeti ynë u dha një tjetër vlerë atyre, të cilët do të udhëhiqnin njerëzit në të ardhmen. Përtej kësaj, është e mundur të thuhet se, nga shpalljet e Allahut, Profeti ynë (pqmt) e dinte renditjen e këtyre katër kolosëve besnikë që do e pasonin në detyrë, dhe këtë ua kishte thënë atyre që kishte rreth e rrotull. Kur shihet nga kjo perspektivë, kuptohet qartë se pretendimet e bëra më pas në lidhje me *Hulefa-i Rashidin* (katër kalifët e medhenj pas Profetit) nuk kanë asnjë lidhje me realitetin.

Të katër kalifët e morën detyrën e kalifit në një sekuençë, e cila, pas një shqyrtimi të kujdesshëm, na tregon një paralelizëm të madh mes veçorive të tyre dhe ngjarjeve që hasën gjatë periudhës së kalifatit. Për shembull, Hazreti Ebu Bekri nuk ishte vetëm shumë i rregullt dhe i kujdesshëm, por gjithashtu nuk kishte asnjë të barabartë me të për sa i përket detajeve në bindje. Në këtë kuadër, kjo ishte një karakteristikë shumë e rëndësishme, pasi ai merrte vendime shumë të shpejta, serioze, dhe të sakta në periudha kritike e, ashtu siç thotë edhe Hazreti Aliu, “nëse Ebu Bekri nuk do të ekzistonte, Islami nuk do të ekzistonte”. Vërtet, do të kishte qenë shumë e vështirë të kalohej ajo periudhë, po të mos kishte qenë një prijës si Ebu Bekri, i cili ishte i aftë të merrte vendime të shpejta dhe të sakta në ato raste të kthimit nga feja, që patën ndodhur në kohën e tij. Me ndihmën e Allahut dhe aftësinë e Hz. Ebu

Bekrit në marrjen e vendimeve të sakta, kapërcimi i atyre problemeve u realizua lehtësisht. Në atë periudhë aq të komplikuar, një person si Ebu Bekri ishte i domosdoshëm, sidomos kur analizohen përgjegjësitë që mori mbi supe ai.

Hz. Omeri ishte një gjeni administrativ dhe ushtarak. Kështu që, për atë kishte nevojë shteti islam në atë periudhë të pushtimeve dhe zgjerimit të tij. Edhe periudha në të cilën jetoi dhe drejtoi shtetin Hz. Aliu, kërkonte një personalitet të gjithanshëm si ai. Dhe Hz. Aliu e përmbushi detyrën e tij me shumë sukses. Nëse do të kishte qënë dikush tjetër në vendin e tij asokohe, ka shumë të ngjarë që ai person të bënte ndonjë padrejtësi. Mendoni momentin kritik kur Havarixhët dhe Navasibët u mblodhën dhe bënë plane sulmi kundër tij. Një nga këshilltarët më të afërt të Hz. Aliut erdhi dhe i tregoi se Havarixhët ishin mbledhur për ta sulmuar. Imami u përgjigj kështu: “Për çfarë më duhet ta di se ata do të më sulmojnë?” Ai i thotë sërish: “O Imam! Po ju them se ata janë mbledhur për t’ju sulmuar!” “Deri në momentin që ata do të më sulmojnë mua, unë nuk mund t’i sulmoj.” Po, Hz. Aliu ishte shumë i drejtë dhe e shprehte këtë duke marrë në konsideratë çdo gjë dhe duke i menduar të gjitha detajet. Ashtu siç thotë edhe Mjeshtri, “... përballë trazirave të atilla, ishte i nevojshëm dikush me fuqi të mrekullueshme, me guxim, respektueshmërinë dhe mendjemprehtësinë e Hazreti Aliut; duhej dikush me fuqinë e Hashimive dhe të Ehlibejtit, që t’i bënte ballë kryengritjes...”⁹¹.

I Dërguari i Allahut (pqt), duke zbuluar gjenialitetin e tyre, këtë forcë potenciale të fshehur në natyrën e secilit prej tyre, nëpërmjet trajnimit dhe edukimit unik të Tij, i vë në dukje një nga një këta katër kalifë. I mësoi ata, i edukoi, i rriti dhe, në këtë mënyrë, bëri të mundur zhvillimin e aftësive të fshehura brenda tyre. Sigurisht, kjo ishte një punë që kërkonte goxha kohë, por, gjithsesi, ishte e realizueshme.

Hz. Ebu Bekri, Hz. Omeri, Hz. Osmani, Hz. Aliu dhe Hazreti Halidi përfituan nga Profeti (paqja qoftë mbi Të) në varësi të kohës që mundën të kalonin pranë Tij. Ai (paqja qoftë mbi Të) mund të

⁹¹ Bediuzaman, Letra XIX, 5.

konsiderohet si një libër virtytesh, të cilin ata e lexuan dhe e kuptuan shumë mirë. Ata mbanin shënim në mendjen dhe idetë e tyre çdo fjalë që i Dërguari i Allahut thoshte; ata e mbanin të gjallë marrëdhënien midis predikimeve e veprimeve të Tij dhe mendimeve të tyre. Nga njëra anë, ata vazhdimisht i peshonin mendimet dhe vlerësimet e tyre në dritën e veprimeve, fjalëve dhe thënieve të Tij. Ndërsa nga ana tjetër, udhëhiqeshin nga ndjeshmëria e madhe për t'iu bindur urdhrit hyjnor.

Këta katër njerëz të mëdhenj, të cilët iu dorëzuan të Dërguarit të Allahut, kishin kënaqësinë të lexonin dhe dëgjonin më të mirin e pejgamberëve dhe që ishin «*muejed min indil'lah*» (të aprovuar dhe të ndihmuar nga Allahu), kurrë nuk e lanë pas dore arsytimin dhe të vepruarit me logjikë. Për shembull, Hz. Omeri ishte më i guximshëm se Hz. Ebu Bekri në shprehjen e mendimeve, ndërsa Hz. Ebu Bekri ishte më i kujdesshëm se Hz. Omeri. E, megjithatë, të gjitha këto virtyte ishin meritë unike e njërit ose e tjetrit. Veçoritë e tyre, në njëfarë kuptimi, kishin të njëjtën vlerë. Peshonin njësoj. Pra, duhet të kuptohet mirë se nuk është mungesë që disa tipare të ndjehen dhe të vërehen më fort te këta njerëz të mëdhenj, kurse disa tipare të tjera të vërehen më pak. Duket sikur këta katër sahabe e kishin ndarë mes njëri-tjetrit gjërësinë e rrugës së drejtë Muhamedane (paqja qoftë mbi Të).

Hz. Omeri thotë: “Unë u pajtova me Zotin tim në tre vende”. Një nga pikat që ai i referohet është çështja e hixhabit. Ndërsa nëna jonë Sevde po ecte natën jashtë shtëpisë, Hazreti Omeri e kupton këtë prej shtatit të saj të lartë dhe shprehet duke thënë se ajo është nëna jonë Sevde. Ai e bën këtë duke pasur parasysh që askujt nuk duhet t'i kalojnë nëpër mendje, madje as në ndonjë cep të saj, dyshime për gruan e Profetit të nderuar.

Sa i përket Hz. Ebu Bekrit, edhe ai ishte shumë i ndjeshëm në lidhje me këtë çështje. Ai gjithmonë i thoshte “*Ummah*” (nënë) vajzës së tij, Hz. Aishesë, sepse ajo ishte nga gratë e Profetit (pqmt). Kjo ndjenjë ishte bërë pjesë e natyrës së tyre. Allahu i Madhërishtëm shpreh sa vijon në suren *Ahzab*: “**I Dërguari është më i afërt për besimtarët sesa ata**

për njëri-tjetrin; gratë e tij janë (si) nënat e tyre.⁹² Kjo do të thotë se ne duhet t'i shohim gratë e Profetit si nënat tona, t'i mendojmë si nënat tona dhe ashtu t'i thërrasim. Për Profetin dhe për gratë e tij, nuk mund të mendohet në asnjë mënyrë përjetimi i ndonjë rrëshqitjeje, qoftë edhe ajo më e vogla. Për këtë arsye veproi ashtu Hz. Omeri, prandaj u tregoi të pranishmëve se ajo gruaja ishte Hz. Sevde, bashkëshortja e Profetit. Pas kësaj ndodhie zbriti ajeti në lidhje me mbulesën e femrave.

Një tjetër rast është ai kur filluan të zbrisnin ajetet e para mbi çështjen e alkoolit, ajetet ku thuhet se, ndonëse ka disa dobi, alkooli është i dëmshëm. Hz. Omeri qe lutur në këtë mënyrë atëherë: "O Allah! Na zbrit një shpallje të prerë dhe të qartë për alkoolin!" Në fakt, edhe pritshmëria e të Dërguarit të Allahut (pqmt) në atë drejtim ishte. Dhe, kështu, zbritën edhe ajetet që e ndalojnë përdorimin e pijeve alkoolike. Për sa i përket arsyes se pse Allahu (xhel'le xhelaluhu) ia përmbushi pritshmëritë Hz. Omerit kësisoj, mund të themi se Zoti i Plotfuqishëm shfaqti në njëfarë mënyre gjenialitetin e Omerit dhe interesimin e tij për një çështje që ndikonte shoqërinë. Pajtimi i tretë i pritshmërive të Hz. Omerit me shpalljet hyjnore ka të bëjë me *riba*-në (interesin e parave të dhëna borxh).

Sidoqoftë, Hz. Omeri ishte një njeri jashtëzakonisht i përvullur dhe i përkushtuar. Ai kujton vetëm tre raste, paçka se ka pasur më shumë raste të tilla. Gjithsesi, ata që studiojnë shkencën e hadithit numërojnë mbi trembëdhjetë pajtime të pritshmërive të tij me ato që Zoti shpalli. Ndonëse në një nivel të tillë, Hz. Omeri as që është i vetëdijshëm për veten dhe ato çfarë di. Nga trembëdhjetë pajtime me Zotin e tij, ai kujton vetëm tre.

Gjithashtu duhet marrë mësim edhe nga qëndrimi i Hz. Omerit në Hudejbije. Hz. Omeri shkon te Profeti ynë (pqmt) në Hudejbije dhe i shpreh Atij disa vërejtje dhe rezerva. Nga ana tjetër, mendimi i të Dërguarit të Allahut për atë çështje është i ndryshëm. Profeti i drejtohet Omerit me këto fjalë: "O Omer! Unë jam i Dërguari i Zotit. Nuk mund t'i dal kundër Atij!" Pas kësaj, Omeri largohet që aty dhe,

⁹² Surja Ahzab, 33/6.

më pas, takohet me Ebu Bekrin. Gjatë bisedës me Ebu Bekrin, Hz. Omeri e kupton thelbin e çështjes. Më vonë, sa herë i kujtohej kjo ngjarje, përkeqësohej nga ndjenja e pendesës dhe ndiente keqardhje të mirëfilltë. Sadakatë që ka dhënë, agjërimet që ka mbajtur dhe faljet shtesë që ka bërë vetëm në emër të shlyerjes së këtij gabimi nuk kanë të llogaritur.

Shkurtimisht, kur shqyrtohet në tërësi jeta e secilit prej katër kalifëve, vihet re shumë qartë se ata pëlqehen masivisht si pasojë e sakrificave dhe vuajtjeve të tyre në emër të kauzës së drejtë që nga pranimi i Islamit, bindjes së tyre katërçipërisht ndaj Profetit tonë (pqmt), të kuptuarit e mirëfilltë të shpirtit të fesë, ndjeshmërisë së tyre në adhurime dhe përtëritjes që i bënin urdhrave të fesë e përgjegjësiive të tyre ndaj njerëzve.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Udha profetike / përgat. Taulant Bica, Detin Kotrri, Armand
Asllani. - Tiranë : Zambaku, 2024.
... f. ; ... cm. - (Kolana Prizmi).

ISBN 9789928476524

1.Mohammed 2.Feja islame 3.Edukimi fetar
28 -32 -475